

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE: ROLI I TYRE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË RAJONIT TË EUROPËS JUGLINDORE. RASTI I SHQIPËRISË

Ismet Voka

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës
në Ekonomi me profil “Ekonomi-Zhvillimi i Qëndrueshëm”,
për marrjen e gradës shkencore "Doktor"

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Luljeta Minxhozi

Numri i fjalëve: 53.468

Tiranë, 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj, se punimi është fryt i punës sime. Punimi është original dhe nuk përmban pjesë të shkruara apo të kopjuara nga ndonjë autor tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara në këtë studim.

Autori

Emri dhe mbiemri

Firma

ABSTRACT

Foreign Direct Investment (FDI) plays an important role in economic development. It's importance is even higher for transition economies where domestic capital is incapable of meeting investment needs of the economy in the transformation process. Firstly the study examines the objective of the research. Secondly it analyses the importance of FDI to transition economies of (SEEC) South East European Countries and Albania. The study examines the trend and characteristics of FDI in the South East European Countries and compare it's amount with Central East European Countries (CEECs). Additionally the case of Albanian net FDI is exerted, examining the evidence of Albanian net FDI by structure, country of origin and activity.

Additionally the case of Albanian net FDI is exerted, examining the evidence of Albanian net FDI by structure, country of origin and activity.

The size of FDI in Albania is outlined at both stock and flow level. In the empirical part of the study, which is covered by the Gravity model, we find significant and positive impact of institutional, transition and business related factors on the size of FDI.

The study additionally finds that gravity related factors are significant, like GDP in host country, GDP in source country and distance, are significantly related factors, relying on expected relationship with the size of inward FDI stock in Albania.

Additionally the study also provides empirical evidence related the causality of FDI on GDP growth and vice versa the causality of GDP growth on FDI, using time series analysis.

Key words: foreign direct investment, transition, determinants of FDI, economic growth.

ABSTRAKTI

Investimet e Huaja Direkte (IHD) luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Rëndësia e tyre është edhe më e lartë për ekonomitë në tranzicion, ku kapitali i brendshëm është i paaftë për plotësimin e nevojave për investime të ekonomisë në procesin e transformimit. Së pari, studimi shqyrton objektivat e hulumtimit. Së dyti, studimi analizon rëndësinë e Investimeve të Huaja Direkte në ekonomitë në tranzicion të Evropës Juglindore dhe Shqipëri. Studimi shqyrton trendin dhe karakteristikat e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore, duke krahasuar shumën e tyre me vendet Qendrore të Evropës Lindore (EQL-së).

Përveç kësaj, rasti i IHD-ve në Shqipëri është analizuar thellësisht, duke shqyrtuar evidencën përshkruese të IHD-ve në nivel fluksi dhe stoku. Gjithashtu, studimi paraqet edhe një analizë deskriptive të IHD-ve në Shqipëri, duke analizuar strukturën e IHD-ve, sipas vendit të origjinës dhe strukturës së kapitalit.

Në pjesën empirike të studimit, e cila është mbuluar me model graviteti, ne gjejmë ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv të faktorëve institucionalë, faktorëve të biznesit dhe faktorëve të tranzicionit në madhësinë e IHD-ve në Shqipëri.

Përveç kësaj, studimi ofron evidencë empirike lidhur me lidhjen shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe rritjes së PBB-së dhe anasjelltas lidhjen shkakësore ndërmjet PPB-së dhe rritjes së IHD-ve, duke përdorur analizën e serive kohore.

Fjalë kyçe: Investimet e Huaja Direkte, tranzicion, faktorët përcaktues të IHD-ve, rritja ekonomike.

DEDIKIMI

Për prindërit e mi dhe familjen time.

FALËNDERIME

Per realizimin e këtij punimi kam patur fatin të kem ndihmën dhe përkrahjen e shumë njerëzve të mirë. Para së gjithash, dua të falënderoj udhëheqësen shkencore Prof.Dr.Luljeta Minxhozi, e cila me përkushtim dhe optimizëm më ka ndihmuar gjatë gjithë kohës si nga ana shkencore, po ashtu edhe nga ana metodologjike. Pozitivizmi dhe mbështetja morale e saj ma lehtësuan realizimin e këtij punimi.

Së dyti, u jam mirënjohës të gjithë pedagogëve të Departamentit të Financës, për të gjitha komentet dhe diskutimet gjatë mbrojtjes së bardhë. Në veçanti, dua të falënderoj oponenten Prof. As. Dr. Oltiona Zoto që me vërejtjet dhe sugjerimet e saj u mundësua që punimi të përmirësohej më shumë.

Falënderoj gjithashtu, Prof. Dr. Agim Kukeli dhe Prof. As. Dr. Selami Xhepa që me frymën kritike dhe mendimin profesional më ndihmuan në pjesën empirike të punimit.

Së fundi, falënderime shkojnë për babain, motrat dhe vëllezërit e mi. Unë, mbi të gjitha, do doja të falënderoja bashkëshorten time, Anjezën, për ndihmën dhe mbështetjen e saj në çdo kohë. Një falënderim i veçantë shkon për fëmijët e mi, Roelin dhe Rebekën. Ata ishin frymëzimi dhe relaksimi im gjatë gjithë shkrimit të punimit të doktoraturës.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE1

1.1	Qëllimi i studimit	2
1.2	Objektivat e studimit	4
1.3	Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit	6
1.4	Metodologji e studimit	9
1.4.1	<i>Modeli teorik i gravitetit</i>	<i>11</i>
1.4.2	<i>Arsyetimi ekonometrik i metodologjisë dhe arsyetimi i modelit të zgjedhur</i>	<i>12</i>
1.4.3	<i>Përshkrimi i të dhënave</i>	<i>13</i>
1.5	Kufizimet e studimit	19
1.6	Organizimi i studimit	20

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS MBI IHD-TË

NË EKONOMITË NË TRANZICION.....23

2.1.	Hyrje	23
2.2.	Përkuftizime dhe kuptimi i Investimeve të Huaja Direkte	24
2.3.	Klasifikimi dhe format kryesore të Investimeve të Huaja Direkte	28
2.4.	Teoritë kryesore mbi IHD-të	31
2.4.1.	<i>Teoria neoklasike e IHD-ve</i>	<i>32</i>
2.4.2.	<i>Teoria Monopoliste e IHD-ve</i>	<i>34</i>

2.4.3. Teoria zëvendësuese e IHD-ve	36
2.4.4 Teoria plotësuese e IHD-ve	37
2.4.5. Teoria e ciklit të jetës së produktit	38
2.4.6. Teoria elektike e Dunning	40
2.4.7. Teoria e Kostos së Transaksioneve	44
2.4.8. Teoria e IHD-ve që bazohet në resurset ekonomike	45
2.4.9. Teoria e IHD-ve që bazohet në rrjetin e biznesit	46
2.4.10. Teoria strategjike e Porter-it	48
2.5. Klasifikimi alternativ i teorive mbi faktorët përcaktues të IHD-ve, që mbështetet në teorinë e Lokacionit të IHD-ve	49
2.5.1. IHD-të që mbështeten në faktorët kërkuar të tregjeve	52
2.5.2. IHD-të që mbështeten në faktorët kërkuar të burimeve	52
2.5.3. IHD- të që mbështeten në faktorët kërkuar të efikasitetit	53
2.6 Investimet e Huaja Direkte dhe rritja ekonomike	53

KAPITULLI III: INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË VENDET E

EVROPËS JUGLINDORE	58
3.1 Hyrje	58
3.2 Rëndësia e IHD-ve gjatë tranzicionit ekonomik në vendet e EJT-së	56
3.3 Zhvillimi ekonomik dhe problematika në Evropën Juglindore	64
3.4 Dinamika dhe trendi i IHD-ve në vendet në tranzicion të Evropës Juglindore ..	73
3.5 Investimet e Huaja Direkte në vendet e Evropës Juglindore, sipas vendit të origjinës	87

3.6.	Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore dhe marrëdhënia e tyre me treguesit e tranzicionit	92
------	---	----

KAPITULLI IV: INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI DHE

	ZHVILLIMI EKONOMIK.....	98
4.1	Hyrje	98
4.2	Tranzicioni në Shqipëri dhe sfidat drejt Bashkimit Europian	99
4.3	Profili i IHD-ve në Shqipëri	117
4.4.	Trendi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me vendet e EJT-së dhe tendencat globale	126
4.5	Aspekte kryesore të stokut të Investimeve të Huaja Direkte	134
	<i>4.5.1. Karakteristikat e prurjeve të IHD-ve, sipas formës</i>	<i>134</i>
	<i>4.5.2. Investimet e Huaja Direkte, sipas aktivitetit ekonomik.....</i>	<i>136</i>
	<i>4.5.3. Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, sipas vendit të origjinës.....</i>	<i>142</i>
4.6	Mjedisi shqiptar dhe Investimet e Huaja Direkte	147
4.7	Politikat dhe masat pro rritjes së IHD-ve në Shqipëri	153
4.8.	Pengesat për zhvillimin e IHD-ve në Shqipëri	165

KAPITULLI V: FAKTORËT PËRCAKTUES TË INVESTIMEVE TË HUAJA

	DIREKTE NË SHQIPËRI DHE ROLI I TYRE NË RITJEN	
	EKONOMIKE TË VENDIT.....	168
5.1	Hyrje	168
5.2	Modeli ekonometrik i gravitetit	170

5.3	Testimi i hipotezave, analiza dhe diskutimi i rezultateve	171
5.4	Roli i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike në Shqipëri	176
	5.4.1. Testimi i hipotezave me anë të modelit ekonometrik Granger	180
5.5	Përfundime dhe implikime të politikave	186

KAPITULLI VI: PËRFUNDIMI I PUNIMIT DHE REKOMANDIME

188

6.1	Përmbledhja dhe gjetjet empirike	188
6.2	Rekomandimet e nevojshme	191
6.3	Sugjerime për kërkime në të ardhmen	193

SHTOJCA

Shtojca A: Analiza empirike e të dhënave panel	195
Shtojca B: Analiza empirike e të dhënave të serive kohore	197

LISTA E REFERENCAVE	206
---------------------------	-----

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Përkufizimet që përdoren për identifikimin e IHD-ve në ekonomitë raportuese.	26
Tabela 2: Faktorët që ndikojnë në aktivitetet e IHD-ve, përgjatë viteve 1970 dhe 1990.	51
Tabela 3 : Rritja ekonomike në Evropën Juglindore (%).	67
Tabela 4 : Disa tregues makroekonomik të Evropës Juglindore.	68
Tabela 5: Stoku hyrës i IHD-ve.	76
Tabela 6: Stoku hyrës i IHD-ve, në raport me PPB-në, në 5 vende të EJT-së dhe 10 vende anëtare të reja të BE-së, në përqindje.	77
Tabela 7 : Stoku dalës i IHD-ve, në raport me PPB-në, në EJT-5 dhe EJT-10, në përqindje.	80
Tabela 8: Fluksi i IHD-ve për kokë banori në EJT-5 dhe BE-10 (në %).	81
Tabela 9: Indikatorët bazë ekonomik të vendeve të EJT-së dhe EJT-së.	83
Tabela 10: Flukset hyrëse të IHD-ve në vendet e EJT-së dhe EJT-së (milionë dollarë).	85
Tabela 11: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, 2007-13 (përqindja e totalit).	88
Tabela12: Stoku i IHD-ve në Bosnjë, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.	89
Tabela 13: Stoku i IHD-ve në Kroaci, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.	89
Tabela 14: Stoku i IHD-ve në Maqedoni, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.	90
Tabela 15: Stoku i IHD-ve në Serbi, sipas vendit të origjinës, 2005-2010.	91
Tabela 161. Treguesit e tranzicionit për vendet e EJT-së, mesatare 2000 – 2010.	97

Tabela 17: Kategori të ndryshme të IHD-ve në Shqipëri, 1992-2012.	120
Tabela 18: Fluksi i IHD-ve në Shqipëri, në raport me nivelin e IHD-ve në Evropën Juglindore dhe nivelin global të IHD-ve (mil. euro).	128
Tabela 19: Prurjet e IHD-ve si përqindje e GCFC-së, vendet e Evropës Juglindore, 2004–2013.	130
Tabela 20: Flukset hyrëse dhe dalëse të IHD-ve në Shqipëri, 1994-2013.	131
Tabela 21: Investimet e Huaja Direkte sipas formës, 2006-2011.	134
Tabela 22: Pagesat e të ardhurave nga IHD-të hyrëse dhe fitimet e riinvestuara në Shqipëri, 2008-2011 (në milionë euro).	136
Tabela 23: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas aktivitetit ekonomik (milionë euro).	138
Tabela 24: IHD-të hyrëse sipas projekteve, numri i investimeve dhe vlera e tyre.	141
Tabela 25: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, në milionë euro.	144
Tabela 26: Prurjet e IHD-ve në Shqipëri, sipas grup-shteteve.	146
Tabela 27: Treguesi i lehtësisë së të bërit biznes në rajon, për vitet 2013 dhe 2014.	162
Tabela 28: Treguesit e mjedisit të biznesit në Shqipëri, për vitet 2010-2014.	163
Tabela 29: Rezultatet empirike sipas metodologjisë së efekteve të rastit.	178
Tabela 30: Rezultatet e Granger-kausalitetit nga analiza VAR, sipas testit Wald.	184
Tabela 31: Testet për rrënjën njësi.	198
Tabela 32: Autokorrelacioni ndërmjet variablave.	199
Tabela 33: Zgjedhja e diferencimeve të përshtatshme sipas kritereve të informacionit AIC, HQIC dhe SBIC.	201

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Rritja ekonomike në Evropën Juglindore (%).	67
Figura 2: Fluksi hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë, në vendet e EJT-së.	86
Figura 3: Fluksi hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë, në vendet e EQL-së.	86
Figura 4: Fluksi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me vendet e EJT-së, 1990-2011(në milionë dollarë).	129
Figura 5: Mesatare e fluksit hyrës të IHD-ve në vendet e EJT-së, 2004-2013.	130
Figura 6: Stoku hyrës dhe dalës i IHD-ve në Shqipëri, 2004-2013.	132
Figura 7: Flukset hyrëse dhe dalëse të IHD-ve në Shqipëri, 2004-2013.	133
Figura 8: IHD-të sipas formës, 2006-2011.	135
Figura 9: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas aktivitetit ekonomik, për vitin 2012.	140
Figura 10: Prurjet e IHD-ve në Shqipëri, sipas grup-shteteve, 2004-2011.	147
Figura 11: Lehtësia e të bërit biznes, në Shqipëri dhe vendet e përfaqësuara, për vitet 2013 dhe 2014.	161
Figura 12: Paraqitja grafike e rolit të IHD-ve në nivel fluksi dhe stoku në PPB real.	183
Figura 13: Paraqitja grafike e relacionit ndërmjet fluksit të IHD-ve dhe PPB-së real (figura a) dhe stokut të IHD-ve dhe PPB-së real (figura b).	198

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORIT

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
ANI	Agjencia e Nxitjes së Investimeve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CEFTA	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë midis vendeve të Evropës Juglindore
EFTA	Marrëveshje e Shoqatës Europiane të Tregtisë së Lirë
EQL	Evropa Qendrore -Lindore
EJL	Evropa Juglindore
EZ	Eurozona
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ICSID	Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
KSHK	Kompani Shumëkombëshe
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
UNCTAD	United Nation Conference on Trade and Development
WIR	Raporti i Investimeve Botërore
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
QKL	Qendra Kombëtare e Licensimit

KAPITULLI I: HYRJE

Investimet e Huaja Direkte janë promovuar nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare si një motor që luajnë një rol kryesor në tranzicionin e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore (EQL), nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu, dhe integrimin e tyre në ekonomi botërore (Ridgway, 2004). Në literaturë dhe në praktikën e shumë vendeve të zhvilluara janë të njohura efektet pozitive që sjellin Investimet e Huaja Direkte (IHD) në rritjen ekonomike dhe në standardin e jetesës. Shumë vende në zhvillim kanë përfituar nga flukset e kapitalit në formën e IHD-ve. Duke luftuar mungesën e kapitalit nga e cila vuanin tregjet e mbyllura, ata kanë favorizuar krijimin e tregut të madh, duke u shoqëruar me rritje të efektshmërisë të firmave, gjë që do të shoqërohej me ulje çmimesh dhe rritje të konkurrencës në tregjet e huaja. Megjithatë, vendet në tranzicion të Rajonit të Evropës Juglindore, në krahasim me vendet e Bashkimit Europian (BE) kanë mbetur mbrapa në drejtim të avancimit të performancës ekonomike, për shkak të krizave të ndryshme politike dhe ekonomike që Rajoni i Evropës Juglindore (EJL) ka kaluar gjatë dy dekadave të fundit. Përparimi i ngadalshëm i këtyre vendeve gjithashtu mund t'i atribuohet edhe politikave jo të qëndrueshme dhe jostabilizuese makroekonomike. Në kontekstin global, vendet në tranzicion të Rajonit të Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore, kanë realizuar hyrje të vogël të Investimeve Direkte të Huaja, në raport me vendet e tjera me zhvillim më të qëndrueshëm (UNCTAD, 2011). Sidoqoftë, kjo situatë është përmirësuar gjatë kohës, duke shënuar rritje të Investimeve Direkte të Huaja, në bilancet e pagesave të vendeve të Evropës Juglindore. Edhe Shqipëria, si një vend i Rajonit të Evropës Juglindore, me vendosjen e saj strategjike në Ballkanin Perëndimor, me një ekonomi tregu në zhvillim,

me një fuqi punëtore të re, dinamike, të arsimuar dhe me kosto konkurruese krahasuar me rajonin, ofron mundësi të shumta për investitorët e huaj.

Pikërisht, duke konsideruar rëndësinë e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) për rajonin e EJT-së në përgjithësi dhe për Shqipërinë në veçanti, në këtë punim do të trajtoj dhe analizoj procesin dhe politikat që kanë ndikim në vendimet e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri. Bazuar në rezultatet e studimit, punimi do të japë rekomandimet për politikëbërësit shqiptar për nxitjen e IHD-ve në Shqipëri. Për të trajtuar këtë çështje hulumtimi me hollësi, punimi i doktoraturës do të bazohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e punimit do të merret me vlerësimet e faktorëve përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri. Duke përdorur modelin e gravitetit, do të analizojmë nëse IDH-të në këto vende motivohen nga faktorët e kërkuarve të tregut, nga faktorët e kërkuarve të burimeve apo nga faktorët e kërkuarve të efikasitetit.

Pjesa e dytë e punimit do të vlerësojë efektin e IHD-ve në rritjen ekonomike në Shqipëri, duke përdorur analizën empirike mbështetur në të dhëna të serive kohore. Analiza ekonometrike për trajtim të rritjes ekonomike në Shqipëri do të mbështetet në modelin ekonometrik Granger të shkakshmërisë.

1.1 Qëllimi i studimit

Shqipëria është një vend i Rajonit të Evropës Juglindore. Ashtu si në vendet e rajonit, edhe në Shqipëri vitet '90-të ishin vitet e ndryshimeve të mëdha. Ekonomia e centralizuar që kishte sunduar për afër një gjysmë shekulli, u zëvendësua nga sistemi i ekonomisë së tregut që do të sillte ndryshime rrënjësore në ekonomi. Aktualisht, Shqipëria është një nga vendet potenciale që synon të bëhet pjesë e Bashkimit Europian,

status ky që kërkon një ekonomi tregu funksionale që të jetë në gjendje të përballojë presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së.

Gjithashtu, Investimet e Huaja Direkte vazhdojnë të jenë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ata sigurojnë investime të nevojshme për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e teknologjisë, kur kursimet e brendshme nuk mund t'i sigurojnë ato.

Parë në këtë kuptim, qëllimi kryesor i këtij punimi është të trajtojë lidhjen e Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes ekonomike në Shqipëri. Është parë me interes të trajtohet kjo lidhje, sepse sot më shumë se kurrë po i kushtohet vëmendje rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, jo vetëm nga specialistë të fushës apo qeveritarë, por edhe nga individët e thjeshtë. Ky interesim për rritjen ekonomike lidhet me rëndësinë e madhe që ka rritja ekonomike për shoqërinë në tërësi dhe për individët në veçanti. Më shumë rritje ekonomike do të thotë më shumë të ardhura për frymë, do të thotë më shumë të mira dhe shërbime të konsumuara që të çojnë në një nivel më të lartë jetese, që është edhe qëllimi final i të gjitha ekonomive. Gjithashtu, në këtë punim do të trajtojmë edhe faktorët përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri, duke përdorur metodologji të avancuara ekonometrike dhe në këtë mënyrë do t'i kontribuojë evidencës empirike nga lëmia e IDH-ve. Një qëllim tjetër për ndërmarrjen e këtij studimi është informacioni potencial që punimi empirik mund t'u japë investitorëve të huaj, investitorëve potencial dhe ekspertëve të interesuar, në lidhje me zhvillimet, ndikimin e IHD-ve dhe implikimin e politikave më të favorshme për rritjen e IDH-ve në Shqipëri. Ky punim jep mesazhe praktike në ndihmë të autoriteteve të vendit për të kuptuar më mirë ndikimin potencial të IHD-ve në rritjen ekonomike në ekonominë

shqiptare dhe për ta përdorur këtë informacion më pas dhe gjatë procesit të vendimmarrjes.

1.2 Objektivat e studimit

Investimet e Huaja Direkte janë konsideruar si një nga faktorët kryesorë që përcaktojnë ritmet e rritjes ekonomike të vendeve në tranzicion. Rritja e fluksit të IHD-ve bëri të mundur liberalizimin e thellë dhe transformimin e ekonomive të Rajonit të Evropës Juglindore, duke nxitur hapjen dhe integrimin e ekonomive të vendeve në tranzicion në tregjet botërore. Përveç kësaj, qëndrimi i vendeve në tranzicion drejt anëtarësimit në Bashkimin European ka bërë të mundur rritje të rrjedhave të Investimeve të Huaja Direkte që do të reflektojnë perspektiva më të favorshme ekonomike të vendeve në tranzicion dhe do të lehtësojnë sfidat e mundshme të këtyre vendeve për t'u ballafaquar me presionet e tregjeve evropiane. Pavarësisht rolit vendimtar të luajtur nga IHD-të në ekonominë e vendeve në tranzicion, e me theks të posaçëm në Shqipëri, evidenca empirike në dispozicion është jo e mjaftueshme, duke qenë në përgjithësi e një natyrë përshkruese.

Objektivi kryesor i këtij punimi është të japë disa prova më të fuqishme empirike, duke testuar hipotezat që shpjegojnë sjelljet e flukseve të IHD-ve në Shqipëri, duke nxjerrë përfundimet dhe dhënë rekomandimet e nevojshme për çështjet e trajtuara. Gjithashtu, duke patur parasysh qëllimin dhe karakterin e këtij punimi, synohet në realizimin edhe të disa objektivave të tjerë, si:

- Studimi, analizimi dhe debati teorik midis teorive dhe pikëpamjeve mbi IHD-të.
- Evidentimi i faktorëve që ndikojnë në aktivitetin e IHD-ve në ekonomi.

- Analizë e detajuar e nivelit të IHD-ve në vendet në tranzicion të Evropës Juglindore, duke bërë një krahasim midis këtyre vendeve.
- Analizë dhe një përshkrim të mjedisit shqiptar për sa i përket problemeve aktuale dhe sfidave për të ardhmen në lidhje me Investimet e Huaja Direkte.
- Analizimi i faktorëve përcaktues të IHD-ve në Shqipëri me anë të modelit ekonometrik të gravitetit.
- Analizë empirike mbi rolin e IHD-ve në rritjen ekonomike në Shqipëri. Kjo analizë do të bazohet në një model ekonometrik të shkakshmërisë Granger.
- Arritja e përfundimeve dhe dhënia e rekomandimeve për politikëbërësit në Shqipëri.

Hulumtimet e mëparshme që lidhen me faktorët përcaktues të IHD-ve në vendet në tranzicion, kanë vlerësuar kryesisht faktorët tradicionalë si të madhësisë së tregut, që janë të rëndësishme për Investimet e Huaja Direkte në ekonomitë e vendeve në tranzicion (Skuflic dhe Botric, 2006) dhe faktorët e gravitetit që shpjegojnë modelin e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore (Mateev, 2008). Faktorë të tjerë që janë gjetur të kenë efekt të rëndësishëm janë afërsia gjeografike, pengesat për tregtinë, politika tatimore dhe stimujt e taksave, shpenzimet e punës dhe integrimi rajonal. Demekas et al. (2005) vërtetoi që faktorë të gravitetit shpjegojnë një pjesë të madhe të flukseve të IHD-ve në ekonomitë në tranzicion, duke përfshirë vendet e Evropës Juglindore, pa harruar gjithashtu edhe mjedisin e biznesit dhe mjedisin politik, të cilët kanë rëndësi të veçantë për Investimet e Huaja Direkte. Janicki dhe Wunnava (2004) sugjerojnë që tregtia ndërkombëtare është ndoshta faktori më përcaktues dhe më i rëndësishëm i Investimeve të Huaja Direkte në vendet me ekonomi në tranzicion. Prandaj, duke pasur parasysh ambiciet e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e strukturës së BE-së, pritët që gjetjet empirike

të punimit të ofrojnë kornizën e përshtatshme analitike që do të ishte e dobishme për politikëbërësit shqiptar për të vendosur cilat politika makroekonomike dhe institucionale duhen aplikuar, në mënyrë që të ndikojnë në rritjen e fluksit hyrës të IHD-ve në vend.

1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit

Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi thelbësore për projektin e studimit dhe i japin hulumtuesit kahjen e shqyrtimeve. Pyetja e hulumtimit ka funksion të dyfishtë: ajo shpreh qëllimin e projektit të hulumtimit, por edhe na jep drejtim në procesin e hulumtimit. Në thelb, po nuk pati pyetje, nuk gjen dot as përgjigje. Në funksion të qëllimit dhe arritjes së objektivave të punimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat që trajtohen në këtë studim janë:

Pyetja kërkimore 1:

A janë faktorët gjeografik, si madhësia e ekonomisë së vendeve shprehur përmes Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe PBB-së për frymë, si dhe distanca ndërmjet vendeve respektive, faktorë të rëndësishëm të cilët shpjegojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?

Për t'iu përgjigjur pyetjes së parë kërkimore, në këtë punim do të testojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto në vendet origjinë të Bashkimit European, është faktor i parëndësishëm në përcaktimin e flukseve të IHD-ve, nga vendet origjinë të BE-së në drejtim të Shqipërisë.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto në vendet origjinë të Bashkimit European, është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e flukseve të IHD-ve, nga vendet origjinë të BE-së në drejtim të Shqipërisë.

Hipoteza 2:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto në Shqipëri, është faktor i parëndësishëm në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto në Shqipëri, është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Hipoteza 3:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto për frymë, është i faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto për frymë, është i faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Hipoteza 4:

Ho: Distanca është faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Distanca është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Pyetja kërkimore 2:

A janë faktorët e tranzicionit, të institucioneve apo të mjedisit të biznesit faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?

Për t'iu përgjigjur pyetjes së dytë kërkimore, në këtë punim do të testojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1:

Ho: Progresi i tranzicionit është faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Progresi i tranzicionit është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Hipoteza 2:

Ho: Zhvillimi i institucioneve është faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Zhvillimi i institucioneve është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Hipoteza 3:

Ho: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Pyetja kërkimore 3:

A ekziston ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes ekonomike në Shqipëri?

Për t'iu përgjigjur pyetjes së tretë kërkimore do të testojmë hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1:

Ho: Nuk ekziston lidhje shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri.

Ha: Ekziston lidhje shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri.

Hipoteza 2:

Ho: Nuk ekziston lidhje shkakësore ndërmjet rritjes ekonomike dhe IHD-ve në Shqipëri.

H1: Ekziston lidhje shkakësore ndërmjet rritjes ekonomike dhe IHD-ve në Shqipëri.

1.4 Metodologji e studimit

Për realizimin e këtij punimi, në fillim do të studiojmë literaturën teorike në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivit kryesor të këtij studimi. Në pjesën teorike, përmes studimit të literaturës do të trajtojmë kuadrin teorik për Investimet e Huaja Direkte, faktorët përcaktues, si dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve të Rajonit të Evropës Juglindore. Konkretisht, kryerja e këtij studimi është konceptuar të kalojë në katër faza.

1. Faza e parë: faza përgatitore, e cila përfshin shqyrtimin e literaturës së nevojshme në funksion të qëllimit të studimit, e cila është një nga fazat më të rëndësishme në kryerjen e çfarëdolloj hulumtimi. Pas studimit të literaturës, karakteristikë për këtë fazë është përzgjedhja e teorive kryesore dhe disa punime që kanë kryer autorë të huaj dhe vendas në lidhje me temën e studimit. Kreu i dytë i këtij punimi është mbështetur kryesisht në literaturën e huaj, konkretisht në këtë pjesë të punimit

përshkruhen teoritë kryesore mbi Investimet e Huaja Direkte. Pasi kemi krijuar kuadrin teorik, për qëllimin e studimit, hartojmë pyetjet dhe hipotezat e kërkimit.

2. Faza e dytë: mbledhja e të dhënave, përfshin procesin gjatë të cilit mblidhen të dhënat, grupohen dhe interpretohen. Të dhënat e mbledhura në këtë fazë janë lëndë e parë për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve të hulumtimit. Nga saktësia dhe cilësia e të dhënave do të varet edhe suksesi i fazës më pas të analizës së të dhënave. Si burim të dhënash për studimin kanë shërbyer: UNSTAD, BB, OECD, BERZH, FMN, Banka e Shqipërisë etj.
3. Faza e tretë: analiza e të dhënave, gjatë të cilës përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbullura. Të dhënat nuk janë vetëshpjeguese. Ato duhen analizuar, vlerësuar, shpjeguar dhe interpretuar. Karakteristikë për këtë fazë është dhënia e përgjigjes për pyetjet e hulumtimit dhe testimi i hipotezave me anë të modelit ekonometrik.
4. Faza e katërt, paraqitja e rezultateve dhe dhënia e rekomandimeve të nevojshme.

Konkretisht: *Për t'u përgjigjur për pyetjen e parë dhe të dytë kërkimore*, do të studiojmë literaturën teorike që pasqyron faktorët përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte, duke u mbështetur në teoritë e IHD-ve. Përmes modelit të gravitetit që aplikojmë në këtë studim, do të pasqyrojmë evidencë të përshtatshme empirike, që trajton faktorët përcaktues të flukseve të IHD-ve, nga 14 vendet origjinë të Bashkimit Europian në Shqipëri, si vend nikoqir i IHD-ve. Shqipëria është zgjedhur si vend i veçantë, në mënyrë që të shohim se si modeli i gravitetit që shpjegon flukset bilaterale të IHD-ve, vlen për një vend në tranzicion orientuar drejt zhvillimit ekonomik. Në punim, përveç variablave tradicionale të përcaktuesve të IHD-ve, në mënyrë që të trajtojmë klimën e investimeve në ekonominë në tranzicion, do të përfshijmë disa variabla politike dhe

institucionale, të tilla si: indekset e qeverisjes së mirë, indekset e mjedisit të biznesit të siguruar nga Banka Botërore dhe indekset e tranzicionit të siguruar nga Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH). Faktorët politikë dhe institucionalë trajtohen nga Komisioni Evropian si ndër më të rëndësishmit për pranimin e vendeve pretendente në struktura të BE-së. Për më tepër, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë politikash të rëndësishme në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor për të lehtësuar dhe nxitur investitorët e huaj që të investojnë në Shqipëri. Në pjesën e parë të kapitullit empirik do të aplikojmë model graviteti për të vlerësuar faktorët përcaktues të fluksit të IHD-ve në Shqipëri, duke u mbështetur më tepër në faktorët institucionalë, të tranzicionit dhe mjedisit të biznesit, të cilët shpjegojnë flukset bilaterale të Investimeve të Huaja Direkte.

1.4.1 Modeli teorik i gravitetit

Në vitet e fundit, analizat empirike bazuar në modelin e gravitetit, janë përdorur në mënyrë intensive në studimet empirike të flukseve tregtare dhe flukseve të IHD-ve. Modeli bazohet në ligjin universal të gravitetit të zhvilluar nga Newton. Ky ligj thekson se të gjithë objektet tërhiqen njëri me tjetrin me një forcë tërheqëse gravitacionale që proporcionalisht varet në mënyrë direkte nga masa e trupave të dy objekteve që tërhiqen dhe inversi i katrorit të distancës që ndan qendrat e dy objekteve (Anderson, 1979). Në terma ekonomik, në kushte të studimeve të flukseve të IHD-ve, ky model do të thotë që fluksi i IHD-ve në mes dy vendeve (tërheqja gravitacionale) përcaktohet nga Produktet e Përgjithshme Bruto (PPB-të) të dy vendeve (masat e tyre) dhe inversi i distancës

ndërmjet dy qendrave (përgjithësisht, distanca ndërmjet kryeqyteteve të vendeve respektive).

Modeli i thjeshtë i gravitetit mund të specifikohet si:

$$F_{ij} = A \times Y_i Y_j \frac{1}{D_{ij}} \quad (5.1)$$

Ku F_{ij} qëndron për vlerën e fluksit të IHD-ve nga vendi i në vendin j ,

Y_i dhe Y_j paraqesin vlerat respektive të të ardhurave kombëtare të vendeve i dhe j .

A paraqet konstanten e proporcionalitetit.

D_{ij} është matës i distancës ndërmjet vendeve i dhe j . Në kuptimin ekonomik, distanca mund të konsiderohet si matës i kostos së transaksioneve dhe kostos fizike që lidhet me lëvizshmërinë e kapitalit nga vendi i në vendin j .

Këto kosto, në përgjithësi, përfshijnë: kostot e transportit, kostot e barrierave gjuhësore dhe kulturore ndërmjet vendeve i dhe j , kostot e lëvizshmërinë së personelit, si dhe kostot e informacioneve që lidhen me faktorët institucional dhe legal, si p.sh.: ligjet mbi të drejtat në pronësi, nomenklaturën e rregullave ligjore të vendeve respektive dhe sistemin e taksave.

1.4.2 Arsyetimi ekonometrik i metodologjisë dhe arsyetimi i modelit të zgjedhur

Në këtë punim kemi përdorur metodologji të ndryshme për të vlerësuar faktorët përcaktues të fluksit hyrës të IHD-ve në Shqipëri, nga 14 vende origjinë të Bashkimit European. Në këtë mënyrë, në studim kemi trajtuar panelin statik, duke përdorur metodologji të OLS-së (përmes shumës së katrorëve të vegjël), efekteve fikse dhe efekteve të rastit (efekteve random), si dhe teknikën e realizueshme të shumës së katrorëve të përgjithësuar (Feasible GLS). Sidoqoftë, disavantazhi i këtyre teknikave

është eliminimi i observimeve të fluksit të IHD-ve, me vlera zero ndërmjet vendeve për vite të caktuara (Henderson & Millimet, 2008). Prandaj, të dhënat bilaterale të IHD-ve, veçanërisht, të dhënat e fluksit të IHD-ve nga vendet origjinë të 14 shteteve, në drejtim të Shqipërisë, paraqesin problem statistikor në matje, për arsye të ekzistencës së një numri të madh observimesh me vlera zero ose negative në matricën e fluksit bilateral të IHD-ve. Në këtë rast, për të eliminuar këtë problem, duke ndjekur metodologjinë e aplikuar nga Eichengreen dhe Irwin (1996), transformojmë variablën varëse, duke kalkuluar logaritmin e vlerës absolute të IHD-ve, shtuar me 1. Përmes këtij transformimi të variablës varëse, eliminojmë problemin e observimeve me vlerë zero dhe negative, dhe koeficientët nga regresioni i shumës së katrorëve të vegjël (OLS-SHKV) mund të interpretohen si elasticitete për vlera të mëdha të variablës varëse. Në këtë rast, plotësojmë kushtin për të aplikuar metodologjinë Tobit me efekte të rastësishme për vlerësim të koeficientëve të regresionit. Testet e diagnostifikimit dhe testet e nevojshme për të zgjedhur modelin e preferuar janë paqyruar te shtojca A.

1.4.3 Përshkrimi i të dhënave

Investimet e Huaja Direkte: *Variabla varëse IHD_{ijt}*, tregon fluksin bilateral të IHD-ve nga vendet origjinë *i* në vendet pritëse *j* në kohën *t*, në çmimet aktuale dhe kursin aktual të këmbimit, në milionë dollarë amerikanë. Burimi i të dhënave për këtë variabël është OECD. Variabla e fluksit bilateral të IHD-ve, për arsye të prezencës së një numri të madh observimesh me vlera zero dhe negative në matricën e saj, është korrigjuar, duke konsideruar logaritmin e vlerës absolute të fluksit bilateral të IHD-ve, shtuar me 1.

Faktorët e gravitetit

Produkti i Përgjithshëm Bruto dhe Produkti i Përgjithshëm Bruto për frymë: ($\ln PPB_{ijt}$ dhe $\ln PPB_{k(i)t}$). Literatura empirike sugjeron relacion pozitiv në mes matësve të madhësisë së tregut, shprehur përmes LPPB-së dhe nivelit të IHD-ve (Resmini, 2000), si dhe relacion pozitiv në mes PPB-së për frymë dhe fluksit të IHD-ve. Sidoqoftë, shenja e PPB-së për frymë në relacion me fluksin e IHD-ve mund të jetë pozitive ose negative varësisht prej faktorëve strategjik që ndikojnë në fluksin e IHD-ve. Nëse IHD-të në vendet e EJL-së udhëhiqen nga faktorët intensiv të kapitalit (faktorët intensiv të punës), në atë rast PPB -ja për frymë është në relacion pozitiv (negativ) me fluksin e IHD-ve (Bergstrand, 1989).

Distanca: (LD_{ij}) Distanca, paraqet matësin specifik të faktorëve të gravitetit. Literatura empirike sugjeron relacion negativ në mes matësve të kostos së distancës ndërmjet vendeve dhe fluksit të IHD-ve si rezultat i adaptimit të kushtueshëm të të mirave për preferencat lokale dhe kostos së lartë të transportit (Bevan and Estrin, 2004). Variabla e distancës matet me distancën rrugore aktuale ndërmjet qendrave ekonomike (përgjithësisht, kryeqyteteve) ndërmjet vendeve origjinë dhe vendeve thithës të IHD-ve. Burimi i të dhënave për këtë variabël është: <http://www.geobytes.com>.

Faktorët institucional

Evidenca empirike, sugjeron se faktorët institucional janë të rëndësishëm për fluksin bilateral të IHD-ve, ndërmjet vendeve. Në këtë këndvështrim, cilësia e institucioneve është faktor i rëndësishëm për fluksin hyrës të IHD-ve, për vendet e EJL-së, pasi cilësia e ulët e institucioneve mund të reduktojë aktivitetin e IHD-ve, si rezultat i rritjes së kostos të operacioneve të biznesit (Kinoshita & Campos, 2004). Në këtë studim,

kualitetin e institucioneve e matim përmes indikatorëve të qeverisjes globale, që sigurohen nga Banka Botërore, ku përfshihen gjashtë matësit relevant në vlera të ranguara të përqindjeve, si: *kontrolli i korrupsionit, zbatimi i ligjit, rregullimi i politikës qeveritare, efektiviteti qeveritar, llogaridhënia institucionale edhe riskun politik*. Këta matës institucional janë të përfshirë në model në interkasion me variablën varëse të korrigjuar për një periudhë, IHD_{ijt-1} .

Kontrolli i korrupsionit, paraqet perceptimet e nivelit në të cilin fuqia publike e politikëbërjes ushtrohet për përfitime private, përmes formave të korrupsionit shtetëror, duke përfshirë të dy llojet e korrupsionit: korrupsionin në formë shërbimesh dhe korrupsionin në formë grantesh qeveritare.

Rregullimi i politikës qeveritare, paraqet matjen e perceptimeve lidhur me aftësinë e qeverisë për të formuluar dhe implementuar politika dhe rregulla qeveritare, që promovojnë zhvillimin e sektorit privat.

Efektiviteti Qeveritar, mat perceptimet për cilësinë e shërbimeve publike të ofruara nga qeveria e Shqipërisë, si kualiteti i shërbimeve civile dhe kualiteti i pavarësisë së këtyre shërbimeve nga presionet politike, kualitetin e formulimit të politikave publike dhe implementimit të tyre, si dhe kredibilitetin e përcaktimeve qeveritare ndaj këtyre politikave.

Zbatimi i ligjit, mat perceptimet e nivelit në të cilin agjentët ekonomikë shfaqin besueshmëri në rregullat dhe ligjet mbi bazën e të cilëve organizohet shoqëria, dhe në veçanti rregullave dhe ligjeve mbi bazën e të cilëve rregullohen punët kontraktuale ndërmjet agjentëve ekonomikë, ligjeve të pronësisë dhe të gjykatave, si dhe ligjeve që parandalojnë krimet dhe dhunën në vend.

Llogaridhënia institucionale, paraqet perceptimet që lidhen me zhvillimet e qytetarisë aktive, zgjedhjes së qeverive me anë të zgjedhjeve të lira, si dhe perceptimet mbi zhvillimet demokratike, të shprehjes së lirë të mediave.

Stabiliteti politik, paraqet perceptimet që sistemi politik i vendit të dëmtohet me metoda jokushtetuese, duke përfshirë dhunën e motivuar politikisht dhe terrorizmin. Burimi i të dhënave për këta indikatorë është Banka Botërore. Për arsye të efektit të korrelacionit ndërmjet variablave institucionale, në model këta variabla nuk janë përfshirë veç e veç. Për eliminimin e efekteve të multikolinearitetit ndërmjet variablave, kemi konstruktuar variablën **inst**, që paraqet shumën totale të të gjashtë variablave në fjalë, shprehur në logaritëm. Efekti i pritur i zhvillimeve institucionale në Shqipëri, mbi flukset bilaterale të IHD-ve nga vendet origjinë të BE-14 në Shqipëri, është i panjohur, për arsye të prezencës së të gjithë treguesve institucional në variablën e konstruktuar mbi zhvillimet institucionale. Për shembull, në kuadër të variablës *inst*, risku politik dhe kontrolli i korrupsionit priten të jenë në relacion negativ me flukset bilaterale të IHD-ve, ndërsa treguesit e tjerë, si: rregullimet e politikës qeveritare, llogaridhënia institucionale, rregulla e ligjit dhe efektiviteti i politikës qeveritare priten të jenë në relacion pozitiv mbi flukset bilaterale të IHD-ve. Prandaj, hipoteza që ndërtojmë mbi ndikimin e zhvillimeve institucionale në flukset bilaterale të IHD-ve nuk është specifike, por duale, si rezultat i prezencës së indikatorëve institucional që priten të kenë efekte të kundërta mbi flukset bilaterale të IHD-ve.

Faktorë të tranzicionit

Për të analizuar treguesit e tranzicionit si faktorë shpjegues të flukseve bilaterale të IHD-ve, kemi konsideruar treguesin e *progresit të tranzicionit*. Ky tregues matet përmes

shumës së indekseve të reformave të përgjithshme infrastrukturore, reformave në sistemin bankar, reformave në politikën tregtare dhe kursin e jashtëm të këmbimit dhe reformave në tregjet e sigurimeve dhe institucioneve financiare jo bankare. Në mënyrë të njëjtë, për arsye të efekteve të multikolinearitetit, këtë variabël e kemi konstruktuar si shumë totale të indekseve të tranzicionit që raportohen nga Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH, EBRD). Pritet që progresi i tranzicionit të jetë në relacion pozitiv me fluksin bilateral të IHD-ve. Burimi i të dhënave për këtë variabël është Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim.

Faktorët e mjedisit të biznesit

Për të reflektuar zhvillimet në mjedisin e biznesit, në model kemi trajtuar variablën *Zjt*, që paraqet zhvillimet në mjedisin e biznesit në Shqipëri. Ky variabël është paraqitur në model për të trajtuar ndikimin e klimës së biznesit në flukset bilaterale të IHD-ve në Shqipëri. Ky tregues është paraqitur në model, në pajtueshmëri me perceptimet mbi faktorët kërkues të efencës, që shpjegojnë flukset bilaterale të IHD-ve, ndërmjet vendeve. *Variabla Zjt* është konstruktuar mbi bazën e shumës totale të gjashtë treguesve kryesorë që ndikojnë për zhvillimet në mjedisin e biznesit në Shqipëri. Treguesit mbi zhvillimet në mjedisin e biznesit raportohen për kohë të nevojshme për zhvillim të një aktiviteti të caktuar biznesor, matur kryesisht me numër ditësh. Treguesit kryesorë përfshijnë: ditët e nevojshme për fillimin e biznesit, për regjistrim të pasurisë, për pagesë të taksave, për fuqizim të kontratave, për zhvillim të tregtisë, dhe ditët e nevojshme për zgjidhje të rasteve të mospagesës. Burimi i të dhënave për këta tregues është Banka Botërore.

Implikimi kryesor që zhvillohet për të trajtuar hipotezën e ndikimit të mjedisit të biznesit në flukset bilaterale të IHD-ve ndërmjet 14 vendeve origjinë të BE-së dhe Shqipërisë është që, klima më e favorshme e biznesit pasohet me flukse të larta thithjesh të IHD-ve në Shqipëri nga 14 vende të Bashkimit European. Pasi variabla e mjedisit të biznesit matet me numër ditësh për kryerje të një aktiviteti të caktuar biznesi, në këtë rast pritet relacion negativ në mes faktorit që reflekton zhvillimet në mjedisin e biznesit dhe flukseve bilaterale të IHD-ve, ndërmjet vendeve, pasi numri më i madh i ditëve për zhvillim të një aktiviteti të caktuar biznesi, si: shlyerje detyrimesh, regjistrim të pasurisë, fuqizim të kontratave, zhvillim të tregtisë dhe zgjidhje të rasteve të josolences, është tregues i një mjedisi dhe klime jo të përshtatshme biznesi.

Për t'u përgjigjur në pyetjen e tretë kërkimore, do të trajtojmë lidhjen kauzale ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, përgjatë periudhës 1994-2010. Për këtë qëllim, do të shërbelemi me metodologji të avancuar ekonometrike të serive kohore të vektorëve autoregresiv. Të dhënat për Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri do të bazohen në dy nivele: në nivel fluksi dhe stoku. Me fjalë tjera, duke aplikuar testin e shkakshmërisë Granger, punimi do të trajtojë lidhjen kauzale ndërmjet IHD-ve, në nivel fluksi dhe stoku, nga njëra anë, dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, nga ana tjetër. Në këtë pjesë të këtij punimi do të fokusohemi më shumë në marrëdhëniet shkakësore midis rritjes ekonomike nga njëra anë, dhe IHD-ve nga ana tjetër, duke përdorur metodologjinë Granger Causality. Autorë të ndryshëm kanë aplikuar metodologjinë Granger për të testuar lidhjen shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe PPB-së, dhe PPB-së dhe IHD-ve. Me fjalë tjera, duke aplikuar testin e shkakshmërisë Granger, punimi do të trajtojë lidhjen kauzale ndërmjet IHD-ve, në nivel fluksi dhe stoku nga njëra anë, dhe rritjes ekonomike në Shqipëri, nga ana tjetër; dhe anasjelltas nëse ndryshimet në nivelin

e PPB-së reale do të përgjigjen me ndryshime në nivelin e IHD-ve. Me analizë të regresionit, ne vlerësojmë nëse rritja ekonomike është faktor i rëndësishëm për të inkurajuar rritjen e nivelit të IHD-ve në vendin pritës (Shqipërisë). Me fjalë të tjera, synojmë të gjejmë nëse ndryshimet në nivelin e PPB-së reale do të përgjigjen me ndryshime në nivelin e IHD-ve.

1.5 Kufizimet e studimit

Kufizimet e këtij studimi lidhen me të dhënat, teknikat e vlerësimit, variablat e përdorur dhe mostra. Madhësia e mostrës së përdorur në këtë punim është e kufizuar në 14 vende partnerë të Investimeve të Huaja Direkte për Shqipërinë. Megjithatë këto vende përfshijnë rreth 70 për qind të fluksit dalës të IHD-ve, në drejtim të Shqipërisë, disa partnerë të rëndësishëm që paraqiten si investues potencial për Shqipërinë, si: SHBA-ja, Turqia, Norvegjia, Zvicra dhe Kanadaja nuk janë të përfshira në mostrën e vendeve burimore të IHD-ve. Një studim tjetër, ku më shumë se 14 vende do të paraqiten si vende origjinë për investimet shqiptare, do të përmirësonte dukshëm rezultatet e punimit. Modeli në studimin empirik lidhur me faktorët përcaktues të IHD-ve, nuk konsideron shpenzimet qeveritare dhe rreziqet e investimeve, për shkak se ky studim është fokusuar vetëm në marrëdhëniet ekonomike në mes Shqipërisë dhe BE-së. Në këtë drejtim, modeli i studimit që shpjegon faktorët përcaktues të IHD-ve, në përgjithësi, është i krahasueshëm me modelet e gravitetit të përdorura në studime të tjera. Të dhënat mbi variablat shpjegues janë mbledhur nga burime të ndryshme, të cilat përmbajnë një shumëllojshmëri përkufizimesh që udhëhiqen sipas fakteve të ndryshëm dhe kriterëve të ndryshëm për vlerësim të të dhënave agregate. Prandaj, rezultatet e punimit duhet të

interpretohen me kujdes, pasi ato janë të bazuara në burime të të dhënave nga baza të ndryshme të dhënash, si: OECD, BB, UNCTAD, WGI dhe BERZH. Gjithashtu, statistikatat e IHD-ve hartohen dhe prezantohen nga vendet sipas udhëzimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Ekzistojnë vështirësi praktike, sidomos për vendet në zhvillim, ku qeveritë jo gjithmonë kanë mjetet e nevojshme për mbledhjen e të dhënave statistikore në mënyrë sistematike. Për më tepër, edhe vendet e zhvilluara që kanë mekanizmat e nevojshëm për mbledhjen e të dhënave, kanë vështirësi. Këto vështirësi burojnë nga fakti se secili vend përdor metoda dhe standarde të ndryshme kontabiliteti, si dhe koncepte e përkufizime të ndryshme, duke u bërë shpesh subjekt edhe i gabimeve.

1.6 Organizimi i studimit

Punimi i doktoraturës është i organizuar në gjashtë kapituj:

Kapitulli i parë paraqet hyrjen, qëllimin, objektivat e hulumtimit, pyetjet kërkimore, hipotezat, metodologjinë e studimit, si dhe kufizimet e punimit.

Në kapitullin e dytë trajtohen në mënyrë të hollësishme teoritë kryesore të IHD-ve. Në këtë kre trajtohen:

- Përkufizimi dhe kuptimi i IHD-ve.
- Klasifikimi dhe format kryesore të IHD-ve.
- Teoritë kryesore mbi IHD-të, si: teoria neoklasike, teoria monopoliste, teoria zëvendësuese, teoria plotësuese, teoria e cilkit të jetës së produktit, teoria elektrike e Dunning, teoria e kostos së transaksioneve, teoria që bazohet në

resurset ekonomike, teoria që bazohet në rrjetin e biznesit, si dhe teoria strategjike e Porter-it.

- Klasifikimi alternativ i teorive mbi faktorët përcaktues të IHD-ve që mbështeten në teorinë e Lokacionit të IHD-ve, si: IHD-të që mbështeten në faktorë kërkues të tregjeve, IHD-të që mbështeten në faktorë kërkues të burimeve dhe IHD-të që mbështeten në faktorë kërkues të efikasitetit.
- Investimet e Huaja Direkte dhe rritja ekonomike.

Kapitulli i tretë i kushtohet Investimeve të Huaja Direkte në rajonin e Evropës Juglindore, duke trajtuar disa çështje me rëndësi, si:

- Rëndësia e IHD-ve gjatë tranzicionit në vendet e EJT-së.
- Zhvillimi ekonomik dhe problematika në Evropën Juglindore.
- Dinamika dhe trendi i IHD-ve në vendet në tranzicion të Evropës Juglindore.
- IHD-të në vendet e rajonit të EJT-së sipas vendit të origjinës.
- IHD-të në Evropën Juglindore dhe marrëdhënia e tyre me treguesit e tranzicionit.

Në kapitullin katërt trajtohen Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri. Në këtë kapitull trajtohen këto çështje kryesore:

- Tranzicioni në Shqipëri dhe sfidat drejt Bashkimit Europian.
- Profili i IHD-ve në Shqipëri.
- Trendi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me vendet e EJT-së dhe tendencat globale.
- Aspekte kryesore të stokut të IHD-ve.
- Mjedisit shqiptar dhe Investimet e Huaja Direkte.

- Pengesat për zhvillimin e IHD-ve në Shqipëri.

Kapitulli i pestë, në funksion të qëllimit të këtij punimi, do të mbështetet në zhvillimin e pjesës empirike të studimit, duke ekzaminuar kështu empirikisht faktorët përcaktues të flukseve hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri nga 14 vendet origjinë të Bashkimit European. Këto 14 vende të Bashkimit European do të konsiderohen si vendet kryesore burimore të IHD-ve për shkak të peshës specifike të flukseve kapitale të këtyre vendeve në formë të IHD-ve, në drejtim të Shqipërisë. Modeli empirik i zgjeruar graviteti i aplikuar në këtë studim, do të bazohet në modelin bazë të trajtuar nga Bevan dhe Estrin (2004) dhe Boss dhe DeLar (2004) model.

Pjesa e dytë e analizës empirike, që do të trajtohet po në këtë kapitull, duke aplikuar metodologjinë Granger, do të shpjegojë rolin e Investimeve të Huaja Direkte mbi bazë stoku dhe fluksi, në rritjen ekonomike në Shqipëri, si dhe marrëdhëniet shkakësore midis rritjes ekonomike nga njëra anë dhe Investimeve të Huaja Direkte nga ana tjetër.

Kapitulli i gjashtë, përfundon punimin duke dhënë edhe rekomandimet e nevojshme për të ardhmen.

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS MBI IHD-TË NË EKONOMITË NË TRANZICION

2.1. Hyrje

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të teorive të IHD-ve, duke adresuar pyetjen: Çfarë i motivon kompanitë shumëkombëshe të kërkojnë tregje të tjera në ekonomitë në tranzicion? Me fjalë të tjera: çfarë janë përcaktuesit kryesorë të Investimeve të Huaja Direkte? Prandaj, qëllimi i këtij kapitulli është të identifikojë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në vendimet e kompanive shumëkombëshe (KSHK) për të investuar në ekonomitë në tranzicion. Në këtë pikëpamje, ne konsiderojmë se prezenca e IHD-ve në ekonomitë në tranzicion mund të shpjegohet nga një kombinim i metodave klasike dhe faktorëve që ndikojnë në përshpejtimin e tranzicionit. Roli i rëndësishëm i kompanive shumëkombëshe është një tipar kyç i globalizimit të ekonomisë botërore. Ky kapitull shqyrton literaturën kryesore të IHD-ve bazuar në tri teoritë kryesore të IHD-ve: koncepti i paradigmës elektike, teoria bazuar në burimet ekonomike të vendit pritës të IHD-ve dhe teorisë së rrjetit të biznesit. Ky kapitull përbëhet nga pesë pjesë. Pjesa e parë, ofron një trajtim teorik mbi kuptimin dhe përkufizimin e IHD-ve. Pjesa e dytë, trajton klasifikimin dhe format kryesore të IHD-ve. Në pjesën e tretë të këtij kreu, trajtohen teoritë kryesore të IHD-ve, si: teoria neoklasike, teoria monopoliste, teoria zëvendësuese e IHD-ve, teoria plotësuese, teoria e ciklit të jetës së produktit, teoria elektike e Dunning (1981), teoria e kostos së transaksioneve, teoria që bazohet në resurset ekonomike, teoria që bazohet në rrjetin e biznesit, si dhe teoria strategjike e Porter-it. Pjesa e katërt, paraqet një klasifikim alternativ që lidhet me faktorët përcaktues të IHD-ve. Në pjesën e pestë, trajtohet teorikisht lidhja midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike.

2.2. Përkufizime dhe kuptimi i Investimeve të Huaja Direkte

Që të kuptojmë rolin që luajnë IHD-të në një ekonomi, është me rëndësi të japim disa koncepte që kanë të bëjnë me përkufizimin dhe kuptimin mbi IHD-të. Teorikisht, në literaturë njihen disa përkufizime mbi IHD-të. Sipas një përkufizimi që përdoret nga FMN-ja (1993) dhe OECD (2007), *Investimi i Huaj Direkt reflekton synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt) në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Koncepti i “interesit të qëndrueshëm” nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje afatgjatë midis investitorit direkt dhe ndërmarrjes, si dhe të një ndikimi të konsiderueshëm të investitorit në administrimin e procesit të vendimmarrjes në ndërmarrje. Investimi direkt përfshin transaksionin fillestar midis dy njësive, si edhe të gjitha transaksionet pasuese midis tyre.*

Një tjetër përkufizim që nënvizon rëndësinë e nocionit të pjesëmarrjes në administrim është ai nga Ridgway, A. (2004). “Investim i Huaj Direkt është pronësia dhe kontrolli i aseteve të huaja”, që nënkupton pronësinë e plotë ose të pjesshme të një kompanie në një vend të huaj. Përcaktuesi “direkt” vjen nga fakti se investimi kryhet në formë të drejtpërdrejtë nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave dhe prurjes së makinerive, përveç prurjes së kapitalit.

Sipas Lehman (2002), Investimet e Huaja Direkte përfaqësojnë një kategori të investimeve ndërkombëtare, që paraqesin investime të karakterit ndërkufitar në të cilën investitori i huaj merr një interes të qëndrueshëm në një ndërmarrje në një ekonomi të huaj.

Botimi i pestë i Manualit të Statistikave të Bilancit të Pagesave (FMN, 1993) përcakton se investimi i drejtpërdrejtë realizohet kur investitori direkt ka fituar 10 për qind ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese të një kompanie tjetër në një vend të huaj, duke qenë rezident në një ekonomi tjetër.

Investimi direkt përfshin transaksionin fillestar midis dy njësive, si edhe të gjitha transaksionet pasuese midis tyre. Sipas Bankës Qendrore Europiane (BQE), pronësia e më pak se 10 për qind konsiderohet si investim portofoli.

“Një nga shkaqet kryesore të shumëllojshmërisë së përkufizimeve të IHD-së vjen nga ndryshimet në rëndësinë që u atribuohet karakteristikave të kompanive që operojnë në arenën ndërkombëtare” (Hood dhe Young, 1979). Në këtë kuadër, Moosa (2002) argumenton se “karakteristikat e përbashkëta të përkufizimeve të IHD-ve qëndrojnë në termat si ‘kontroll’ dhe ‘fuqi vendosëse’, të cilat përfaqësojnë tiparin kryesor që dallon IHD-të nga investimet e portofolit, meqë investitori i portofolit nuk kërkon kontroll mbi ndërmarrjen. Përgjithësisht, një minimum prej 10 për qind i zotërimit të aksioneve, konsiderohet të lejojë aksionerët e huaj të ushtrojnë një influencë të konsiderueshme mbi ndërmarrjen, nëse do të zgjidhnin ta bënin. Në kuadër të ndryshimit të modelit dhe rolit të IHD-së në ekonominë botërore, një grup ekspertësh nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) arritën në përfundimin që, është koha e duhur të rishikohet përkufizimi i tyre, i përmendur më sipër. Në vitin 2003 u krijua një grup i përbashkët ekspertësh nga FMN-ja dhe OECD-ja, për të koordinuar shtjellimet metodologjike dhe për të siguruar harmonizimin mes rekomandimeve të tyre. Një nga rekomandimet që doli nga takimi i grupit të ekspertëve të OECD-së, mbi Statistikat e Investimeve Ndërkombëtare, mbajtur në Tetor 2004 dhe Prill 2005, ishte ndryshimi nga 10 në 20 për qind i kufirit të përdorur

si kriter në përcaktimin e pronësisë së aksioneve të një kompanie të huaj, në një ekonomi jorezidente (OECD, 2005). Sidoqoftë, disa vende kanë zgjedhur për të lejuar dy lloje të kualifikimeve që përcaktojnë kriteret e definimit të investimeve si Investime të Huaja Direkte.

Së pari, në qoftë se një investitor direkt zotëron më pak se 10 për qind të aksioneve të zakonshme të një ndërmarrjeje, në një ekonomi jorezidente, por ka një zë efektiv në menaxhimin e transaksioneve midis investitorit dhe ndërmarrjes, atëherë ky lloj investimi njihet si Investim i Huaj Direkt. Së dyti, investitori që zotëron më pak se 10 për qind të aksioneve të zakonshme të një ndërmarrjeje, në një ekonomi jorezidente, dhe nuk ka një zë efektiv në administrimin e saj, ndërmarrja e tillë përjashtohet nga statistikat e IHD-ve. Tabela 1 tregon numrin e vendeve në vitin 1997 dhe 2001 që përdorën pragu e 10 përqindshit, të pronësisë për të identifikuar IHD-të, si dhe ato vende që përdorin kualifikime të tjera për të identifikuar IHD-të.

Tabela1: Përkufizimet që përdoren për identifikimin e IHD-ve në ekonomitë raportuese.

Numri i vendeve	Vendet që aplikojnë pragu 10% të aksioneve si kriter themelor	Vendet që aplikojnë një përqindje të pronësisë të ndryshme nga pragu 10%	Vende që përfshijnë ndërmarrjet në të cilën investitori zotëron më pak se 10%, por ka një zë efektiv në administrimin	Vendet që përjashtojnë ndërmarrjet në të cilat investitori zotëron më shumë se 10%, por nuk ka zë efektiv në menaxhimin e ndërmarrjes	Vendet që aplikojnë pragu prej 10% të vlerës së IHD-ve	Vendet që përfshijnë ndryshime të kriterëve për definimin e investimeve si IHD
Total 2001 (61)	55	9	10	3	6	5
Total 1997 (61)	50	9	12	5	12	5
Ndryshimi	+5	0	-2	-2	-6	0
OECD 2001 (30)	28	2	6	2	4	2
OECD 1997 (29)	24	6	7	2	4	3
Tjera 2001 (31)	27	7	4	1	2	3
Tjera 1997 (32)	26	3	5	3	8	2

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2003.

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), kriteret për njohjen e një investimi si IHD, mund të përcaktohen nga kombinimi i faktorëve të tillë, si:

1. Përfaqësimi i bordit të drejtorëve.
2. Pjesëmarrja në proceset e krijimit të politikave.
3. Transaksionet e materialeve brenda kompanisë.
4. Shkëmbimi i personelit menaxherial.
5. Ofrimi i informacionit teknik.
6. Sigurimi i kredive afatgjata me norma më të ulëta interesi se normat ekzistuese.

Investimet e Huaja Direkte përbëjnë jo vetëm bashkimet dhe blerjet apo sipërmarrjet, por edhe fitimet e riinvestuara dhe transferimet e kapitalit midis kompanisë mëmë dhe filialeve (Adam et al., 2003).

Në Shqipëri në ligjin nr. 7764, datë 2 nëntor 1993, “Për Investimet e Huaja”, përcaktohet qartë se kush quhet “investitor i huaj” dhe çfarë quhet “investim i huaj”.

“Investitor i huaj” nënkuptohet:

- a) Çdo person fizik që është shtetas i një vendi të huaj;
- b) Çdo person fizik që është shtetas i Republikës së Shqipërisë, por me banim të përhershëm jashtë vendit;
- c) Çdo person juridik që është themeluar sipas ligjit të një vendi të huaj, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi kërkon të kryejë ose është duke kryer një investim në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet e saj që i përkasin periudhës nga 31.07.1990 e në vijim.

Të huajt kanë të drejtë të angazhohen në aktivitetet ekonomike pa nevojën e një autorizimi apo leje të mundshme. Ata lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që ju njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me përjashtim të pronësisë mbi tokën, e cila rregullohet me ligj të veçantë. Në të gjitha rastet dhe në çdo kohë, investimet e huaja kanë trajtim të barabartë e të paanshëm, gëzojnë mbrojtje e siguri të plotë. Investitorëve që iu shkaktohen humbje si pasojë e luftërave, konflikteve të armatosura, emergjencave kombëtare apo ngjarjeve të tjera të ngjashme, do të trajtohen në mënyrë jo më pak të favorshme se investitorët shqiptarë.

2.3. Klasifikimi dhe format kryesore të Investimeve të Huaja Direkte

Nisur nga këndvështrimet e tyre mbi Investimet e Huaja Direkte, autorë të ndryshëm kanë bërë klasifikime të ndryshme. Nga këndvështrimi i investitorit, IHD-të ndahen në horizontale, vertikale dhe konglomerate (Caves, 1971).

IHD-të horizontale ndodhin kur kompanitë shumëkombëshe prodhojnë produkte homogjene nëpër vende të ndryshme të botës apo produkte të ngjashme me ato që prodhohen në vendin e origjinës. IHD-të në vendet e zhvilluara janë zakonisht investime horizontale drejtuar nga strategjitë e tregut dhe ata kanë tendencë për të rritur intensitetin e punës në prodhim në vendin pritës. Prandaj, investimet horizontale përsërisin procesin e plotë të prodhimit të vendit origjinë në një vend të huaj. IHD-të horizontale kërkojnë të marrin avantazhet e një tregu të ri të madh, i cili konsiderohet si motiv tradicional për IHD-të.

IHD-të vertikale, nga ana tjetër, konsistojnë në ndarjen gjeografike të fazave të ndryshme të procesit të prodhimit. IHD-të vertikale ndodhin atëherë kur një firmë

angazhohet vetëm në një pjesë të procesit të prodhimit dhe jo në të gjithë prodhimin. Në shumë raste, kjo është ri-vendosje e aktiviteteve të punës intensive në vendet me paga të ulëta. Kështu, nxitet tregtia përtej kufijve dhe rritet tendenca e firmave për të eksportuar. IHD-të vertikale janë të shtyra zakonisht nga dallimet në çmimet e faktorëve të prodhimit midis vendeve të origjinës dhe atyre pritëse. IHD-të në vendet më pak të zhvilluara janë të lidhur me investimet vertikale.

IHD-të konglomerat mund paraqesin një përzierje të investimeve horizontale e vertikale. Nisur nga pikëpamjet e IHD-ve sipas orientimit ndaj eksportit, Kojima (1975) i klasifikon investimet e huaja në të orientuara drejt tregtisë (që gjenerojnë një kërkesë të rritur për importe e një ofertë të rritur për eksporte) ose të orientuara kundër tregtisë, që kanë një efekt negativ mbi tregtinë.

Ai nënvizon se përparësitë krahasuese të industrive në vendet e origjinës e ato pritëse, janë vendimtare për të përcaktuar nëse IHD-të janë të orientuara nga tregtia apo kundër saj. Në vendet në zhvillim, që janë pritëse të IHD-ve, IHD-të që përdorin në mënyrë intensive faktorin punë, konsiderohen si IHD që gjenerojnë tregti, ndërsa IHD-të që përdorin në mënyrë intensive kapitalin, konsiderohen si IHD-të që zëvendësohen me tregtinë. Ky klasifikim është përpunuar më tej nga Dunning dhe Narula (1996 a), të cilët klasifikuan IHD-të në:

- a) *IHD-të zëvendësuese të tregtisë*, që zëvendësojnë importet me furnizimin e tregjeve të brendshme;
- b) *IHD-të promovuese të tregtisë*, që kanë për qëllim furnizimin e tregjeve të tjera;
- c) *IHD-të plotësuese të tregtisë*, kur IHD-të drejtohen në prodhimin e racionalizuar të pajisjeve ndihmëse në tregjet e eksportit; dhe

d) *IHD-të shmangëse të tregtisë*, nëse synojnë të përdorin pjesë të papërdorura të tregut, me marrëveshje tregtare.

Dunning (1999) identifikoi katër kategori kryesore të investitorëve të huaj, të cilat janë përdorur më pas nga shumë studiues të tjerë në analizat e tyre: *IHD-të kërkuese të rendimentit*; *IHD-të kërkuese të tregjeve*; *IHD-të kërkuese të burimeve* dhe *IHD-të kërkuese të aseteve strategjike*.

IHD-të kërkuese të rendimentit motivohen nga përparësitë e thjeshta të drejtimit të aktiviteteve të huaja të shpërndara gjeografikisht për të përfituar nga ekonomitë e shkallës dhe diversifikimi i rrezikut, karakteristikë kjo për vendet e zhvilluara.

Investitorët e huaj e konsiderojnë çmimin e faktorëve të prodhimit dhe anëtarësimin në marrëveshjen e integritetit rajonal. Qëllimi është përfitimi nga përparësitë që mund të ofrojnë ndryshime në koston e faktorëve të prodhimit, kultura, marrëveshjet institucionale, sistemet ekonomike e politike

IHD-të kërkuese të tregjeve motivohen nga dëshira e tyre për të hyrë në tregjet e vendit pritës ose tregjet rajonale. *IHD-të e tregut* synojnë të depërtojnë në tregjet lokale të vendeve pritëse dhe janë lidhur zakonisht me: madhësinë e tregut dhe të ardhurat për kokë banori, rritjen e tregut, qasja në tregjet rajonale dhe globale, preferencat e konsumatorit dhe strukturën e tregut të brendshëm.

IHD-të kërkuese të burimeve ndërmarrin një investim të huaj direkt për të përfituar burime, pasuri specifike që janë të disponueshme në vendin pritës me një kosto më të ulët. Këto lloje të pasurive mund të jenë në formë të burimeve fizike, që mund të sigurohen me kosto më të ulët, forcës punëtore të motivuar, të aftë për punë që mund të sigurohet me kosto të ulët, burime teknologjike, personelit me eksperiencë administrimi e menaxhimi.

IHD-të kërkuese të aseteve strategjike hyjnë në kategorinë e Investimeve të Huaja Direkte që realizohen me qëllim përfitimin të një aseti të rëndësishëm, që i përmirëson firmës pozicionin konkurrues në treg. Në praktikë ka një ndërthurje midis këtyre kategorive të IHD-ve. Në vitin 1998, Meyer bën dallimin mes investitorëve të huaj, të drejtuar nga tregjet që synojnë tregje vendase ose rajonale, investitorëve të huaj të drejtuar nga çmimi i faktorëve që synojnë shitjet rajonale dhe investitorëve të huaj që janë një kombinim i dy llojeve të mësipërme, domethënë të drejtuar nga tregjet dhe çmimi i faktorëve.

Një tjetër lloj i investimeve të huaja është edhe Investimi i Portofolit të Jashtëm (IPF). Ky lloj i investimeve zhvillohet në tregjet financiare ndërkombëtare dhe konsiderohet nga të gjithë agjentët ekonomikë, si individët, firmat dhe qeveritë lokale apo kombëtare. Investimet e huaja të portofolit i referohen transaksioneve të tilla që përfshijnë blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë të kapitalit neto, me vlerë të borxhit në formën e bonove, shënime, instrumentet e tregut të parasë dhe derivatet financiare me përjashtim të letrave me vlerë të klasifikuara si investime direkte dhe rezervat e fondit (Ridgway, 2004).

2.4. Teoritë kryesore mbi IHD-të

Në këtë pjesë të punimit paraqesim një përmbledhje të teorive kryesore mbi Investimet e Huaja Direkte (IHD). Në thelb të trajtimit të teorive të IHD-ve qëndron pyetja: Çfarë i motivon kompanitë shumëkombëshe të kërkojnë tregje të tjera në ekonomitë në tranzicion? Me fjalë të tjera, çfarë janë përcaktuesit kryesorë të Investimeve të Huaja

Direkte? Prandaj, qëllimi i punimit në vazhdimësi është të identifikojmë faktorët e rëndësishëm që shërbejnë për njohje të IHD-ve, përmes literaturës teorike.

Në këtë këndvështrim trajtojmë teoritë vijuese të IHD-ve, si: teoria neoklasike, teoria monopoliste, teoria zëvendësuese e IHD-ve, teoria plotësuese, teoria e ciklit të jetës së produktit, teoria elektike e Dunning, teoria e kostos së transaksioneve, teoria që bazohet në resurset ekonomike, teoria që bazohet në rrjetin e biznesit dhe teoria e Porter-it.

2.4.1. Teoria neoklasike e IHD-ve

Teoria neoklasike mbi IHD-të bazohet në konceptet e tregtisë ndërkombëtare dhe konceptet e tregjeve ndërkombëtare të kapitalit. Kjo teori supozon ekzistencën e tregjeve perfekte (të konkurrencës perfekte-të plotë). Qasja neoklasike merr në konsideratë ekzistencën e fenomenit të rrallësisë dhe kostos së lartë të fuqisë punëtore. Sipas kësaj qasje, si rezultat i ekzistencës së fenomenit të rrallësisë dhe kostos së lartë të fuqisë punëtore, IHD-të tentojnë të transferojnë fasilitetet e prodhimit nga vende të zhvilluara në vende në zhvillim e sipër, kryesisht në vende në tranzicion (Cantwell, 1991; Caves, 1996). Si rrjedhojë, ekziston vetëm një drejtim i fluksit të kapitalit, nga vende të zhvilluara në drejtim të vendeve me mungesë të theksuar kapitali (Vasyechko, 2012). Modeli Heckscher-Ohlin (H-O), që parashikon drejtimin e tregtisë të të mirave mes dy vendeve, bazuar në dallimet e tyre në faktorë kostosh dhe prodhimi, është përdorur në mënyrë ekstensive për të shpjeguar IHD-të, brenda kornizës së ekulibrit të përgjithshëm. Ky model qëndron në kuadrin e pikëpamjeve neoklasike mbi tregtinë. Për të kuptuar rolin e burimeve në tregti është i nevojshëm zhvillimi i një modeli në të cilin prodhohen dy të mira, duke përdorur dy faktorë prodhimi. Sipas këtij modeli, vendi do

të tentojë të prodhojë më shumë produktin që përdor faktorin e prodhimit që vendi ka me shumicë.

Qasja neoklasike është kritikuar nga studiues të ndryshëm për mungesë të “realizmit në trajtim” dhe “paaftësisë shpjeguese” (Hymer, 1972). Në kontekst të vendeve në tranzicion, tregjet me konkurrencë perfekte nuk ekzistojnë dhe institucionet bazë që promovojnë ekonominë e tregut, janë në zhvillim e sipër. Zerbregs (1998) argumenton se qasja neoklasike nuk është relevante në shpjegimin e flukseve hyrëse të IHD-ve në vendet në tranzicion.

Sidoqoftë, supozimi i qasjes neoklasike që mbështetet në faktin se kapitali lëviz nga vendet ekonomikisht të zhvilluara në drejtim të vendeve me mungesë të theksuar kapitali është shumë e rëndësishme për të kuptuar motivet e IHD-ve në ekonomitë në tranzicion. Duke konsideruar qasjen neoklasike, motivet investuese të investitorëve të huaj janë shumë të rëndësishme për vendet në tranzicion dhe këto motive shpjegohen nga dallimet në faktorët e kostove të kapitalit, risqeve në kurset e këmbimit dhe risqeve në tregjet e letrave me vlerë që u atribuohen investitorëve të huaj në disa ekonomi në tranzicion (Aliber, 1970).

Dy faktorë të rëndësishëm të aktivitetit biznesor të propozuar nga qasja neoklasike mbi teoritë e IHD-ve, janë pasiguria që lidhet me mënyrën e funksionimit të tregjeve globale si faktor risku për investitorët e huaj dhe roli i qeverisë së vendit pritës të IHD-ve, në procesin e krijimit dhe zhvillimit të institucioneve, e cila paraqet pikënisjen kryesore të shumë studimeve empirike që shpjegojnë motivet e IHD-ve në ekonomitë në tranzicion.

2.4.2. Teoria Monopoliste e IHD-ve

Teoritë monopoliste të IHD-ve janë zhvilluar nga Coase (1937), i cili paraqiti konceptin e kostos së transaksioneve për të shpjeguar natyrën dhe kufijtë e firmës. Coase (1937) e kritikoi qasjen neoklasike, e cila mbështetet në supozimin e konkurrencës perfekte ndërmjet firmave që veprojnë në treg. Në kundërshtim me hipotezën neoklasike, Coase (1937) trajtoi konceptin e kostos, e cila shpjegon formimin e strukturave brenda kompanisë, e cila nga ana tjetër ndihmon firmën për të ulur koston e transaksioneve. Kritikët e Coases (1937) u bazuan në pengesat që krijohen gjatë përdorimit të sistemit ideal të çmimeve të tregut në qasjen neoklasike.

Në përputhje me Coase, Hymer (1968) ofron një alternativë tjetër: një analizë mikroekonomike e firmave shumëkombëshe bazuar në teorinë e organizimit industrial. Hymer argumentonte se flukset e IHD-ve nuk janë të shpërndara rastësisht në mesin e industrive, por më tepër janë të ndikuara nga kushtet konkurruese (Xizhong, 2004). Sipas teorisë së organizimit industrial, firmat vendase që ndërmarrin aktivitete të IHD-ve, përfshihen në industri të vendeve të tjera, të udhëhequr nga aftësitë e tyre për të gjeneruar të ardhura, të cilat nuk janë të disponueshme për firmat vendase (Dunning, 1981). Prandaj, fokusi i Hymer (1960) ishte që të lidhen me IHD-të firmat shumëkombëshe, në mënyrë që të analizohen motivet e rritjes së firmave shumëkombëshe, të cilat më shumë mbështeten në konceptet e prodhimit ndërkombëtar sesa në konceptet e tregtisë ndërkombëtare.

Në kundërshtim me teorinë neoklasike të IHD-ve, që supozon ekzistencën e tregjeve perfekte, Hymer argumenton se firmat shumëkombëshe ekzistojnë dhe veprojnë në kushte të tregjeve me konkurrencë jo të plotë (Vasyechko, 2012).

Në kohën e shkrimeve të Hymer-it, në vitet 1960-të, ekonomistët dallonin me vështirësi Investimet e Huaja Direkte dhe Investimet e Huaja Portofol. Në vend të kësaj, ata mendonin se përmbajtja e Investimeve të Huaja Direkte, si dhe e atyre portofol, mund të shpjegoheshin para së gjithash me dallimet në normat e interesit midis ekonomisë vendase dhe ekonomive të huaja. Hymer nga ana tjetër, tregoi se IHD-të janë krejtësisht të ndryshme nga investimet portofol dhe se ato mund të shpjegohen kur i konsiderojmë si pjesë e strategjisë ekspansioniste të firmës shumëkombëshe dhe e dëshirës së saj për të kontrolluar prodhimin në vendet e huaja (Gilpin, 2000). Duke i paraprirë zbatimeve të mëvonshme të teorisë së organizimit industrial në fushën e studimit të KSHK-ve, si edhe teorisë elektike, Hymeri argumentonte se firmat investojnë jashtë vendit për të shfrytëzuar dhe mbrojtur disa avantazhe të lidhura me specifikat e firmës monopolistike. Në pajtueshmëri me konceptin e Hymerit, në vitin 1966, Vernon paraqiti kornizën teorike që shpjegon flukset e IHD-ve, bazuar në përparësitë konkurruese të faktorëve të kostos dhe prodhimtarisë. Kjo teori paraqet interpretimin e parë dinamik të faktorëve përcaktues të flukseve të IHD-ve dhe flukseve tregtare. Ky shpjegim tregon më shumë për përbërjen gjeografike dhe industriale të investimit ndërkombëtar (Dunning, 1973). Kjo teori sugjeron që dallimet në faktorët e prodhimit dhe kushteve fillestare për tregti në mes vendeve shpjegojnë modelin gjeografik të IHD-ve (Kinoshita and Campos, 2004), prandaj mund të paraqitet fenomeni i investimit të vendeve të zhvilluara në vendet në zhvillim.

2.4.3. Teoria zëvendësuese e IHD-ve

Teoria që mbështetet në zëvendësimin e IHD-ve me tregtinë, zhvilluar nga Robert Mundell (1968), thekson se tregtia ndërkombëtare është nxitur nga dallimet në faktorët e prodhimit dhe çmimeve. Duke supozuar në palëvizshmërinë e faktorëve të prodhimit dhe produkteve, Mundell zhvillon një model standard që mbështetet në dy faktorë prodhimi, dy të mira dhe dy vende. Mobiliteti i kapitalit në mes dy vendeve trajtohet brenda koncepteve të kësaj teorie, të zhvilluar nga Mundell (1957). Ky model mbështetet në supozimin mbi ekzistencën e faktorëve që ndikojnë në funksionin e prodhimit. Në këto kushte, lëvizshmëria e kapitalit bëhet e lirë dhe zëvendësohet me tregtinë (Mundell, 1957). Barrierat në tregti shpjegojnë në mënyrë të konsiderueshme konceptin e lëvizshmërisë së kapitalit, brenda kësaj kornize teorike. Mundell (1968) argumentonte se kur ekzistojnë pengesa në tregti, në lëvizjen e mallrave, relacioni në mes lëvizshmërisë së mallrave dhe faktorëve të prodhimit është zëvendësues. Ky relacion nënkupton që rritja e IHD-ve do të ndikojë në ulje të eksporteve nga vendi origjinë në vendin pritës, kështu që Mundell përfundon se lëvizshmëria e kapitalit udhëhiqet nga IHD-të, dhe IHD-të në këtë rast janë zëvendësues perfekt për eksportet. Kjo ndodh në qoftë se flukset e IHD-ve ndjekin trajektoren e kurbës së eksporteve (Rybczynski, 1955), për shkak të efikasitetit të lartë dhe kostove të ulëta të prodhimit. Megjithatë, shumë hulumtues kanë kritikuar teorinë zëvendësuese të IHD-ve, sepse flukset e IHD-ve me flukset e tregtisë, në fakt, asnjëherë nuk mund të jenë në marrëdhënie të zëvendësimit perfekt midis tyre në një ekonomi reale, dhe IHD-të çdoherë bashkekzistojnë me eksportet (Vasyechko, 2012). Në këtë drejtim, Johnson (2006) ka argumentuar relacionin zëvendësues dhe plotësues midis IHD-ve dhe

eksporteve, duke gjetur që investimi në vendin pritës të IHD-ve ndikon në rritje të eksporteve (tregtisë) të vendit pritës të produkteve të ndërmjetme që prodhohen në procesin e prodhimit. Prandaj, firmat shumëkombëshe investojnë në vendet me ekonomi në tranzicion në mënyrë që të eksportojnë outputin në vende të treta.

2.4.4 Teoria plotësuese e IHD-ve

Mbështetur në argumentet e teorisë zëvendësuese të IHD-ve, Kojima ka analizuar teorinë plotësuese të IHD-ve, që mbështetet në supozimin se IHD-të me eksportet (tregtinë) mund të kenë marrëdhënie plotësuese midis tyre. Kojima, konceptin e teorisë plotësuese të IHD-ve e zhvilloi në fund të viteve 1970-të, si kundërpërgjigje ndaj modelit zëvendësues të IHD-ve me eksportet (tregtinë), (Xizhog, 2004). Kjo teori shërben si sintezë për modelin: Hecksher-Ohlin të tregtisë, hipotezës së Linderit, teoremës së Rybczynskit dhe hipotezës së Vernonit që mbështetet në teorinë e ciklit jetësor të produktit (Vasyechko, 2012).

Kojima i trajton IHD-të, brenda teorisë plotësuese si një zgjerim teorik, që mbështetet në teoritë neoklasike të eksporteve (Dunning, 1988). Qasja makroekonomike e zhvilluar nga Kojima parashikon që IHD-të e orientuara nga eksportet ndodhin në rastet kur vendi origjinë i IHD-ve investon në industritë me përparësi krahasuese të vendit pritës të IHD-ve (Xizhog, 2004). Prandaj, Kojima arrin në përfundimin që IHD-të e orientuara nga eksportet karakterizohen si IHD-të me efekte pozitive në ekonominë e vendit pritës. Efekti pozitiv paraqitet në përmirësimin e mirëqenies ekonomike të popullsisë së vendit pritës të IHD-ve dhe në formë të promovimit të tregtisë së vendit pritës. Prandaj, efektet

plotësuese të IHD-ve në eksportet e vendit pritës janë në shërbim të rritjes së tregtisë ndërkombëtarë midis vendit pritës dhe vendit të origjinës.

2.4.5. Teoria e ciklit të jetës së produktit

Teoria e ciklit jetësor të produktit, zhvilluar nga Vernon (1966), ofron një shpjegim teorik për vendimin për të ndërmarrë IHD-të. Sipas tij, ky vendim ka të bëjë më shumë me vetë biznesin sesa me shtetet, çka në thelb është e vërtetë për kompanitë që ndërmarrin në konsideratë IHD-të. Thelbi i teorisë së ciklit të produktit të Vernon-it ishte se çdo produkt ndjek një cikël jete që fillon nga novacioni përmes maturimit të rënies, drejt vjetërimit e daljes jashtë përdorimit. Gjatë fazës fillestare të ciklit të produktit, firmat eksportojnë produkte të reja nga baza e tyre industriale kombëtare, por me kalimin e kohës një numër ndryshimesh, të lidhur me maturimin e produktit, si për shembull: standardizimi i teknikave të prodhimit, përhapja jashtë vendit e njohurive, know-how, mbi ato produkte dhe shfaqja e një kërkesë të madhe nga tregu i huaj për atë produkt, stimulojnë futjen në atë fushë prodhimi e tregtimi të imituesve të huaj. Për të shkurajuar e penguar firmat e huaja nga hyrja në treg dhe për reduktimin e pozitës së tyre monopol, firmat i vendosin linjat e tyre prodhuese në ekonomi të tjera.

Kështu, sipas teorisë së ciklit të produktit të Vernon-it, investimi i huaj i drejtpërdrejtë është, para së gjithash, një shpikje e përdorur nga firmat për t'i paraprirë konkurrencës së huaj dhe për të ruajtur pozitat e tyre monopol (Gilpin, 2000). Teoria e Vernon-it e vë theksin mbi rolin e rrisë së produktit dhe efektet e ekonomive të shkallës në ecurinë e tregtisë përtej kufijve kombëtarë. Teoria e ciklit jetësor të produktit sugjeron që konkurrenca për koston më të ulët e çon prodhimin jashtë vendit, dhe konkurrenca vjen

e rritet ndërkohë që produkti maturohet e standardizohet. Fillimisht, prodhimi i huaj zhvendoset në vende të tjera të industrializuara për t'i shërbyer tregut të vendit pritës dhe pastaj eventualisht spostohet në vendet në zhvillim, që mund të ofrojnë përparësitë konkurruese specifike për vetë vendin. Kjo teori përcakton fazën e rritjes, në ciklin e jetës së produktit, si faza kur eksportet rriten dhe investimi i huaj shkon për fabrika prodhuese në vende që kanë kërkesë në rritje për produktin. Teoria e ciklit jetësor të produktit që shpjegon IHD-të hedh dritë mbi faktorë të rëndësishëm të drejtpërdrejtë të investimeve të huaja, si: përvoja menaxheriale, patentimi apo licencimi i produkteve, diferencimi i produkteve, ekzistenca e informacionit asimetric dhe ekzistenca e kulturës dhe etikës së biznesit (Caves, 1971). Teoria e Vernon-it, që supozonte praninë e diferencave të thella nga pikëpamja e pasurisë në zotërim dhe e zhvillimit teknologjik midis Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera, ndihmoi për të shpjeguar ekspansionin botëror të firmave amerikane në vitet 1960-të.

Kur dallime të tilla u zhdukën pas viteve 1970-të, rëndësia e teorisë së tij mbi sjelljet e firmave e humbi vlerën. Për më tepër, teoria e ciklit të produktit nuk mund të shpjegonte ekspansionin e mëpastajmë në botë të firmave evropiane dhe japoneze, si dhe të shumë firmave të shumë kombeve të tjera (Gilpin, 2000). Shpjegimet e dhëna nga ekonomistët e tjerë të biznesit mbi këto zhvillime të reja përfshijnë faktorë të tillë specifikë dhe të përgjithshëm, si: ngritja e barrierave tregtare, rëndësia e afërsisë së tregut, rënia e kostos së transportit dhe problemi i luhatjeve të vlerës së monedhave.

Teoria “elektike”, e lidhur para së gjithash me emrin e Joan Dunning, ishte përpjekja më sistematike për të shpjeguar zhvillimet e shumta të Kompanive Shumëkombëshe (KSHK) dhe Investimeve të Huaja Direkte.

2.4.6. Teoria elektike e Dunning

Teoria ndërkombëtare e IHD-ve, e zhvilluar në teori të paradigmës elektike (OLI), nga Dunning (1981), na jep një analizë të thellë se ç'janë KSHK-të, duke vënë theksin në rolin e teknologjisë si një faktor i zhvillimit të KSHK-së. Përparimet e mëdha në komunikacion dhe transport e kanë bërë teknikisht të mundshme që bizneset të organizojnë dhe menaxhojnë në një plan global sistemet e shërbimit dhe prodhimit. Në fakt, përparimet teknologjike i kanë reduktuar mjaft kostot e transaksionit dhe kosto të tjera të ndërkombëtarizimit të prodhimit apo të shërbimeve. Kjo teori është më tepër një përmbledhje e ideve të zgjedhura nga shumë burime e kërkime të ndryshme mbi KSHK-të. Teoria në vetvete paraqet plotësim të teorisë së Hymer mbi IHD-të dhe teorisë që mbështetet në kostot e transaksioneve, të zhvilluar nga Coase. Kornizat e teorisë OLI mbi IHD-të mbështetet në dy grupe avantazhesh të vendit: makroekonomike dhe mikroekonomike të pronësisë (Dunning, 1981). Për Dunning, kushtet OLI përbëjnë një kuadër më të plotë teorik të integritit të elementeve kyçe të shpjegimeve të ndryshme të teorive mbi IHD-të.

Në kontekst të kushteve të tranzicionit, Dunning ishte i pari që shqyrtoi strukturën e burimeve, madhësinë e tregut dhe politikave qeveritare, si përcaktuesit kryesorë të vendndodhjes së IHD-ve në një vend pritës, gjithashtu vijoi duke argumentuar se modelet e IHD-ve nuk janë të vazhdueshme, por ndryshojnë në varësi të këtyre faktorëve përcaktues.

Në përputhje me konceptin e paradigmës elektike, OLI, Dunning (1980) jep një kornizë të dobishme për studime analitike të teorive të Investimeve të Huaja Direkte.

Paradigma OLI bazohet në tre faktorë që ndikojnë në vendimet e IHD-ve:

1) faktorët e pronësisë; 2) faktorët e vendndodhjes; 3) faktorët e trupëzimit.

Në këtë drejtim, paradigma OLI përfaqëson një kombinim të tre teorive kryesore të IHD-ve, që përqendrohen në përparësitë e pronësisë, përparësitë e vendndodhjes dhe përparësitë e trupëzimit. Në të njëjtën kohë, kjo paradigmë ofron një përgjigje për tre pyetje të rëndësishme që lidhen me IHD-të: “Cila firmë do të investojë jashtë vendit?”, “Ku do të bëhet investimi?” dhe “Pse disa firma shërbejnë në tregun e huaj përmes investimeve direkte dhe jo përmes eksporteve?”.

Kjo paradigmë ndihmon hulumtuesit për të kuptuar pse zhvillohen IHD-të, si përdoren IHD-të nga firmat shumëkombëshe për të përmirësuar konkurrencën globale, si IHD-të ndikojnë në përparësitë konkurruese të vendit pritës, si dhe pse qeveritë e vendit pritës dhe vendit origjinë të IHD-ve, adresojnë politikat qeveritare në drejtim të promovimit dhe nxitjes së IHD-ve. Përkundër aftësive shpjeguese të koncepteve të IHD-ve, paradigma OLI është e kufizuar në aftësinë e saj për të shpjeguar apo parashikuar llojet e veçanta të prodhimit ndërkombëtar dhe, edhe më pak, sjelljen e ndërmarrjeve individuale (Dunning, 1988, 1998; Dunning dhe Gray, 2003).

Sipas paradigmës elektike, një kompani e prodhimit ndërkombëtar ka avantazhe të rëndësishme në raport me kompanitë vendase. Këto avantazhe mund të shpjegohen (Dunning, 1988, 1998; Dunning and Gray, 2003):

1. (O) Përparësitë specifike të pronësisë, duke iu referuar origjinës së investimit.
2. (L) Përparësitë specifike të vendndodhjes, duke iu referuar drejtimin të investimit.
3. (I) Përparësitë specifike të trupëzimit, duke iu referuar arsyes për ndërmarrje të aktiviteteve për IHD-të.

- *Përparësitë e pronësisë (ownership advantage)*: përparësitë krahasuese, specifike për firmën, që ndërmarrja shumëkombëshe ka ndaj firmave vendase për t'i shërbyer tregjeve të veçanta. Këto mund të jenë produkte ose procese prodhimi apo reputacioni për cilësinë që firmat vendase nuk i kanë. Shembuj të tjerë të këtyre përparësive përfshijnë: ekonomitë e shkallës, emri i mirë, aftësitë menaxheriale dhe teknologjia superiore (Johnson, A., 2006). Duke u mbështetur në këto përparësi, kompanitë shumëkombëshe vendosin për të përfituar nga avantazhet e veta, të cilat rrjedhin nga ekonomia e shkallës, aftësi menaxheriale dhe përvojës së marketingut, teknologjive të përparuara si rezultat i investimeve në kërkim dhe zhvillim. Teoria OLI e prodhimit ndërkombëtar thekson se, firmat vendase do të kërkojnë të përfitojnë avantazh konkurrues apo të pronësisë mbi firmat e huaja, në mënyrë që të përfshihen në aktivitete e tyre jashtë tregjeve të tyre kombëtare (Dunning, J., 1981). Duke kombinuar asetet e firmës, që sigurohen nga përparësitë e pronësimit apo përparësitë konkurruese, me faktorët ekonomik të lokalizuar në firmat e huaja, mund të përcaktohet forma e përfshirjes ndërkombëtare e firmës vendase në operacione të biznesit ndërkombëtar (Dunning, 1988).

- *Përparësitë specifike të vendndodhjes (Location-specific advantages)*: të cilat janë motivime shtesë për IHD-të që u atribuohen firmave shumëkombëshe nga ekzistenca e përparësive specifike të vendit të huaj në të cilin firma shumëkombëshe investon, si: materiale me kosto të ulët, kosto më e ulët e prodhimit, kosto e ulët e transportit për kompanitë që operojnë në treg dhe zhvillimi i infrastrukturës i vendit pritës së IHD-ve. Këto avantazhe përcaktojnë mënyrën se si vende të ndryshme bëhen tërheqëse për prodhimet ndërkombëtare. Ato gjithashtu shërbejnë për të shfrytëzuar avantazhin në

tregun e huaj ose në një vend pritës (Johnson, 2006). Duke pasur parasysh avantazhet specifike të pronësisë, Dunning ka identifikuar faktorët përcaktues dhe disa avantazhe kryesore që lidhen me faktorët specifik të lokacionit, për firmat vendase dhe firmat e huaja. Këta faktorë përfshijnë faktorët që përcaktojnë numrin e konsumatorëve, cilësinë e inputeve, zhvillimet në infrastrukturë dhe politikat qeveritare në drejtim të promovimit të Investimeve të Huaja Direkte, stabilitetin e përgjithshëm politik, social dhe ekonomik të vendit dhe qëndrimin e popullsisë lokale ndaj firmave të huaja. Lokacioni gjithashtu ka të bëjë edhe me faktorët e kërkesës dhe faktorët e ofertës, duke ndikuar procesin e prodhimit dhe koston e procesit të prodhimit, kostot administrative dhe kostot për hulumtim dhe zhvillim (Dunning, 1977). Duke supozuar një treg të veçantë dhe çdo firmë operuese në të është çmim pranues, prodhimi lokalizohet në vendet ku kostot janë më të ulëta. Në kthim, kjo varet nga vlefshmëria e inputeve, dhe efienca e transformimit të këtyre inputeve në outpute dhe kostot e lëvizjes së produkteve nga pika e prodhimit në atë të shitjes (Dunning, 1981).

- *Përparësitë specifike të trupëzimit (Internalisation advantages)*. Faktorë që ndikojnë firmën në vendimin për të prodhuar të mirat ose shërbimet vetë apo për t'u mbështetur në një prodhues lokal. Zgjedhja e mënyrës që përdor ndërmarrja shumëkombëshe për të hyrë në tregun e huaj varet nga faktorët e trupëzimit.

Këta faktorë paraqesin motivet e firmave për të zgjeruar biznesin e tyre në mënyrë që të ulin kostot e transaksioneve (Johnson, 2006). Nëse firmat shumëkombëshe nuk kanë në pronësi inventare që shërbejnë për operimin e saj në tregjet ndërkombëtare, atëherë pritët që kostot e monitorimit dhe të transaksioneve të jenë të larta. Përparësitë e trupëzimit përcaktojnë aftësinë e firmave shumëkombëshe për të pronësuar fasilitetet

(Johnson, 2006). Këto përparësi të trupëzimit mund të arrihen nëpërmjet patentimit të produkteve, licensimit të produkteve, aplikimit të mbrojtjes teknologjike know-how. Përparësitë e trupëzimit janë të nevojshme në rastet kur barrierat tregtare ose kostot e transportit janë të larta dhe në rastet kur ekziston rreziku i informacionit asimetrik që lidhet me cilësinë e produkteve. Përparësitë e trupëzimit janë veçanërisht të rëndësishme për industritë që janë të bazuara në shfrytëzimin e burimeve dhe për industritë teknologjikisht intensive. Tabela 2 paraqet variablat më të rëndësishëm që identifikojnë faktorët përcaktues të fluksit të IHD-ve që janë analizuar në studimet e mëparshme, duke konsideruar përparësitë e pronësisë, vendndodhjes dhe trupëzimit. Kolona në të djathtë paraqet efektin e pritshëm të variablave specifike në fluksin hyrës të IHD-ve. Të gjithë faktorët e përmendur më sipër, bashkë me të tjerë, si vlefshmëria e burimeve, strategjia e përgjithshme e firmës etj., ndihmojnë firmën të zgjedhë në mes strategjive alternative të operimit në tregjet ndërkombëtare, si: IHD-të, eksportit, kompanisë së përbashkët apo alternativave të tjera.

2.4.7. Teoria e Kostos së Transaksioneve

Kjo teori shpjegon ekzistencën e ndërmarrjeve shumëkombëshe. Teoria e kostos së transaksioneve është zhvilluar nga Williamson (1975), më pas nga Casson (1982) dhe e përpunuar më tej nga shumë autorë të tjerë. Williamson shpjegon pse mund të jetë përparësi përqendrimi në aktivitete të caktuara brenda firmës sesa mbështetja në mekanizmat e tregut, si për shembull, të licensojë apo të nënkontraktojë për të arritur të njëjtat objektiva.

Ai argumenton se, kur kostot e ndryshme të transaksionit, të përfshira në operimin me mekanizmat e tregut, janë më të larta sesa ato që burojnë nga aktivitetet brenda firmës, në atë rast do të preferohet trupëzimi, që mund të bëhet duke krijuar një filial të huaj. Casson (1982) e aplikoi të njëjtin model për tregjet ndërkombëtare. Ai shpjegoi se ndërmarrjet shumëkombëshe krijohen kur kostot shtesë të trupëzimit nëpërmjet IHD-së janë më të vogla se përfitimet nga kostot më të ulëta të transaksioneve. Duke ndjekur të njëjtën logjikë, Hood dhe Young (1979) i konsiderojnë IHD-të si rrjedhim i mungesës së perfeksionit të tregjeve në të gjithë botën. Sipas modelit të tyre, përparësitë që këto tregje joperfekte krijojnë dhe u japin ndërmarrjeve shumëkombëshe mundësi të konkurrojnë në një ambient të huaj. Përparësitë e tilla mund të burojnë nga: aftësitë teknologjike, aftësitë e marketingut, strukturës dhe sjelljes oligopolistike të tregjeve, kapaciteteve administruese dhe faktorëve financiarë e monetarë që përfshijnë kapital të lirë dhe diversifikim investimesh, mundësive të përdorimit të lëndëve të para me kosto të ulët etj.

2.4.8. Teoria e IHD-ve që bazohet në resurset ekonomike

Teoria e bazuar në resurset ekonomike fokusohet më shumë në resurset ekonomike sesa produktet (Kim, 2000). Kjo teori që shpjegon sjelljen e IHD-ve bazohet më shumë në konceptet mbi teorinë e firmës të zhvilluar nga Coase (Barney, 1991; Grant, 1991). Kjo teori konsideron përparësitë konkurruese të firmës si rezultat i pozicionimit më të mirë të firmës në treg dhe përparësitë e firmës që rezultojnë nga vlefshmëria e resurseve (Barney, 2001). Evidenca empirike e literaturës që trajton teoritë që bazohet në vlefshmërinë e resurseve ekonomike konsideron resurset ekonomike si bazë të nevojshme të firmës për të qenë e suksesshme. Këto resurse ekonomike përfshijnë:

resurset financiare, resurset fizike, resurset humane dhe resurset organizative (Barney, 1991; Grant, 1991; Idris et al., 2003; Hill and Jones, 1992; Bowman and Asch, 1987; Brown and Gutterman, 2003; Becker, 1976; Hall, 1992; Williamson, 1975; Barney, 1991; Caldeira and Ward, 2003). Kjo teori fokusohet më shumë në përparësitë ekonomike që lidhen me kompleksitetin e menaxhimit të aktiviteteve të biznesit në një ekonomi inovative dhe të paqëndrueshme (Dunning, 2001). Teoria që mbështetet mbi resurset ekonomike mund të përdoret në këtë studim për të studiuar se si faktorët e brendshëm të firmës, siç janë: kapitali human, kapitali fizik, resurset financiare mund të përcaktojnë nivelin e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore.

2.4.9. Teoria e IHD-ve që bazohet në rrjetin e biznesit

Teoria që bazohet në rrjetin e biznesit është fushë e shkencave sociale që aplikohet në studimet në ekonomi dhe biznes. Kjo teori definon marrëdhëniet në mes firmave për të mbështetur shkëmbimin e informacionit në mes anëtarëve që operojnë brenda një aktiviteti biznesor. Kjo teori mund të verifikojë rëndësinë e faktorëve kryesorë që shërbejnë për zgjedhje të aktivitetit të IHD-ve, në raport me format e tjera të organizimit të biznesit. Teoria e IHD-ve, që mbështetet në konceptet e rrjetit biznesor, bazohet në një sërë marrëdhëniesh në mes firmave, duke përfshirë aleancat strategjike, sipërmarrjet e përbashkëta, partneritetet dhe format e tjera të organizimit të aktivitetit biznesor përmes licensimit dhe patentimit të produkteve (Ebers dhe Jarillo, 1998; Gowa dhe Mansfield, 2004). Castells (2000) konsideron rrjetin biznesor si një formë të re të paradigmes elektike dhe e trajton atë si nyje themelore nga e cila mund të zhvillohen organizata të reja. Një rrjet mund të përkufizohet si “një marrëdhënie afatgjatë midis

organizatave si aktorë që ndajnë burimet për të arritur objektivat e negociuara për veprime të përbashkëta” (Porras et al., 2004). Në përputhje me këtë, shumë autorë kanë definuar rrjetin në pajtueshmëri me përkufizimet e Porras et al. (2004). Mills et al. (2003) brenda përkufizimit të rrjeteve përfshin: grupet e interesit brenda shoqërisë, marrëdhëniet e personelit të kompanisë me furnizuesit, klientët, institucionet qeveritare, autoritetet legislative dhe këshilltarëve. Jarillo (1988) në punimin e tij mbi teorinë e rrjetit është përpjekur për t’iu përgjigjur pyetjes kërkimore: nëse firmat duhet të prodhojnë brenda vendit apo të fokusohen në burimet e jashtme? Në studimin e tij dha konkluzionin se firmat nuk duhet të trupëzojnë aktivitetet e prodhimit, por të shërbehen me aktivitetet e outsourcing, përmes bashkëpunimit me partnerët, pasi që kostoja totale e outsourcing (bashkëpunimit) është më e ulët sesa kostoja e prodhimit. Kjo teori që bazohet në rrjetin e biznesit, mbështet gjetjet empirike të Jarillo-s (1998), duke konkluduar që rrjeti i biznesit zhvillon kapitalin social, mundëson krijimin e vlerës së re dhe redukton kostot e transaksioneve. Gjetjet e kësaj teorie mbështesin hipotezën se zhvillimi i lidhjeve të biznesit të firmave lokale me firmat e huaja përcaktohet nga madhësia e firmës, lokacionit të firmës, kushtet e hyrjes së firmave në treg dhe natyrës së rrjetit të prodhimit (Chang et al., 2006). Këto gjetje empirike, gjithashtu, u mbështetën edhe nga konkluzionet e studimit të zhvilluar nga Girod dhe Rugman (2005), të cilët analizuan marrëdhëniet në mes aktiviteteve të IHD-ve dhe rrjetit biznesor. Këta autorë në studimin e tyre argumentuan faktin se lidhjet e rrjetit ndihmojnë në tejkalimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe kufizimeve të brendshme të firmës. Qëllimi i rrjetit përmes IHD-ve është të përdoren resurset ekonomike të një vendi tjetër dhe të trajtohen si burime të avantazhit konkurrues, si: inteligjenca e tregut,

teknologjitë know-how, eksperiencia menaxheriale ose thjesht reputacioni që mund të sigurohet nga themelimi i firmës në një treg prestigj.

2.4.10. Teoria strategjike e Porter-it

Një tjetër interpretim mbi kompanitë shumëkombëshe (KSHK) është i pranishëm në kërkimet dhe publikimet e Michael Porter-it, të shkollës së Biznesit të Harvard-it (*Harvard School of Business*). Në librin e tij, të vitit 1990, “Avantazhi Krahësues i Kombeve” (“*Competitive Advantage of Nations*”), si dhe në shkrimet e tij, Porter argumenton se KSHK-të kanë hyrë në epokën e menaxhimit strategjik.

Në zhvillimin e teorisë së tij të menaxhimit strategjik, Porter ndjek konceptin e teorisë elektike të avantazheve të brendshme, organike të KSHK-ve. Por avantazhi kryesor i KSHK-ve mbi firmat vendase, sipas Porter-it, është se ata ofrojnë akses për një grup të tërë strategjish të mundshme përmes të cilave KSHK-të mund të zgjedhin në “zinxhirin e vlerave”. Në dallim nga një firmë vendase, një firmë shumëkombëshe mund t’i kryejë veprimtaritë e saj në vendndodhjen lokale më eficiente për secilën veprimtari të veçantë kudo nëpër botë. Thelbi i menaxhimit strategjik është se firma shumëkombëshe ka në dispozicion të vet një arsenal më tepër opsionesh e teknikash se sa kanë firmat më të mëdha kombëtare. Në këto mekanizma futen jo vetëm IHD-të, por edhe aleancat strategjike, teknologjitë dhe licensimi. Këto veprimtari të firmave ndërthuren e krijojnë komplekse apo rrjete ndërkombëtare marrëdhëniesh të këtyre firmave me KSHK-të prindër në vendin e tyre të origjinës. Përmes teknologjive moderne të informacionit dhe monopolit të burimeve të informacionit, KSHK-të arrijnë të bëhen mbizotëruese edhe ndaj konkurruesve kombëtarë. Një përshkrim i tillë i strategjisë së një firme, i strukturës

dhe veprimtarisë së saj, ka shkuar shumë më tej nga pikëpamja e zhvillimit në detaje, se sa portretizoi Vernon në teorinë e tij të ciklit të jetës së produktit apo edhe teoria elektike e Dunning-ut (Gilpin, 2000).

2.5. Klasifikimi alternativ i teorive mbi faktorët përcaktues të IHD-ve, që mbështetet në teorinë e Lokacionit të IHD-ve

Teoritë e IHD-ve mbështeten edhe në klasifikime alternative që varen nga qëllimet e hulumtimit (Dunning, 1973). Ky klasifikim ka për bazë pyetjen hulumtuese: Përse firmat investojnë jashtë shtetit? Studimet e Dunning-ut argumentojnë se faktorët kryesorë që konsiderojnë investitorët e huaj, që lidhen me motivet e tyre ndërmarrëse të aktivitetit të IHD-ve në tregjet ndërkombëtare, janë stabiliteti politik dhe perspektiva e rritjes së tregut nacional të tregjeve potenciale të IHD-ve. Megjithatë, Dunning është vetë kritik në këtë vlerësim, për shkak se dështon në dallimin mes faktorëve motivues dhe faktorëve përcaktues të IHD-ve (Dauti, 2015). Teoria e kapitalit është një qasje alternative që mundohet të shpjegojë arsyet pse firmat fokusojnë aktivitetet e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe zhvendosin kapitalin e tyre jashtë shtetit amë. Kjo teori merr për bazë normat e interesit midis vendeve origjinë dhe pritëse të IHD-ve dhe vlerësimet e risqeve të ndryshme politike dhe ekonomike që lidhen me aktivitetet e IHD-ve, në vendin origjinë dhe vendin pritës (Dunning, 1973). Qasja e tretë që mundohet të japë shpjegim për pyetjen hulumtuese: Pse firmat fokusojnë aktivitetet e tyre në tregjet ndërkombëtare? Kjo teori mbështetet në teorinë e tregtisë dhe mundohet të japë shpjegime lidhur me lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, por dështon në shpjegimin e lëvizshmërisë së faktorëve të prodhimit. Përpjekjet më të fuqishme për inkorporim të lëvizjeve të kapitalit në teorinë e tregtisë në vitet e fundit kanë ardhur nga

dy drejtime. Propozimi i parë është se tregtia me lëvizjet e kapitalit janë zëvendësues me njëra tjetrën dhe propozimi i dytë supozon ndryshimet në teknologji apo avancimet në njohuri. Megjithatë, duke futur dimension të ri të skenarit botëror për aktivitetin e biznesit ndërkombëtar, Dunning (1998), identifikon tre tipare që ndikojnë në ndryshimin gjeografik të lokacionit që lidhen me aktivitetet e IHD-ve:

Shfaqja e kapitalit intelektual, e cila përbën përqindje të lartë të shpenzimeve kapitale vjetore me komponentë të njohurive të fuqisë punëtore, konsiderohet tipari më i rëndësishëm që mundëson krijimin e pasurisë në shumicën e ekonomive industriale.

Globalizimi, rritja e aktivitetit ekonomik ka ndikuar dukshëm në reduktimin e barrierave në tregti dhe investimeve kapitale në tregjet ndërkombëtare.

Gjithashtu, *zhvillimet në infrastrukturë dhe teknologji* kanë mundësuar rritje të shpejtë të ekonomive në tranzicion. Këto hipoteza shërbejnë si gurë themeli në studimet e Dunning-ut, mbi krijimin e aseteve të ekonomive të vendeve industriale.

Gjatë viteve '90-të, Dunning (1998), duke analizuar qasjen mikroekonomike për faktorët përcaktues mbi IHD-të, thekson se vendimet e IHD-ve nuk varen vetëm nga lloji i aktivitetit në të cilin angazhohen investitorët e huaj, por edhe nga motivet e tyre për investime në tregjet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, qasja mikroekonomike e studimeve që lidhen me vendndodhjen e IHD-ve, arrin të diferencojë ndërmjet motiveve për IHD-të dhe faktorëve përcaktues për IHD-të, në krahasim me vitet '70-të, ku ky diferencim nuk arriti të bëhet. Në motivet për investime përfshihen faktorët kërkues të eficensës, faktorët kërkues të burimeve ekonomike dhe faktorët kërkues të tregjeve. Megjithatë, disa prej variablave të gjetur nga Dunning, duke ndikuar në vendndodhjen e vlerës së shtuar nga aktivitetet e IHD-ve, si krahasim në mes të viteve 1970 dhe 1990, janë paraqitur në tabelën 2.

Tabela 2: Faktorët që ndikojnë në aktivitetet e IHD-ve, përgjatë viteve 1970 dhe 1990.

Llojet e IHD-ve A. Kërkues të burimeve	Në vitet 1970	Në vitet 1990
B. Kërkues të tregjeve	1. Kualiteti i resurseve natyrore, çmimet e faktorëve të prodhimit. 2. Infrastruktura e nevojshme që mundëson eksplorimin e resurseve. 3. Restriksionet qeveritare mbi IHD- të dhe mbi kapitalin e jashtëm. 4. Motivet mbi investimet: p.sh. taksa të ulëta.	1. Krijimi i kushteve lokale për rritje të cilësise së resurseve dhe transportimi i outputit bëhet i rëndësishëm për motivet e lokacionit. 2. Ekzistenca e partnerëve lokal për të promovuar njohuritë dhe eksplotimin e burimeve kapitale.
C. Kërkues të eficensës	1. Kosto e prodhimit (p.sh. kosto e punës, materialeve, makinerisë etj.). 2. Liria e tregtisë për të mirat e ndërmjetme dhe të mirat finale. 3. Prezenca e ekonomive në rritje, p.sh. zonave teknike, teknologjike dhe industriale. 4. Motivet mbi investimet. Taksa të ulëta, subvencioneve qeveritare.	1. Rritja e shpërndarjes gjeografike të njohurive dhe nevojës së firmave për posedim të aseteve në lokacione të huaja. Kjo rrit motivet për IHD-të. 2. Rritja e rolit të qeverisë në eliminim të pengesave që lidhen me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike dhe specializimi i resurseve humane përmes programeve edukuese dhe trajnuese për procesin e përshtatshëm teknologjik të prodhimit. 3. Ekzistenca e sistemeve specializuese për mbështetje të zonave industriale, sistemeve mbështetëse të shërbimit, dhe faktorëve të specializuar të inputeve.

Burimi: John H. Dunning, 1998.

2.5.1. IHD-të që mbështeten në faktorët kërkues të tregjeve

IHD-të që mbështeten në faktorët kërkues të tregjeve janë horizontale dhe qëllimi i tyre është shërbimi i tregjeve lokale dhe rajonale (Kinoshita dhe Campos, 2004). Firmat shumëkombëshe që, për bazë të aktivitetit të tyre ndërmarrës për IHD-të, kanë orientimin nga tregu, tentojnë të investojnë në mënyrë të tillë që t'u shërbejnë nevojave të vendit pritës për mallra e shërbime cilësore (Johnson, 2006). Faktorët kryesorë që konsiderojnë IHD-të e orientuara drejt tregjeve janë: madhësia e tregut, e cila mund të matet me madhësinë e vlerës së PPB-së dhe cilësia e kërkesës së tregut, e cila mund të matet me PPB-në për frymë.

2.5.2. IHD-të që mbështeten në faktorët kërkues të burimeve

IHD-të e orientuara drejt burimeve në ndërmarrjen e aktiviteteve të tyre drejt investimeve në tregje të huaja, konsiderojnë faktorë të tillë, si: vlefshmëria e burimeve natyrore në vendet pritëse të IHD-ve, kosto e ulët e fuqisë punëtore dhe lëndës së parë (Dunning, 1981). Dunning argumenton se kërkimi i burimeve ishte forma më e rëndësishme e IHD-ve që u zhvillua gjatë shekullit të19-të. IHD-të e orientuara drejt burimeve janë IHD-të vertikale dhe të orientuara drejt eksportit (Johnson, 2006). Ky lloj i IHD-ve ka për qëllim të shërbejë jo vetëm për tregun vendas, por edhe për tregun e vendit origjinë të IHD-ve. Ekzistenca e burimeve natyrore, kostoja e ulët e fuqisë punëtore, ajo e lëndës së parë dhe infrastrukturës së zhvilluar, në vendet pritëse të IHD-ve, përbëjnë faktorët kryesorë të IHD-ve që udhëhiqen me motive për kërkim të burimeve.

2.5.3. IHD- të që mbështeten në faktorët kërkues të eficensës

Lloji i IHD-ve që udhëhiqen nga faktorë kërkues të eficensës ndodhin në rastet kur firma mund të fitojë nga qeverisja e përbashkët e aktiviteteve të shpërndara gjeografikisht në praninë e ekonomive të shkallës (Johnson, 2006).

IHD-të e orientuara nga faktorë të eficensës përfshijnë aktivitete të investimit të firmave shumëkombëshe në tregje ndërkombëtare, me qëllim të reduktimit të kostove të prodhimit të produkteve dhe shërbimeve që prodhojnë në ato tregje. IHD-të e orientuara drejt eficensës, konsiderohen si IHD vertikale.

2.6 Investimet e Huaja Direkte dhe rritja ekonomike

Marrëdhëniet në mes të Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes ekonomike janë studiuar në mënyrë intensive në literaturën e ekonomisë së zhvillimit si teorikisht, ashtu dhe empirikisht. Kohët e fundit është paraqitur interes i rritur në studimin e faktorëve përcaktues të rritjes ekonomike dhe hulumtimit të konsiderueshëm të faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike. Për këtë qëllim, janë trajtuar edhe teoritë endogjene të rritjes. Për dallim nga modeli neoklasik që bazohet vetëm në dy faktorë prodhimi (puna dhe kapitali) dhe që supozon që teknologjia është faktor ekzogjen, teoria e re e rritjes ekonomike integron progresin teknologjik dhe përparimet në fushën e dijes, si faktorë endogjenë brenda modelit të rritjes. Përparimi teknologjik është konsideruar endogjen, sepse përparimet teknologjike janë rezultat i veprimeve të vetëdijshme për të bërë investime nga sipërmarrësit dhe firmat e veçanta. Firmat supozohen që të investojnë për kërkime shkencore dhe për veprimtaritë zhvilluese për të njëjtat arsye që ato investojnë

në faktorë të tjerë prodhimi, pra nisur nga perspektiva e fitimit të pritshëm nga ai investim. Në fakt, teoria e re e rritjes ekonomike supozon se dituria, teknologjia dhe dija se si bëhen gjërat në përgjithësi (know-how) përbëjnë një faktor më vete shtesë prodhimi në drejtim të kapitalit dhe punës. Koncepti i njohurive dhe teknologjisë si faktor më vete të prodhimit ka sjellë risi në kuptimin e rritjes ekonomike. Dituria, njohuritë se si bëhen gjërat luajnë rol në rritjen e produktivitetit edhe të dy faktorëve të tjerë.

Ndërsa dituria dhe teknologjia thjesht shfaqen, ndodhin vetvetiu sipas modelit neoklasik, teoria e re e rritjes ekonomike supozon se ato të dyja së bashku janë rezultat i vendimeve të ndërgjegjshme dhe se përparimi teknologjik nxitet nga forcat e tregut. Investimet në drejtim të kapitalit dhe të diturisë mund të stimulojnë dhe përforcojnë njëri-tjetrin. Këto teori në mënyrë të besueshme përfshinë edhe IHD-të si një nga faktorët endogjen përcaktues të rritjes ekonomike afatgjatë. Nisur nga ky këndvështrim, kohëve të fundit është realizuar një numër i madh studimesh, që lidhen me rolin e Investimeve të Huaja Direkte në nxitjen e rritjes ekonomike. De Mello (1997) liston dy kanale kryesore, nëpërmjet të cilave IHD-të mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Së pari, IHD-të mund të inkurajojnë futjen e teknologjive të reja në procesin e prodhimit. Së dyti, IHD-të mund të stimulojnë transferime të dijes, si në aspektin e trajnimit të punës dhe blerjen e aftësive ashtu duke futur praktikë alternative të menaxhimit dhe marrëveshjet më të mira organizative.

Një studim nga OECD-ja (2002) mbështet këto vërejtje, si dhe nga këto studime kanë gjetur se IHD-të kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave dhe produktivitetit të faktorëve. De Mello (1997) dhe OECD-ja vërtetojnë se ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike të vendit pritës varet kryesisht nga kushtet ekonomike dhe teknologjike në

vendin pritës. Në veçanti, duket se vendet në zhvillim duhet të arrijnë një nivel të caktuar të zhvillimit, në arsim dhe/ose në infrastrukturë, para se ata të jenë në gjendje për të kapur përfitimet e mundshme që lidhen me Investimet e Huaja Direkte. Për këtë arsye, IHD-të duket se kanë ndikim të kufizuar në rritjen ekonomike në vendet teknologjikisht më pak të përparuara.

Katër autorë, duke u mbështetur në analizë regresi, duke shfrytëzuar të dhëna të kryqëzuara ndërmjet vendeve, kanë trajtuar faktorët e nevojshëm për identifikimin e një ndikimi pozitiv të IHD-ve në rritjen ekonomike.

Lidhur me këtë, Blomström et al. (1996,1998) argumenton se IHD-të kanë efekt pozitiv në rritje, aq më shumë, kur një vend është mjaft i pasur në aspektin e të ardhurave për frymë.

Së dyti, Balasubramanyam et al. (1996) vërtetojnë se niveli i hapjes së tregtisë matur përmes shumës totale të eksporteve dhe importeve në raport me PPB-në paraqet një ndër faktorët vendimtar që ndikon pozitivisht në rritje të IHD-ve dhe në PPB-në.

Së treti, Borenztein et al. (1998) vërteton se IHD-të ndikojnë në rritjen ekonomike, por vetëm në vendet ku forca e punës ka arritur një nivel të caktuar të arsimit.

Së fundi, Alfaro et al. (2001, 2003, 2004) vërteton se në vendet me tregje financiare të zhvilluara, IHD-të promovojnë rritjen ekonomike. Megjithatë, Carkovic dhe Levine (2002) vlerësojnë efektet e IHD-ve në rritjen ekonomike pas kontrollit të endogjenitetit ndërmjet variablave dhe efekteve specifike të vendit, gjejnë që, IHD-të nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm statistikor në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë.

Një pjesë e këtij punimi është fokusuar më shumë në marrëdhëniet shkakësore midis Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes, duke përdorur metodologjinë Granger Causality. Autorë të ndryshëm kanë aplikuar metodologjinë Granger për të testuar

lidhjen shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe PPB-së dhe PPB-së e IHD-ve. Testet Granger të lidhjes shkakësore, kryesisht bazohen në një model të korigjimit të gabimit. Zhang (2001), duke analizuar 11 vende, vërteton një lidhje të fortë Granger-shkakësore midis rritjes së IHD-ve dhe rritjes së PBB-së. Chowdhury dhe Mavrotas (2005), duke përdorur modelin e specifikuar nga Toda dhe Yamamoto (1995) dhe duke përdorur të dhënat vjetore për periudhën 1969-2000, gjejnë që IHD-të nuk shkaktojnë rritjen e PPB-së në Kili, ndërsa për vendet, si Malajzi dhe Tajlandë vërtetohet lidhje e fortë shkakësore ndërmjet rritjes së IHD-ve dhe rritjes së PPB-së, dhe e kundërta. De Mello (1999), duke analizuar mostrën prej 32 vendesh, 17 prej të cilave janë vende jo të OECD-së, vërteton efektin afatgjatë të IHD-ve në rritjen ekonomike.

Sidoqoftë, De Mello nuk arrin të vërtetojë lidhje të fortë shkakësore ndërmjet rritjes së PPB-së dhe IHD-ve për vendet jo anëtare të OECD-së. Nair-Reichert dhe Weinhold (2001), duke përdorur të dhëna të serive kohore dhe të dhëna të kryqëzuara, për 24 vende, për periudhën 1971-1995, e njëjtë si De Mello, theksojnë heterogjenitetin si një çështje serioze dhe, për këtë arsye, përdorin metodologjinë e efekteve fikse për të testuar ndikimin e IHD-ve në rritjen ekonomike. Autorët gjejnë që IHD-të, në mesatare, kanë një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike, edhe pse marrëdhënia është shumë heterogjene në të gjithë vendet. Choe (2003) përdor metodën tradicionale panel të të dhënave për të studiuar lidhjen kauzale në një grup të të dhënave prej 80 vendeve. Rezultatet e tij gjithashtu konfirmojnë lidhjen shkak-pasojë midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike. Basu et al. (2003) trajton çështjen e lidhjes së dyanshme ndërmjet rritjes dhe IHD-ve. Autorët gjejnë një marrëdhënie bashkëpunimi të integruar midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike duke përdorur një panel prej 23 vendeve.

Basu et al. (2003) vërtetojnë faktorin e hapjes së tregtisë si një faktor përcaktues vendimtar për ndikimin e IHD-ve në rritjen ekonomike, si në periudhën afatshkurtër, po ashtu edhe në periudhën afatgjatë.

Duke përmbledhur literaturën empirike që trajton lidhjen kauzale në mes rritjes së IHD-ve dhe rritjes së PPB-së, mesazhi kryesor që nxiret nga shqyrtimi i literaturës empirike, është se lidhja ndërmjet IHD-ve dhe PPB-së nuk duket të jetë një lidhje e qëndrueshme për të gjithë kategoritë e vendeve.

Edhe pse marrëdhënia është shumë heterogjene në të gjithë vendet, studimet në përgjithësi pajtohen se IHD-të, mesatarisht, kanë një ndikim në rritje, dhe në këtë kuptim shkaktojnë rritjen e tipit Granger. Përfundimi kryesor nga ky përfundim i përgjithshëm është Carkovic dhe Levine (2002).

KAPITULLI III: INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE

3.1. Hyrje

Duke ndjekur procesin e tranzicionit të ekonomive të Evropës Juglindore nga sistemi qendror i planifikuar në sistemin e orientuar nga tregu mund të themi se ky kalim i suksesshëm nuk mund të bëhet pa ndihmën e flukseve të mëdha hyrëse të kapitalit të huaj. Prandaj, duke konsideruar rëndësinë e IHD-ve për vendet e EJT-së, në pjesën e parë të këtij kapitulli kemi trajtuar në mënyrë teorike rolin e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore gjatë tranzicionit ekonomik drejt tregut. Kjo pjesë fokusohet në avantazhet që sjellin IHD-të në zhvillimin ekonomik të vendeve të EJT-së. Pjesa e dytë e këtij kapitulli trajton zhvillimin ekonomik dhe problematikat në vendet e EJT-së. Pas kolapsit të komunizmit, secili nga vendet ish-komuniste të Evropës Juglindore u zhyt në një recension të ashpër dhe kaos ekonomik. Recensionin ishte aq spektakolar, sa që në shumë dokumente e analiza të FMN-së apo Bankës Botërore cilësohej si “fundosje ekonomike e vendeve ish-socialiste në tranzicion”. Në këtë pjesë të këtij kapitulli bëhet një analizë e rrugës së zhvillimit ekonomik të vendeve të EJT-së në periudhën e tranzicionit ekonomik. Në pjesën e tretë të këtij kapitulli, nëpërmjet evidencës empirike trajtohet dinamika dhe trendi i IHD-ve në vendet e EJT-së. Pjesa e katërt paraqet IHD-të në rajonin e EJT-së sipas vendit të origjinës. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli jemi fokusuar në marrëdhëniet e IHD-ve me treguesit e tranzicionit. Ky seksion argumenton se progresi i tranzicionit është i rëndësishëm për ekonomitë në tranzicion për të tërhequr më shumë fluksin e IHD-ve.

3.2. Rëndësia e IHD-ve gjatë tranzicionit ekonomik në vendet e EJT-së

Investimet e Huaja Direkte kanë fituar rëndësi të madhe gjatë dekadës së kaluar si një mjet për përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e ekonomive në tranzicion. Besohet gjerësisht se avantazhet që sjellin IHD-të në standardin e jetesës dhe perspektivën e rritjes ekonomike të vendit nikoqir, në masë të madhe, peshojnë më shumë se disavantazhet. Rëndësia e tyre qëndron në ndryshimin themelor nga format e tjera të investimeve kapitale: natyrën dhe kohëzgjatjen e angazhimit.

Fillimet e viteve '90-të sollën ndryshime të mëdha në vendet e Evropës Juglindore. Modeli ekonomik i perëndimit po përhapej me shpejtësi në ekonomitë e këtyre vendeve. Ky model, i shoqëruar nga sistemi i tij politik përfaqësonte një rrugë shumë më të mirë zhvillimi dhe jetese, sesa modeli i lindjes me ekonomi të planifikuar dhe sistem politik njëpartiak. Tranzicioni i ish-ekonomive të komanduara komuniste drejt shoqërive demokratike, të bazuara te tregu, është një nga çështjet më të rëndësishme të periudhës pas viteve '90-të. Tranzicioni nga socializmi në kapitalizëm është edhe një politikë dhe një proces ekonomik (Bevan dhe Estrin, 2004). Tranzicioni do të thotë se këto ekonomi janë në trajektoren e një lëvizjeje të njohur dhe të parashikueshme të kalimit nga komunizmi në kapitalizmin demokratik. E vërteta është se askush nuk e di realisht se çfarë faktorësh ekonomikë, politikë e të tjerë çuan në përbysjen e komunizmit (Gilpin, 2009). IHD-të janë promovuar nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare si një motor që luan një rol kryesor në tranzicionin e vendeve të Evropës Lindore e Qendrore nga ekonomi me drejtim të centralizuar në ekonomi tregu dhe integrimin e tyre në ekonominë botërore (FMN, 1997). Shumë vende në zhvillim kanë përfituar nga flukset e kapitalit në formën e IHD-ve.

Duke luftuar mungesën e kapitalit, nga e cila vuanin tregjet e mbyllura, ata kanë favorizuar krijimin e tregut të madh duke u shoqëruar me rritje të efektshmërisë të firmave, gjë që do të shoqërohej me ulje çmimesh dhe rritje të konkurrencës në tregjet e huaja. Para së gjithash, kapitali i huaj mund të përdoret për të shtuar kursimet e brendshme (e cila është zakonisht në nivelin e ulët) dhe kështu t'u mundësojë vendeve për të rritur normat e akumulimit të kapitalit. Rrjedhimisht, kjo duhet të përmirësojë perspektivat e rritjes afatgjatë dhe për të rritur pasurinë e popullsisë, me fjalë të tjera, të përshpejtojë procesin e zhvillimit. Sipas pikëpamjes tradicionale, Investimet e Huaja Direkte janë të shtyra kryesisht nga diferenca e çmimeve të faktorëve të prodhimit dhe të madhësisë së tregut kombëtar. Investitorët e huaj tentojnë të lëvizin procesin e tyre të prodhimit në vendet në zhvillim, me qëllim që të ushtrojë avantazhet e faktorëve më të lirë të prodhimit dhe strategjia e tyre është delokalizimi i fazave të prodhimit drejt vendeve me paga të ulëta. Në literaturën ekonomike, këto investime njihen si investime vertikale. Strategjia e IHD-ve në vendet e përparuara dhe të zhvilluara janë të shtyrë nga tregu dhe përfaqësojnë zhvendosjen e procesit të prodhimit drejt një vendi të huaj. Përdorimi efikas i burimeve, si dhe krijimi i një mjedisi konkurrues u afron investitorëve të huaj rendimente gjithnjë e më të larta. Në përgjithësi, flukset hyrëse të kapitalit të huaj kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të rëndësishme për rindërtimin e Rajonit të Evropës Juglindore dhe për integrimin e tij në ekonominë botërore (Xhaferaj, 2005). Lidhur me këtë, një numër i konsiderueshëm i vendeve kanë zhvilluar procesin e tranzicionit, duke aplikuar politika favorizuese ndaj investitorëve të huaj, me qëllim që të sigurojnë mundësi për të përdorur burime natyrore ose të rrisin eksportet e makinerive dhe pajisjeve, e në të njëjtën kohë, të gjenerojnë hyrje kapitali që përmirësojnë bilancin e pagesave. Justifikimi për politikat favorizuese ndaj IHD-ve

mbështetet gjithashtu edhe në argumentin që kthimet publike nga IHD-të tejkalojnë kthimet private, si rezultat i rritjes së produktivitetit të ekonomisë pranuese të IHD-ve, të cilët përkthehen në formën e eksternaliteteve pozitive, duke promovuar rritje dhe zhvillim të ekonomive dhe duke krijuar vende të reja pune (Blomstrom dhe Kokko, 2003). Si rezultat i rëndësisë së eksternaliteteve pozitive që vendet pranuese të IHD-ve pranojnë, faktorët përcaktues të motiveve të IHD-ve janë studiuar në mënyrë ekstensive në forma të ndryshme empirike. Njësitë ekonomike në vendet pranuese të IHD-ve përfitojnë transferime të njohurive dhe teknologjive nga vendet burimore të IHD-ve. Gjithashtu, firmat vendase, si rezultat i aktivitetit të IHD-ve, mund të përfitojnë nga konkurrenca perfekte, duke regjistruar përmirësim të qasjes ndaj eksporteve, veçanërisht në vendet burimore të IHD-ve, prandaj IHD-të konsiderohen si katalizatorë të transformimit ekonomik të ekonomive në tranzicion. Rëndësia e tyre shihet më shumë në sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare nga fonde të huaja, dhe në transferimin e kapitalit, njohurive dhe formave organizative nga vende me ekonomi relativisht më të zhvilluar (Blomstrom dhe Kokko, 2003). Kur fluksi i IHD-ve rezulton në rritje të normave të kursimit të brendshëm në vendet pranuese, atëherë efektet pozitive në ekonominë pranuese të IHD-ve ndodhin përmes eksternaliteteve pozitive, të cilat zhvillohen përmes lidhjeve me furnitorët lokal, zhvillimit të konkurrencës së lirë. Konkurrenca e lirë zhvillohet përmes hyrjes së firmave të reja nga tregje të huaja në vendet pranuese të IHD-ve. Hyrjet e firmave të reja në tregjet vendase ndikojnë në rritje të kërkesës së produkteve të vendit dhe kjo ndikon më tej në ofrimin e produkteve të ndryshme nga firmat vendase dhe të huaja në tregje me konkurrencë jo të plotë. Kjo shumëllojshmëri produktesh i bën firmat operuese në tregjet e konkurrencës jo të plotë më konkurrues në raport me çmimin dhe koston e produkteve. E gjithë kjo rezulton me

rritje të konkurrencës, ulje të fitimeve, duke vënë në rrezik ekzistencën e firmave më pak eficiente. Forcimi i konkurrencës bën presion për ulje të marzhit të fitimit, çmimeve dhe fitimeve. Ulja e çmimeve pasohet nga procesi i ristrukturimit industrial që, për firmat më pak eficiente, nënkupton falimentimin, blerjen nga të tjerat ose shkrirjen në firma më të mëdha.

Si rezultat, Evropa ka industri me strukturë të përbërë nga firma më të mëdha dhe më eficiente e që konkurrojnë fuqishëm. Përfitimet janë në terma të çmimeve më të ulëta për konsumatorët dhe të sasisë më të lartë të konsumit, që do të thotë rritje të mirëqenies. Kjo gjithashtu motivon vendet pritëse të IHD-ve të aplikojnë politika favorizuese ndaj investitorëve të huaj. Investimet e Huaja Direkte shoqërohen edhe me efekte indirekte, të jashtme, që ndryshe janë quajtur “rrjedhje” (*spillovers*). Termi “rrjedhje” nënkupton efektet indirekte, të gjeneruara nga prania e kompanive të huaja, në strukturën ekonomike të vendit pritës. Këto efekte u shtjelluan nga Blostrom dhe Kokko (2003), duke u quajtur si “rrjedhje të produktivitetit” dhe “rrjedhje të hyrjes në treg”. Sipas kësaj ndarjeje, “rrjedhje të produktivitetit” krijohen kur, një firmë vendase përmirëson produktivitetin e vet duke imituar disa teknologji të përdorura nga kompanitë shumëkombëshe që operojnë në tregun vendas; hyrja e një filiali të huaj çon në rritjen e konkurrencës në ekonominë vendase dhe i detyron firmat vendase të përdorin me efikasitet të lartë burimet dhe teknologjinë ekzistuese duke kërkuar njëkohësisht teknologji të reja për të përballuar konkurrencën e rritur në treg. “Rrjedhje të hyrjes në treg” krijohen në rastet kur firmat vendase bëhen më të afta të administrojnë vetë të gjitha aspektet komplekse të trupëzimit të kostove, si marketingun, shpërndarjen dhe mirëmbajtjen në prani të kompanive të huaja. Kjo mund të ndodhë sepse firmat vendase

mund të jenë nënkontraktore ose furnizuese të kompanive të huaja dhe mësojnë apo kopjojnë nga ata.

IHD-të janë konsideruar të rëndësishme për rritjen e mirëqenies në vendin pritës për shkak të avantazheve që lidhen me futjen e teknologjive të reja dhe inovacionit, teknikat e reja menaxheriale, zhvillimi i aftësive të tjera, rritja e kapitalit, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e kushteve të punës, si dhe zhvillimin e sektorit industrial në vendin pritës (Haddad dhe Harrison, 1993). Për shkak të këtij fakti, mund të kuptohet lehtë se pse kaq shumë vende në zhvillim kërkojnë mënyra të reja për rritjen e IHD-ve.

“Qoftë direkt apo i portofolit, investimet ndërkombëtare përmirësojnë shpërndarjen e burimeve botërore, duke drejtuar kursimet botërore atje ku janë më produktive, duke u lejuar vendeve pritëse të ruajnë nivele të qëndrueshme të investimeve dhe konsumit në vend të luhatjeve në të ardhurat e tyre, si edhe duke u dërguar sinjale të rëndësishme vendeve pritëse në lidhje me qëndrueshmërinë e politikave të tyre” (OECD, 1998).

Megjithatë, IHD-të mund të rezultojnë në pikëpamje negative në ekonomitë e vendeve pritëse, aq më shumë në qoftë se ajo i detyron ndërmarrjet vendase të mbyllën për shkak të paaftësisë së tyre për të marrë burimet e nevojshme për financimin e aktiviteteve të tyre dhe përmirësimin e teknologjisë së tyre (Jansen & Stockman, 2004). Haddad, Harrison (1993) dhe Blomstrom (1986) kanë argumentuar empirikisht se prania e investorëve të huaj ul shpërndarjen mesatare të produktivitetit në një sektor. Ata gjithashtu vërejtën se efekti pozitiv është më i rëndësishëm në sektorët me teknologji të thjeshtë, që do të thotë se prania e firmave të huaja forcon firmat lokale për t'u bërë më produktive në sektorët ku teknologjitë e tyre janë të cilësisë së ulët. Një tjetër disavantazh jo i drejtpërdrejtë i IHD-ve mund të jetë se, në sektorë ekonomik më pak

të zhvilluar të vendit pritës janë gjithmonë të papërshtatshme kur niveli i IHD-ve ndikon në mënyrë negative (Zoto, 2012).

3.3. Zhvillimi ekonomik dhe problematika në Evropën Juglindore

Fundi i sistemit socialist shënoi edhe fitoren evidente të sistemit kapitalist. Por, ndërkohë që “receta” për ndërtimin e kapitalizmit në vendet e lindjes ishte standarde, realiteti po i përballte këto vende me sfida të ndryshme. Pavarësisht nga zgjidhja për terapinë e shok-ut ose për rrugën graduale, pothuajse të gjithë vendet ish-socialiste, në fillimet e tranzicionit, kryesisht në periudhën 1989-1994, u përballën me situata të vështira ekonomike, financiare e sociale si pasojë e recensionit të thellë që pësuan.

Studimet dhe analizat për këtë periudhë evidentojnë tri arsye fundamentale që ndikuan në këtë situatë: tentativat për një stabilizim sa më të shpejtë makroekonomik; efekti i ndryshimeve institucionale; ristrukturimi mikroekonomik (Civici, 2014).

Recensioni pati karakteristikat e mëposhtme:

- u shfaq në fazën e dobësimit të aktivitetit ekonomik që kishte tendencë drejt stanjacionit, fazë kjo tipike në rritjen ekonomike ciklike të ekonomive socialiste;
- u karakterizua nga rënia absolute e prodhimit dhe investimeve;
- kalimi në fazën e rritjes nuk u shfaq për një periudhë të gjatë;
- gjatë 4-5 viteve të kohëzgjatjes së recensionit u shfaqen, krejt jashtë rregullit dhe logjikës ekonomike, momente të shkurtra rritjeje ekonomike (OECD,1977).

Periudha e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut, e filluar që në vitin 1990, u karakterizua me shfaqjen e diferencave të dukshme ndërmjet vendeve ish-socialiste. Në terma të përgjithshëm, problemi i tranzicionit përfshin në vetvete zbatimin e disa detyrave komplekse e të vështira. Duhet të krijohen institucione të reja publike dhe duhen reformuar ose eliminuar strukturat e vjetra institucionale, po ashtu duhet të hartohen rregulla dhe rregulloret e kërkuara për funksionimin e ekonomisë së tregut. Duhet të kryhet privatizimi i sektorëve në pronësi shtetërore dhe të ndryshojë pronësia mbi mjetet e prodhimit nga pronësi shtetërore në private. Strukturat inefficente ekonomike të menaxhuara nga shteti duhet të likujdohen duke krijuar firmat private, të cilat mund t'i përshtaten më mirë ekonomisë së tregut. Duhet të zbatohet kudo parimi i tregut: sistemi i planifikuar duhet zëvendësuar me mekanizmin e çmimit, në kushtet e të cilit vendimet ekonomike përcaktohen nga reagimet e individëve dhe firmave në treg. Pas gjithë këtyre reformave ekonomike qëndron sfida edhe më e vështirë e krijimit të një kulture të re qytetare të moralit publik, të së mirës publike, si edhe një sensi kombëtar të përgjegjësisë shoqërore.

Pa një ndryshim të tillë moral e psikologjik nuk do të realizohet kurrë qëllimi i një tranzicioni të suksesshëm drejt një sistemi kapitalist demokratik (Gilpin, 2009). Megjithatë, mbas vitit 1995, pothuajse të gjithë vendet ish-socialiste duket se i kaluan pengesat kryesore të tranzicionit duke adaptuar një ekonomi tregu funksionale. Futja e shumicës së këtyre vendeve (përfshirë edhe Shqipërinë në vitin 2000) në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), shënoi fundin e izolimit të këtyre vendeve dhe integrimin në ekonominë dhe tregtinë botërore. Në fakt, integrimi i vërtetë fillon mbas vitit 2000, ku këto vende filluan procedurat e anëtarësimit në BE. Edhe pse ka kontradita midis ekonomistëve mbi treguesit ose kriteret që përcaktojnë fundin e tranzicionit, ka

pothuajse një unanimitet të plotë në konkluzionin se “anëtarësimi në BE është treguesi më i mirë për aplikimin e një ekonomie tregu reale e eficiente të këtyre vendeve”.

Ndërkohë që në Evropën Perëndimore dhe në SHBA, kriza globale financiare e viteve 2008-2013 e ktheu më shumë vëmendjen te roli dhe prania e shtetit në ekonomi, vendet ish-socialiste, që prej shumë vitesh ishin “bastione të liberalizmit”, nuk dukeshin të gatshme të pranonin largimin ose reduktimin e tij. Politikanët lindorë nuk ishin dakord me rikthim të modelit Keynesian të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi në rregullimin e tregjeve, në mënyrë që të sigurohet shoqëria nga katastrofa të tilla financiare. Ata kërkonin një Evropë liberale, ndërkohë që ata bashkë me lideret evropianë duhej të përballonin një krizë ekonomike që nuk njihte kufij e barriera (Civici, 2014). Në fillim të krizës, shumica e vendeve të lindjes mendonin se kriza nuk ishte për ta, pasi ajo u përkiste vendeve të zhvilluara kapitaliste. Megjithatë, parë në tërësinë e tyre, vendet ish-socialiste u tronditën nga kriza financiare 2008-2013 dhe reagueshan ndaj saj duke diskutuar për vlerat dhe recetat e liberalizmit të pastër politik e ekonomik.

Zhvillimet ekonomike afatshkurtra për gjashtë vende të Evropës Juglindore (EJL-6): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia - varen ndjeshëm nga faktorë që janë kryesisht përtej kontrollit të qeverive të vendeve të EJL-6. Liderët e vendeve kryesore të BE-së ende po përpiqen të zbatojnë një grup politikash të besueshme për të arritur një proces të rregullt të menaxhimit të borxhit të Greqisë, për të parandaluar rreziqet e përhapjes së tij në ekonomitë e tjera të Eurozonës, për të siguruar rikapitalizimin e bankave të prekura nga shkurtimi i mundshëm i borxheve sovrane, si edhe për krijimin e një kuadri fiskal më të unifikuar dhe me efektiv fiskal për vendet e Eurozonës. Pasiguria në lidhje me mundësinë e përmbylljes me sukses të këtij procesi, si edhe e një sërë uljesh vlerësimi të borxheve dhe pasiguria në


lidhje me politikat e deficitit në SHBA ka tronditur besimin e investorëve dhe të biznesit dhe i ka bërë konsumatorët mosbesues. Një numër më i madh analistësh i ka ulur parashikimet për rritjen globale në SHBA dhe në BE. Kjo do të thotë se ritmet e rritjes do jenë shumë më të ulëta sesa ato përpara vitit 2008 me 6-10 për qind (tabela 3 dhe 4). Edhe këto parashikime modeste për rritjen ekonomike kanë në bazë të tyre supozimin që liderat evropianë janë në gjendje ta zgjidhin krizën duke shmangur një falimentim të çrregullt dhe përhapjen e saj. Megjithatë, në rast se hartuesit e politikave dështojnë dhe kriza përkeqësohet, performanca e vendeve të EJT-6 dhe e pjesës tjetër të globit mund të jetë edhe më negative.

Tabela 3: Rritja ekonomike në Evropën Juglindore (%).

Vendet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëri	5.7	5.8	5.4	5.9	7.5	3.3	3.8	3.1	1.3	0.9
Bosnje	6.3	3.9	5.5	6.0	5.6	-2.8	0.7	1.0	-0.7	0.6
Kroaci	4.1	4.3	4.9	5.1	2.1	-6.9	-2.3	0.0	-2.0	-1.0
Maqedoni	4.6	4.4	5.0	6.1	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.2	2.1
Mali i Zi	0	0	0	0	0	-5.7	2.5	3.2	-2.5	1.8

Burimi: UNCTAD, 2014.

Figura1: Rritja ekonomike në Evropën Juglindore (%).



Burimi: UNCTAD, 2014.

Tabela 4: Disa tregues makroekonomik të Evropës Juglindore.

Vitet	PPB nominal	PPB real	Deflatori i PPB - së	Remitancat	Rritja ekonomike (%)
1990	2,222	5,322	(58.25)		8.3
1991	1,656	3,831	(56.77)		13.3
1992	1,574	3,556	(55.74)	21.40	9.1
1993	1,762	3,897	(54.77)	27.03	-10.2
1994	1,949	4,220	(53.83)	15.47	12.7
1995	2,479	4,782	(48.16)	17.62	10.1
1996	3,315	5,217	(36.46)	18.28	7.3
1997	2,325	4,651	(50.03)	13.67	7
1998	2,717	5,070	(46.42)	18.48	2.9
1999	3,425	5,755	(40.49)	11.86	5.7
2000	3,640	6,136	(40.69)	16.22	5.9
2001	4,066	6,624	(38.62)	17.09	5.5
2002	4,443	6,904	(35.64)	16.49	5
2003	5,696	7,300	(21.98)	15.72	5.9
2004	7,307	7,714	(5.28)	15.55	7.7
2005	8,159	8,159	0	15.40	3.3
2006	8,993	8,602	4.55	14.89	3.5
2007	10,701	9,110	17.47	13.72	8.3
2008	12,984	9,796	32.54	11.61	13.3
2009	12,088	10,121	19.44	10.95	9.1
2010	11,762	10,502	11.99	9.69	-10.2
2011	12,709	10,826	17.39	8.73	12.7
2012	12,044	10,967	9.83	8.32	10.1

Shënim: PPB real është i bazuar me çmimet konstante të vitit 2005 dhe kursin konstant të këmbimit të vitit 2005 shprehur në miliona dollarë amerikanë. PPB nominal është i llogaritur sipas mënyrës së shpenzimeve ose sipas vlerës shtesë të aktivitetit ekonomik. Deflatori i PPB – së paraqet raportin mes PPB nominal dhe PPB real. Remitancat personale paraqesin transferet dhe kompensimet e të punësuarve. Transfertat personale paraqesin të gjitha transfertat koherente në formë parash të gatshme apo në ndonjë formë tjetër, të pranuar nga individët rezidentë dhe nga individët jorezidentë.

Burimi: Banka Botërore, 2014.

Efektet e një ngadalësimi të mëtejshëm global dhe thellimit të krizës së eurozonës do t'u përcillen vendeve të EJT-6 përmes disa kanaleve, ku më kryesoret janë dy elementë ndërlidhës: kanali i qarkullimit të mallrave dhe qarkullimi i kapitaleve. Një numër studimesh janë bërë dhe kanë identifikuar katër fushat kryesore: kanalin e tregtisë, lidhjet financiare, brishtësitë dhe dobësitë strukturore financiare dhe kuadrin e përgjithshëm politik e institucional (Berkmen et al., 2009). Kanali i tregtisë i transmeton

efektet e tij në varësi të shkallës së hapjes tregtare, matur me raportin e tregtisë së jashtme ndaj PBB-së, të përbërjes strukturore të eksporteve edhe të gjeografisë së tregtisë së jashtme. Në përgjithësi, shkalla më e lartë e hapjes është në lidhje pozitive me intensitetin e transmetimit të efekteve të krizës. Vendet e BE-së dhe ato të Eurozonës (EZ), në veçanti, janë ndër partnerët më të rëndësishëm tregtar për të gjitha vendet e EJT-6: tregtia me BE-në është nga 30 për qind deri në pothuajse gjysmën e PBB-së të vendeve të EJT-6.

Sigurisht që në epokën e sotme kanali më i fortë i transmetimit të efekteve të krizës është ai i lidhjeve të tregjeve financiare. Edhe në këtë rast, shkalla e hapjes së tregjeve është lidhur pozitivisht me shtrirjen e krizave, ndërsa kufizimet në llogarinë kapitale dhe niveli i ulët i Investimeve të Huaja Direkte janë në lidhje negative. Përtej tregtisë, BE-ja është gjithashtu burimi më i lartë në agregat i IHD-ve për rajonin, ku vlera neto e prurjeve të IHD-ve e kalon 2 përqindshin e PBB-së të Ballkanit Perëndimor. Prania e bankave të huaja krijon një tjetër kanal të rëndësishëm të transmetimit potencial të krizës së eurozonës në vendet e EJT6, jo vetëm që përqindja e bankave të huaja në totalin e aktiveve në sistemin bankar të rajonit është shumë e lartë (afërsisht 89 për qind e totalit), por kjo prani e huaj në disa raste përfshin financime të konsiderueshme të huaja të aktivitetit të këtyre bankave (EJT, Raport i Zhvillimeve Ekonomike, 2011). BE-ja është gjithashtu një burim shumë i rëndësishëm i remitançave (dërgesave të emigrantëve) për rajonin.

Të gjitha këto kanale transmetimi do të ndikohen nga thellimi i tensioneve ekonomiko-financiare të BE-së dhe Eurozonës. Aktualisht, sistemet bankare në vendet e EJT-6 duken të qëndrueshme, me nivel të lartë likuiditeti dhe rezerva të larta kapitali, por kjo mund të ndryshojë papritur, sidomos për disa banka specifike. Rajoni i EJT-6

karakterizohet nga një përqindje relativisht të lartë të bankave me pronësi greke dhe italiane. Bankat austriake gjithashtu kanë një prani të rëndësishme në rajon, ndonëse këto banka përballen me më pak rreziqe të borxhit publik. Duke patur parasysh kërkesën e BE-së për rritjen e kapitalit të bankave, një trysni e mëtejshme mbi fondet e bankave përkatëse mëma mund të çojë në një presion mbi bankat e huaja për të siguruar likuiditet apo dividende për bankat mëmë.

Për më tepër, që nga viti 2009 ka patur një rritje të shpejtë të huave me probleme në të gjitha vendet e EJT-6. Që nga ajo periudhë, huatë me probleme janë stabilizuar në disa, por jo në të gjitha vendet, duke mbetur ende shumë lart niveleve të tyre të para krizës. Këta faktorë mund të shkaktojnë një tjetër ngërç kredie në rajon. Nga ana tjetër, bankat e huaja aktualisht duken likuide dhe me kapital të mjaftueshëm. Gjithashtu, pjesa më e madhe e tyre janë banka dhe jo degë, dhe rrjedhimisht janë objekt i monitorimit dhe rregullimit të mbikëqyrësve të vendeve të EJT-6-së. Po kështu, niveli i përgjithshëm i varësisë nga financimet e huaja të bankave të EJT-6 është më i ulët nga ai i vendeve të EJT-10-së. Kjo reflekton pjesërisht varësinë për fonde të bankave me pronësi të huaja në vendet e EJT-6-së nga depozitat vendase. Ndërkohë që situata ka nevojë për një monitorim të kujdesshëm. Megjithatë, financimet e huaja përbëjnë një burim të rëndësishëm në fondet e bankave për financimin e sektorit real, duke qenë se huamarrja e huaj direkte nga sektori real në vendet e EJT-6-së arrijnë afërsisht 18 për qind të PBB-së. Prurjet nga Investimet e Huaja Direkte dhe portofoli përbëjnë një burim më të qëndrueshëm financimi.

Megjithatë, Investimet e Huaja Direkte në vendet e EJT-6-së janë ngadalësuar që nga gjysma e dytë e vitit 2008 dhe tashmë janë në nivelin 60 për qind të nivelit të para krizës (EJT, Raport i Zhvillimeve Ekonomike, 2011). Në analizën e kuadrit të përgjithshëm

politik dhe institucional duhen trajtuar treguesit që karakterizojnë politikën monetare, të tillë si: niveli i inflacionit, paqëndrueshmëria e kursit të këmbimit dhe të rezervave valutore dhe vetë regjimi i kursit të këmbimit, si dhe politikat fiskale. Politikat monetare në disa prej vendeve të EJT-6-s kanë hapësirë të kufizuar veprimi, për shkak të regjimit të kursit të këmbimit që kanë adaptuar. Situata fiskale mbetet e brishtë: Serbia, Shqipëria dhe në veçanti Mali i Zi do të duhen të vazhdojnë reduktimin e deficiteve fiskale dhe reduktimin e borxhit.

Në të njëjtën kohë, autoriteteve u duhet të rigjenerojnë rezervat fiskale dhe të jenë të përgatitura për konsolidim të mëtejshëm të të ardhurave në rast mosplotësimi apo mospërbushje të parashikimeve për të ardhurat si rrjedhojë e përkeqësimit të kushteve globale. Gjithashtu, qeveritë e këtyre vendeve duhet të përmirësojnë klimën e investimeve dhe të reformojnë tregjet e punës dhe sektorin publik. Në çdo rast, gjendja e brendshme e tregjeve është faktori thelbësor dhe ndonjëherë përcaktues për intensitetin e krizës në një vend. Gjatë viteve të fundit, vendet e EJT-6-s i ezauruan rezervat modeste të krijuara gjatë periudhës së para krizës, kur pati një rritje të lartë ekonomike dhe të ardhura të begata. Për më tepër, tregjet e kapitaleve vendase janë të vogla e ndërsa bankat duket se kanë aktualisht pozicione të mira likuiditeti, kjo situatë mund të ndryshojë shumë shpejt në rast të një ngadalësimi më të theksuar të aktivitetit ekonomik. Për më tepër, aksesit në tregjet e jashtme financiare do të mbetet i vështirë për vendet e EJT-6-s në periudhën që do të vijë. Kjo do të thotë që vetëm pak nga vendet e EJT-6-s do të kenë ende mundësi për t'i bërë ballë një përkeqësimi të krizës përmes stimujve fiskalë apo përmes stabilizatorëve automatikë, ndërsa disa vendeve do t'u duhet të përshpejtojnë konsolidimin fiskal, në veçanti të reformave që forcojnë qëndrueshmërinë afatgjatë fiskale.

Pas disa vitesh krize të thellë dhe një rimëkëmbje të ngadaltë, me një papunësi dhe varfëri në rritje dhe me një recension në vazhdim, me gjithë përpjekjet e qeverive të vendeve të EJT-së për konsolidim fiskal e reforma strukturore, ekziston rreziku që vendet e EJT-së të jenë futur në një rreth vicioz që përfaqëson ciklin e ngadalësimit afatgjatë, të rritjes ekonomike të ulët ose negative, të borxhit publik të lartë dhe të trazirave të mundshme sociale. Këto vende e kanë konsumuar tërësisht hapësirën e tyre fiskale dhe i kanë reduktuar investimet publike. Investimet private janë tkurrur nga mungesa e investimeve publike plotësuese produktive, rimëkëmbja e ngadaltë e kreditimit dhe kërkesa e brendshme e ulët. Kërkesa e jashtme është minimale dhe eksportet janë jo vetëm të ulëta, por ato pengohen për t'u bërë motor i rritjes ekonomike nga problemet e infrastrukturës së dobët, financave etj. Është e rëndësishme të mbahet parasysh fakti që, pavarësisht nga kriza e kohëve të fundit, modeli i rritjes ekonomike i bazuar në thellimin e procesit të integritimit me BE-në në drejtim të financave, tregtisë, tregjeve të punës dhe institucioneve mbetet modeli më i mirë për vendet e EJT-6-ës në periudhën afatgjatë. Në epokën e neoliberalizmit me një theks të fortë mbi tregun e lirë, krijimi i një regjimi zhvillimi për këto vende nuk shtrohet për diskutim. Nga ana tjetër, tregtia e lirë dhe hapja ekonomike nuk përbëjnë në vetevete një zgjidhje të përshtatshme për problemin e prapambetjes në zhvillim apo të problemeve që kanë ekonomitë në tranzicion. Diku duhet të gjendet një kompromis midis dy ekstremeve, nga njëra anë braktisja e neoliberalizmit, nga ana tjetër, mbështetja e plotë te tregu. Dy janë mësimet bazë të ngjarjeve më të fundit që do t'u bëjnë të mundur vendeve të EJT-6-ës të shfrytëzojnë më mirë përfitimet e këtij modeli të rritjes ekonomike.

Mësimi numër një është që, në të ardhmen rritja ekonomike do të bazohet më shumë nga investimet dhe përmirësimet e produktivitetit që rrisin konkurrueshmërinë dhe

kapacitetet prodhuese e më pak nga konsumi i financuar nga jashtë dhe nga investimet në pasuri të paluajtshme dhe flukse të tjera aktivesh që karakterizuan periudhën përpara vitit 2009.

Mësimi numër dy është që, për pjesën më të madhe të vendeve të EJT-6-së mbetet një program i gjatë i papërfunduar i reformave fiskale dhe strukturore. Këto reforma duhen adresuar sa më shpejt për të përfituar aksesin në tregje, investimet e huaja direkte, financimet bankare dhe remitancat që ofron modeli i rritjes ekonomike i bazuar tek integrimi. Jeffrey Sachs ka argumentuar se, zgjidhja afagjatë e këtyre problemeve të vendeve në tranzicion do të kërkojë që problemet themelore të zgjidhen prej komunitetit ndërkombëtar.

3.4. Dinamika dhe trendi i IHD-ve në vendet në tranzicion të Evropës Juglindore

Në këtë pjesë të punimit kemi analizuar fluksin dhe trendet e IHD-ve në rajonin e Evropës Juglindore. Për qëllime të analizës kemi trajtuar vetëm pesë shtete të rajonit të EJT-së, që përbëhet nga: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kroacia dhe Serbia. Për qëllime krahasimi, të trendit të IHD-ve, gjithashtu kemi trajtuar edhe 10 vende anëtare të Bashkimit Europian. Mostra e 10 shteteve anëtare të reja në Bashkimin Europian përbëhet nga vende të Evropës Lindore dhe Qendrore, të cilët janë pranuar në struktura të BE-së, që nga viti 2005 e këndeje. Këto vende janë: Bullgaria, Rumania, Sllovenia, Hungaria, Sllovakia, Republika Çeke, Polonia, Lituania, Letonia dhe Estonia. Investimet e Huaja Direkte përbëjnë një burim të rëndësishëm të financave për vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion, por, për fat të keq, shumica e flukseve hyrëse dhe dalëse të IHD-ve janë të përqëndruara në vendet e zhvilluara. Përparimi i ngadalshëm i

këtyre vendeve mund të ketë ndodhur për shkak të krizave të qeverisjes që rajoni i Evropës Juglindore ka përjetuar gjatë dekadës së kaluar, si dhe politikave jo të qëndrueshme stabilizuese dhe makroekonomike që kanë ndjekur këto vende.

Parë nga aspekti global, 5 vende të EJT-së kanë regjistruar një pjesë jo të konsiderueshme të IHD-ve, në raport me IHD-të globale. Sidoqoftë, situata është përmirësuar më vonë, pasi pjesëmarrja e IHD-ve të këtyre vendeve në IHD-të globale ka shënuar rritje përgjatë kohës, duke shënuar kështu riintegrim të mirëfilltë të ekonomive të këtyre vendeve në ekonomitë globale të orientuar nga tregjet. Duke analizuar të dhënat në tabelën vijuese, shohim që stoku global i IHD-ve u rrit me 10.2 për qind në mes viteve 1990 dhe 2010. Në bazë të të dhënave që pasqyrojnë fluksin e IHD-ve, tabela vijuese tregon se në fillim të dekadës së fundit, një pjesë e konsiderueshme e stokut të IHD-ve u përqëndrua në vendet e zhvilluara. Ky trend ka rënë vazhdimisht gjatë viteve, gjë që është justifikuar nga zhvendosja e stokut të IHD-ve në vendet në zhvillim. Si shqetësim vërehet për shtetet e reja anëtare të vendeve të BE-së, në fillim të rrugës së tyre integruese drejt strukturave të BE-së, në vitin 2000, regjistruan stok të ulët hyrës të IHD-ve, në raport me nivelin global. Ky raport në vitin 2000 ishte 1.40 për qind, ndërsa në vitin 2006 arriti në 2.99 për qind. Ky trend rritës ka vazhduar deri në vitin 2008, kur ky raport arriti në 3.73 për qind. Ndërsa raporti i stokut hyrës të IHD-ve në 10 ekonomitë e vendeve të reja anëtare të BE-së, krahasuar me vendet e zhvilluara të BE-së në vitin 2000, ishte 1.85 për qind, dhe niveli i tyre është rritur ndjeshëm në vitin 2006, në 4.08 për qind. Ky trend rritës ka vazhduar deri në vitin 2008, kur është shënuar edhe raporti më i lartë me 5.38 për qind. Pas kësaj periudhe, stoku i IHD-ve në vendet e reja të BE-së, ka shënuar ritëm rënieje graduale deri në vitin 2013.

Ndërsa stoku hyrës i IHD-ve, në vendet e Evropës Qendrore-Lindore, është rritur gradualisht deri në vitin 2010, duke arritur nivelet rekord në vitet 2012 dhe 2013. Në anën tjetër, vendet e rajonit të Evropës Juglindore (Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Maqedonia) kanë regjistruar trend përmirësues të stokut hyrës të IHD-ve, përgjatë periudhës 2000-2013.

Në shkallë globale, përqindja e IHD-ve të vendeve të EJT-së nuk është shumë e madhe, por kjo përqindje ka ardhur në rritje duke filluar nga 0.07 për qind që ishte në vitin 2000, në 0.3 për qind në vitin 2006. Ky trend rritës ka vazhduar deri në vitin 2008, kur ky raport arriti në 0.41 për qind.

Tabela 5: Stoku hyrës i IHD-ve.

Rajoni/Vitet	1990	2000	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Bota	2,081,392	7,511,300	14,495,137	18,136,166	15,679,509	18,427,630	20,370,690	21,117,234	23,304,429	25,464,165
Vendet e zhvilluara	1,565,422	5,681,798	10,625,118	12,841,861	10,857,287	12,470,328	13,040,937	13,425,931	14,536,019	16,053,141
Vendet e zhvilluara si % e nivelit global	75.2	75.6	73.3	70.8	69.2	67.6	65.9	63.6	62.4	63
Vendet në zhvillim	514,319	1,771,479	3,499,663	4,660,152	4,423,631	5,364,271	6,597,073	6,942,733	7,945,334	8,483,009
Vendet në zhvillim si % e nivelit global	24.7	23.6	24.1	25.7	28.2	29.1	32.4	32.9	34.1	33.3
Vendet në tranzicion	1,652	58,023	370,356	634,153	398,591	593,031	732,679	748,570	823,076	928,015
Vendet në tranzicion si % e nivelit global	0.08	0.77	2.56	3.50	2.54	3.22	3.60	3.54	3.53	3.64
Vendet e EJL - së	-	5,682	44,660	71,647	65,375	74,767	74,327	74,776	78,060	85,285
Vendet e EJL - së si % e nivelit global	-	0.07	0.3	0.39	0.41	0.4	0.36	0.35	0.33	0.33
Vendet e EJL - së si % e vendeve në tranzicion	-	9.8	12	11.2	16.4	12.6	10.1	9.9	9.5	9.2
Vendet e reja anëtare të BE - së, 10 Vendet e EQL - së.	2,436	105,324	433,437	591,937	584,504	640,539	658,058	638,293	722,535	764,467
10 Vendet e EQL - së si % e nivelit global	0.11	1.40	2.99	3.26	3.73	3.48	3.23	3.02	3.10	3.00
10 Vendet e EQL - së si % e vendeve të zhvilluara	0.15	1.85	4.08	4.61	5.38	5.14	5.05	4.75	4.97	4.76
Bashkimi Ekonomik Europian	535,135	1,628,783	4,145,174	5,355,519	4,784,488	5,296,291	5,085,711	5,232,130	5,372,311	5,754,261
Bashkimi Ekonomik Europian si % e nivelit global	25.71	21.68	28.60	29.53	30.51	28.74	24.97	24.78	23.05	22.60

Shënim: Stoku i IHD-ve paraqet vlerën e IHD - ve, duke përfshirë edhe fitimin e riinvestuar që u atribuohet kompanive mëmë, plus detyrimet e kompanive bijë (filialeve). Të dhënat janë paraqitur në dollarë amerikanë, me çmimet aktuale dhe kursin aktual të këmbimit, në milionë dollarë.

Burimi: UNCTAD, 2014.

Në literaturën ekonomike, treguesi më i përhapur në analizimin e IHD-ve është IHD-ja si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Përmes treguesit relativ të stokut të IHD-ve, si përqindje e PPB-së në vendin përkatës (tabela në vijim) analizohet efekti potencial i stokut të akumuluar të IHD-ve në aktivitetin kombëtar ekonomik, të vendeve respektive.

Tabela 6: Stoku hyrës i IHD-ve, në raport me PPB-në, në 5 vende të EJT-së dhe 10 vende anëtare të reja të BE-së, në përqindje.

Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Mesatare
Shqipëria	6.8	8.0	8.1	8.5	11.4	12.5	15.5	25.2	22.1	27.0	27.7	34.6	38.4	48.3	21.0
Bosnja	19.5	20.7	21.8	18.4	22.5	21.0	25.6	35.1	32.7	40.4	39.6	38.6	42.7	44.5	30.2
Kroacia	13.0	16.9	22.9	25.2	30.3	32.5	54.9	75.9	44.8	59.3	59.5	50.0	56.3	56.1	42.7
Maqedonia	15.0	26.6	31.9	34.3	39.8	34.9	42.1	45.9	42.0	48.6	47.5	46.0	51.6	54.7	40.1
Serbia	10.5	9.5	10.3	14.3	15.6	20.3	31.1	34.6	44.2	57.5	67.2	63.3	76.2	77.9	38.0
Bullgaria	21.0	21.2	25.8	30.8	40.0	47.9	70.7	90.1	85.0	101.4	99.0	88.5	96.6	99.6	65.5
Rumania	18.6	20.5	17.1	20.5	27.0	26.0	37.0	36.9	33.2	43.8	42.6	39.1	46.1	45.4	32.4
Sllovenia	14.5	12.6	17.9	21.9	22.5	20.3	23.1	30.4	28.9	31.1	31.1	30.2	34.1	32.5	25.1
Sllovakia	34.2	38.5	50.8	65.4	66.8	61.8	69.1	63.6	53.5	60.2	57.7	54.2	61.1	61.5	57.0
R. Çeke	36.8	42.1	49.3	47.5	50.2	46.6	53.8	62.3	50.2	63.8	64.7	55.8	69.5	68.6	54.4
Hungaria	49.3	52.0	54.6	57.9	60.4	55.4	71.2	70.2	57.1	78.0	71.2	62.2	83.1	85.6	64.9
Polonia	20.0	21.7	24.4	26.7	34.3	29.9	36.8	42.0	31.0	43.0	45.9	39.4	48.0	48.8	35.1
Lituania	20.3	21.8	28.0	26.5	28.2	31.5	36.4	38.3	27.3	35.7	36.2	33.1	37.9	37.1	31.3
Latvia	26.8	28.3	29.8	29.4	33.0	30.9	37.7	37.8	34.5	44.9	44.6	42.5	47.8	50.6	37.0
Estonia	46.6	50.5	57.8	71.2	83.5	81.1	75.6	76.2	69.0	86.6	87.7	75.2	86.5	87.7	73.9

Burimi: UNCTAD, bazuar në të dhëna nga departamenti i ekonomikut në Kombet e Bashkuara, Divizioni statistikor, 2014; kalkulim personal.

Ashtu siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, vendet e Evropës Juglindore janë bërë më atraktive për investorët gjatë vitit 2005. Në vitin 2005, niveli më i lartë i stokut të IHD-ve, si përqindje e PPB-së u regjistrua në Maqedoni (34.9 për qind), Kroaci (32.5 për qind), Bosnjë-Hercegovinë (21.0 për qind). Vende më të varfëra në lidhje me hyrjet e stokut të IHD-ve, në raport me PPB-në, gjatë vitit 2005, kanë regjistruar Shqipëria (12.05 për qind) dhe Serbia (20.3 për qind). Sidoqoftë, në vitet në vazhdim, Kroacia ka regjistruar stokun më të lartë të IHD-ve në raport me PPB-në.

Në vitin 2007, Kroacia ishte vendi kryesor që regjistroi pjesën më të lartë proporcionale të stokut hyrës të IHD-ve si përqindje ndaj PBB-së me vlerë (75.9 për qind), ndërkohë që më pas vinin Maqedonia (45.9), Bosnja (35.1), Serbia (34.6) dhe Shqipëria përfitoi me vetëm (25.2 për qind). Në vitin 2010 situata ndryshoi në favor të Serbisë.

Në vitin 2010, Serbia pranoi stokun më të lartë të IHD-ve, në raport me PPB-në (67.2 për qind), duke lënë pas Kroacinë (59.5), Maqedoninë (47.5), Bosnjë-Hercegovinën (39.6) dhe Shqipërinë me (27.7 për qind). Stoku i IHD-vë në Shqipëri shënoi rritje të qëndrueshme nga vitet 2005 në 2013, duke arritur maksimumin e saj në vitin 2013 (48.3 për qind).

Lidhur me vendet tjera të Evropës Qendrore, rritje më të qëndrueshme të stokut të IHD-ve kanë shënuar: Estonia, Bullgaria, Hungaria, Republika Çeke dhe Rumania. Sidoqoftë, nga tabela 6, vërtetohet që vendet e EJL-së bëhen më atraktive për investorët e huaj pas vitit 2005, duke ndryshuar kështu perceptimet e investorëve të huaj ndaj kushteve ekonomike të vendeve të EJL-së. Në vitin 2013, nga rajoni i Evropës Juglindore, Serbia dhe Kroacia kanë regjistruar fluks më të lartë hyrës të stokut të IHD-ve, në raport me PPB-në, me vlera respektive të regjistruara prej (77.9 për qind) dhe (56.1), duke lënë pas vendet e tjera si: Maqedoninë (54.7 për qind), Shqipërinë me

(48.3) dhe Bosnjën (44.5) të stokut hyrës së IHD-ve, në raport me PPB-në. Mesatarisht, gjatë periudhës së vëzhgimit 2000-2013, nga rajoni i Evropës Juglindore, Kroacia dhe Maqedonia kanë regjistruar fluks më të lartë hyrës të stokut të IHD-ve, në raport me PPB-në, me vlera respektive të regjistruara prej (42.7 për qind) dhe (40.1), duke lënë pas vendet e tjera, si: Serbinë (38 për qind), Bosnjën (30.2) dhe Shqipërinë me (21 për qind) të stokut hyrës së IHD-ve, në raport me PPB-në. Nga ana tjetër, nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, anëtare të reja të Bashkimit Europian, mesatarisht, gjatë periudhës së vëzhgimit 2000-2013, Estonia dhe Bullgaria kanë regjistruar nivel më të lartë të stokut të IHD-ve, me vlera respektive në përqindje prej (73.9) dhe (65.5), duke lënë pas: Hungarinë (64.9), Sllovakinë (57), Republikën Çeke (54.4), Letoninë (37), Poloninë (35.1), Rumaninë (32.4), Lituaninë (31.3) dhe Slloveninë me (25.1). Gjithashtu, për dallim nga vendet e zhvilluara në Evropë, ku të dyja kategoritë e IHD-ve janë prezente, stoku hyrës dhe dalës i IHD-ve, në vendet me ekonomi tranzicioni, një rast i tillë nuk është prezent. Stoku dalës i IHD-ve, në raport me stokun hyrës të IHD-ve, është sipërfaqësor. Ky shpjegim mund t'i atribuohet faktit që vendet me ekonomi tranzicioni të rajonit të Evropës Juglindore kanë mungesë të theksuar të kapitalit. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, mesatarisht, gjatë periudhës së vëzhgimit, 2000-2013, stoku më i lartë dalës i IHD-ve, si përqindje e PBB-së, është regjistruar në Estoni (19.5 për qind), Slloveni (12.2 për qind) dhe Hungari (12.1 për qind). Vendet më të varfëra në aspektin e stokut dalës të IHD-ve, gjatë periudhës së vëzhgimit, janë nga Shqipëria (0.7 për qind), Bosnja (0.8) dhe Maqedonia (0.9 për qind).

Tabela 7: Stoku dalës i IHD-ve, në raport me PPB-në, në EJT-5 dhe EJT-10, në përqindje.

Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Mesatare
Shqipëria	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.4	0.7	1.1	1.4	1.3	1.4	1.6	1.9	0.7
Bosnja	0.0	0.0	0.0	0.0	0.6	0.6	1.3	1.7	1.5	1.1	1.3	1.2	1.2	1.1	0.8
Kroacia	3.8	3.9	6.4	6.0	5.2	4.6	4.8	6.4	7.5	10.6	7.5	7.4	7.9	7.5	6.4
Maqedonia	0.4	0.5	1.0	0.9	1.0	1.0	0.6	0.8	0.9	1.0	1.1	1.2	1.0	1.0	0.9
Serbia	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.5	3.7	4.9	5.6	5.1	6.1	6.5	2.3
Bullgaria	0.5	0.2	0.3	0.3	0.4	0.4	1.4	1.9	2.8	2.9	3.3	3.1	3.9	4.3	1.8
Rumania	0.4	0.3	0.3	0.4	0.4	0.2	0.7	0.7	0.7	0.8	0.9	0.7	0.8	0.8	0.6
Sllovenia	3.8	4.8	6.6	8.1	9.0	9.2	11.7	17.0	16.2	18.5	17.4	15.6	16.3	16.5	12.2
Sllovakia	2.7	3.4	3.1	3.4	2.6	1.6	2.7	2.8	3.1	3.6	4.0	4.2	4.8	4.5	3.3
R. Çeke	1.3	1.8	1.9	2.4	3.3	2.8	3.4	4.7	5.6	7.5	7.5	6.1	7.7	10.8	4.8
Hungaria	2.8	3.0	3.3	4.2	5.9	7.1	11.0	12.7	11.4	15.6	16.0	17.7	28.1	30.5	12.1
Polonia	0.6	0.6	0.7	1.0	1.3	2.1	4.2	5.0	4.6	6.8	9.5	10.2	11.7	10.6	4.9
Lithuania	0.3	0.4	0.4	0.6	1.9	2.8	3.4	4.0	4.2	6.2	5.7	4.8	6.1	6.2	3.4
Latvia	0.3	0.5	0.6	1.0	1.7	1.8	2.4	3.2	3.1	3.4	3.6	3.0	3.9	4.7	2.4
Estonia	4.6	7.1	9.2	10.5	11.8	13.9	21.4	28.1	27.9	34.2	30.3	21.0	26.3	27.2	19.5

Shënime: Stoku dalës i IHD-ve. Burimi i të dhënave për PPB: UNCTAD, bazuar në të dhëna nga Kombet e Bashkuara, departamenti i ekonomikut, Sektori i statistikave.

Burimi: UNCTAD, 2014; kalkulim personal.

Dinamika e IHD-ve në vendet në tranzicion të ELJ-së mund të shihet edhe nëpërmjet treguesit relativ të fluksit hyrës të IHD-ve në përqindje për kokë banori. Rrjedha e IHD-ve për frymë në Shqipëri, gjatë dekadës së fundit, ka regjistruar rritje të qëndrueshme, veçanërisht gjatë periudhës 2005-2010. Në vitin 2005, flukset hyrëse të IHD-ve për frymë ishin 3.24 për qind, duke shënuar në vitin 2007 një rritje të theksuar (7.22). Më pas kemi një rritje graduale në vitin 2008 (9.93), në vitin 2009 (9.82) dhe duke arritur maksimumin në vitin 2010 (10.01). Në vitin 2010, Shqipëria shënoi përqindjen më të lartë të fluksit hyrës të IHD-ve për kokë banori në rajonin e EJT-së, duke lënë pas Serbinë (9.8), Maqedoninë (2.98), Bosnjë-Hercegovinën (1.81) dhe Kroacinë (0.84).

Rrjedha e IHD-ve për frymë në Maqedoni, gjatë dekadës së fundit, ka regjistruar rritje të qëndrueshme, veçanërisht gjatë viteve 2006 dhe 2007, duke arritur maksimumin e saj në vitin 2007 (10.37). Në vitin 2008, rrjedha e IHD-ve për frymë në Maqedoni shënoi rënie

graduale në 8,36 për qind, duke regjistruar rënie të theksuar në (2,90%) në vitin 2009 dhe (2,98) në vitin 2010. Megjithatë, mesatarisht, në shuma më të larta të IHD-ve për frymë gjatë periudhës 2000-2010 janë regjistruar në Serbi (8,42), Shqipëri (5,31), Kroaci (5,30), duke lënë pas Maqedoninë (5,00) dhe Bosnjë-Hercegovinën (4,36).

Tabela 8: Fluksi i IHD-ve për kokë banori në EJT-5 dhe BE-10 (në %).

Flukset Hyrëse të IHD –ve për kokë banori në EJT dhe EQL												
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	Mesatare 2000 - 2010
EJT – 5												
Shqipëri	2,35	3,11	1,95	2,43	4,48	3,24	3,77	7,22	9,93	9,82	10,01	5,31
Bosnjë	1,65	1,31	2,78	3,85	4,86	3,21	4,79	14,18	7,71	1,90	1,81	4,36
Kroaci	2,91	3,51	2,73	4,81	2,74	4,07	7,37	10,11	12,24	7,06	0,84	5,30
Maqedoni	3,88	8,45	1,97	2,01	5,64	1,60	6,87	10,37	8,36	2,90	2,98	5,00
Serbi	0,21	0,66	2,05	5,46	3,45	6,65	14,84	12,42	22,38	14,77	9,80	8,42
EQL-10												
Bullgari	4,59	3,50	3,82	8,20	12,50	13,56	25,36	37,81	28,32	10,29	4,86	13,89
Rumani	1,40	1,45	1,36	2,50	6,75	6,53	10,62	8,72	11,39	4,24	2,62	5,23
Slloveni	0,45	1,19	5,07	0,92	2,40	1,64	1,73	3,74	4,65	-1,69	0,91	1,91
Sllovaki	5,12	4,06	10,15	5,05	6,74	5,07	9,04	6,24	7,17	-0,01	0,87	5,40
R. Çeke	4,68	5,14	7,56	1,80	4,08	8,95	3,92	7,09	4,25	2,02	4,13	4,87
Hungari	3,07	4,21	3,07	2,11	4,01	6,98	5,94	3,44	5,46	1,89	2,08	3,84
Poloni	3,61	2,15	1,53	1,64	4,38	3,38	6,07	6,83	4,09	3,51	2,31	3,59
Lituani	2,11	2,32	3,54	0,79	3,19	3,93	6,45	6,52	6,17	0,24	2,73	3,45
Latvi	3,84	1,14	2,05	2,29	4,39	4,43	9,38	11,96	6,71	0,60	2,46	4,47
Estoni	3,97	5,15	2,59	7,73	7,74	20,60	11,74	16,50	10,90	13,53	11,08	10,13

Burimi: UNCTAD: Libri i statistikave 2011, kalkulim personal.

Megjithatë, nga tabela e mësipërme mund të vërehet se vendet e Evropës Juglindore janë duke u bërë vende më tërheqëse për investitorët e huaj, sidomos pas vitit 2005, duke ndryshuar perceptimin e investitorëve të huaj ndaj kushteve ekonomike të vendeve të Evropës Juglindore (EJT). Ky ndryshim i mundshëm i trendit mund t'i atribuohet përmirësimit të politikave stabilizuese makroekonomike dhe kushteve të qëndrueshme

politike për investime në rajonin e EJT-së. Një shpjegim tjetër për këtë mund të jetë negociimi i suksesshëm në mes vendeve të EJT-së dhe BE-së, për anëtarësimin eventual të vendeve të EJT-së në struktura të BE-së, që do të thotë se rajoni e ka përfunduar me sukses periudhën tranzitore të saj, duke lënë pas konfliktet kombëtare dhe pasojat shkatërruese të luftërave dhe ngjarjeve politike dhe konfliktet etnike. Lidhur me vendet tjera të Evropës Qendrore, sasi të konsiderueshme fluksesh të IHD-ve për frymë, mesatarisht gjatë dekadës së fundit, janë regjistruar në Bullgari (13,89%), pasuar nga Estonia (10,13%), duke lënë prapa vendet e tjera të rajonit të njëjtë me shuma të parëndësishme, poshtë (6%). Trendi zhvillues i vendeve të Evropës Juglindore (EJT) është në përmirësim e sipër në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) të integruara në struktura të Bashkimit Europian. Shpjegimi për këtë situatë me tendencë përmirësimi për vendet e EJT-së, mund t'i atribuohet faktit, se vendet e EJT-së tentojnë drejt hapjes së tyre, si rezultat i angazhimeve të tyre për integrim të suksesshëm në tregjet e BE-së.

Edhe pse numri i popullsisë në vendet e EJT-së është rreth 80 për qind më i ulët se në vendet e EQL-së, vlera e përgjithshme e Produktit të Përgjithshëm Bruto (PPB-së), e grupit të vendeve të EJT-së, është sa një e treta e vlerës së përgjithshme të PPB-së së vendeve të EQL-së (tabela në vijim). Lidhur me treguesit e PPB-së për kokë banori për çdo vend individual, vërejmë që në mesin e vendeve të EJT-së, Kroacia shënon nivelin më të lartë në rajon, me vlerë të PPB-së për frymë prej 13,449.15, bazuar në çmimet në dollarë amerikan dhe 17,576.66 bazuar në paritetin e fuqisë blerëse, për kokë banori të PPB-së, duke reflektuar kështu nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik të Kroacisë, që në mënyrë të vazhdueshme shënon rritje.

Nga ana tjetër, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia kanë shënuar vlera të ulëta të PPB-së për frymë. Vend lider për nga PPB-ja për frymë, në mesin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore është Sllovenia, me vlerë të PBB-së për frymë prej 28,111.30, bazuar në çmimet në dollarë amerikan, e ndjekur nga Republika Çeke (26,121.90), Sllovakia (22,121.85), Estonia (18,539.45), Polonia (18,961.08) dhe Hungaria (18,809.65). Nëse fokusohemi në të dhënat në grup për të dy mostrat, vërejmë që vendet e EQL-së (Vende të reja, anëtare të Bashkimit European) janë 3,5 herë më të pasura se vendet e EJT-së. Ky indikator është në favor të vendeve të EJT-së, nëse konsiderojmë madhësinë e mostrës të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Tabela 9: Indikatorët bazë ekonomik të vendeve të EJT-së dhe EQL-së.

	Popullsia (Mijë)*	PPB në çmime konstante (2005) dhe kurs konstant të këmbimit (2005)*	PPB për frymë bazuar në PFB për frymë të PPB. ^	PPB për frymë në çmime aktuale **	Indeksi i deflatorit të PPB- së
Shqipëri	3,204	10,487	7,497.84	3,704.51	192,39
Bosnjë-H.	3,760	12,695	7,832.79	4,271.85	122,99
Kroaci	4,403	46,894	17,576.66	13,449.15	118,76
Maqedoni	2,060	7,062	9,963.69	4,551.68	160,46
Serbi	9,856	13,548	10,120.04	4,891.52	154,92
EJT-5	23,283	307,164	52,991.02	30,868.71	
EJT- 5 si % e EQL -10	22,78	32,62	27,99	23,13	
Bullgari	7,494	32,932.44	12,965.21	6,374.12	135,68
Republika Çeke	10,493	148,578.41	26,121.90	18,813.93	106.05
Hungari	9,983	109,264.9	18,809.65	12,845.40	122,65
Poloni	38,276	382,760.61	18,961.08	12,307.73	114,43
Rumani	21,537	111,921.21	11,904.14	7,667.22	159,86
Sllovaki	5,462	60,184.43	22,121.85	16,049.85	106.32
Slloveni	2,029	39,034.34	28,111.30	23,407.24	148.62
Letoni	2,252	15,398.96	14,406.70	10,680.53	188,29
Lituani	3,323	27,466.48	17,333.32	11,116.15	124,78
Estoni	1,341	13,897.78	18,539.45	14,137.64	127,98
EQL – 10	102,195	941,529.57	189,274.61	133,399.81	

Shënim: Të dhënat janë siguruar nga statistika të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN); *dollarë amerikan/Bilion; ** Dollarë amerikanë: Njësi; ^Njësi.

Flukset hyrëse të IHD-ve në vendet e EJT-së ishin të ulëta gjatë fundit të viteve '90-të, sigurisht, si rezultat i nivelit të lartë të centralizimit të ekonomive të vendeve ish-socialiste në fillimin e procesit të tranzicionit dhe ekzistencës së ndërmarrjeve me pronësi të shtetit. Në këtë periudhë, të gjitha vendet ish-socialiste u përballen me situata të vështira ekonomike si rezultat i recensionit që pësuan këto vende në fillimet e rrugës drejt kapitalizmit. Duke filluar nga viti 2000 e më pas, vendet e EJT-së kanë përfituar flukse hyrëse të IHD-ve gjithnjë në rritje. Në fund të viteve 2007, vlera kumulative e fluksit hyrës të IHD-ve, në vendet e EJT-së shënoi rritje të theksuar, duke regjistruar vlerën e IHD-ve, prej 13.074 milionë dollarë amerikan, që paraqet 18 përqindshin e vlerës totale të fluksit hyrës të IHD-ve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (tabela në vijim).

Progresi i ulët i reformave ekonomike në këto vende dhe jostabiliteti politik mund të paraqesin arsyt kryesore të flukseve të ulëta hyrëse të IHD-ve në ekonomitë e vendeve të EJT-së. Sidoqoftë, në relacion me IHD-të, situata është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme prej vitit 2005, duke arritur nivelin maksimal të shënimit të fluksit hyrës të IHD-ve, në vitin 2007. Përshkrim i detajuar i vlerës kumulative të fluksit hyrës të IHD-ve, në vendet e EJT -së paraqitet në tabelën vijuese. Në mesin e vendeve të EJT-së, mesatarisht për periudhën 200-2013, është Kroacia (2 129,6) që ka tërhequr më shumë IHD dhe më pas renditet respektivisht Serbia (2.055,6) dhe Shqipëria (588,2).

Nga tabela 10 vërejmë se, para viteve 2007, IHD-të, në mesin e vendeve të EJT-së, më shumë ishin të koncentruara në vende të tilla si Kroacia dhe Serbia, dhe ky trend ndryshoi në favor të Shqipërisë në fund të vitit 2010. Shpjegimi për këtë situatë mund të mbështetet në argumentin se vendet e zhvilluara pranojnë më shumë flukse të IHD-ve sesa vendet në zhvillim. Sidoqoftë, arsyt pse Shqipëria ka shënuar progres në relacion

me pranimin e IHD-ve, gjatë vitit 2010, mund t'u adresohen: 1) stabilitetit politik që vendi fitoi me anëtarësim në struktura të NATO-s, duke e bërë ekonominë shqiptare më të sigurt e të qëndrueshme, 2) kuadrit të liberalizuar ekonomik, 3) përmirësimit të mjedisit të biznesit, 4) zhvillimit të infrastrukturës dhe 5) aplikimit të politikave favorizuese ndaj investitorëve të huaj nga ana e qeverisë shqiptare.


Tabela 10: Flukset hyrëse të IHD-ve në vendet e EJT-së dhe EQL-së (milionë dollarë).

Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Mesatare
EJT-5	1,608.0	2,263.1	2,139.2	4,177.9	3,436.8	4,748.4	9,790.3	13,074.5	11,991.9	7,151.7	3,971.7	6,611.4	3,329.2	3,848.7	5,581.6
Shqipëri	144.3	206.4	135.0	178.0	345.7	264.3	324.4	658.5	974.3	995.9	1,050.7	876.3	855.4	1,225.5	588.2
Bosnjë	146.1	118.9	265.2	381.1	511.2	351.2	554.7	1,819.2	1,001.6	249.9	406.0	493.3	366.3	331.7	499.7
Kroaci	1,050.9	1,313.2	1,070.9	1,989.1	1,179.1	1,825.4	3,231.1	4,927.7	5,938.1	3,346.4	490.0	1,516.8	1,355.5	580.1	2,129.6
Maqedoni	215.1	447.1	105.6	113.3	323.7	96.0	432.6	692.5	585.8	201.4	211.9	468.2	92.6	333.9	308.5
Serbi	51.8	177.4	562.5	1,516.4	1,077.1	2,211.5	5,247.5	4,976.6	3,492.1	2,358.1	1,813.1	3,256.8	659.4	1,377.4	2,055.6
EJT-10	23,304.6	21,005.9	26,413.6	17,806.6	39,169.7	48,359.8	62,778.6	72,851.4	63,151.3	27,338.5	31,589.9	41,337.8	38,242.2	29,312.6	37,333.0
Bullgari	1,016.5	808.4	922.3	2,088.6	3,397.1	3,920.0	7,804.9	12,388.9	9,855.1	3,385.4	1,524.7	1,849.0	1,375.2	1,450.4	3,699.0
Rep. Çeke	4,985.2	5,641.7	8,482.0	2,102.7	4,974.5	11,653.2	5,462.6	10,443.8	6,451.0	2,926.8	6,140.6	2,317.6	7,984.1	14,990.4	6,039.7
Estoni	391.3	539.3	288.7	928.0	957.1	2,869.3	1,796.3	2,716.8	1,731.1	1,840.0	1,598.4	340.5	1,516.8	949.8	1,318.8
Hungari	2,764.1	3,936.0	2,993.6	2,137.4	4,265.7	7,709.0	6,817.5	3,950.8	6,325.4	1,994.6	2,201.6	6,290.3	13,983.3	3,091.1	4,890.0
Lituani	378.9	445.8	725.0	180.4	773.7	1,028.1	1,816.8	2,015.0	1,964.5	-13.7	799.6	1,448.0	700.2	531.1	913.8
Poloni	9,445.3	5,701.2	4,122.8	4,587.7	12,874.4	10,293.4	19,603.2	23,560.8	14,838.7	12,932.1	13,875.6	20,615.6	6,058.6	6,037.7	10,890.8
Romani	1,056.8	1,157.9	1,140.7	2,196.3	6,435.6	6,482.9	11,366.9	9,921.5	13,908.5	4,844.1	2,940.1	2,522.1	2,748.1	3,616.8	5,024.2
Slovaki	2,720.4	2,274.8	5,864.9	2,975.7	4,029.0	3,109.6	5,803.1	4,017.2	4,868.0	-6.1	1,769.8	3,491.3	2,825.9	591.0	3,166.8
Sloveni	133.3	369.1	1,620.4	305.3	826.0	587.6	644.0	1,514.3	1,947.5	-658.6	360.0	997.7	-59.4	-678.6	564.9
Letoni	413.0	131.6	253.3	304.5	636.5	706.7	1,663.3	2,322.3	1,261.4	93.9	379.5	1,465.7	1,109.3	808.3	825.0
EJT/EQL	6.9	10.8	8.1	23.5	8.8	9.8	15.6	17.9	19.0	26.2	12.6	16.0	8.7	41.3	16.1

Burimi: UNSTAD, 2015.


Gjithashtu, duhet të theksojmë se modelet bazë të investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri janë të lidhura me strukturën e saj gjeo-ekonomike. Shqipëria është një vend i vogël me një popullsi me rreth 2.8 milionë banorë (2011), ndonëse jo aq i vogël në kontekstin e vet të Rajonit të Evropës Juglindore. Produkti i Brendshëm Bruto nominal i saj në vitin 2010, sipas kursit të shkëmbimit të tregut, ishte afërsisht 9 miliardë euro, sa trefishi i PBB-së së Malit të Zi dhe 50 për qind më i lartë se ai i Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, por vetëm sa një e treta e atij të Kroacisë (UNSTAD,2011).

Figura 2: Fluksi hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë, në vendet e EJT-së.



Burimi: UNSTAD, 2015, llogaritje personale.

Figura 3: Fluksi hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë, në vendet e EJT-së.



Burimi: UNSTAD, 2015, llogaritje personale.

Në rastin e thithjes së IHD-ve ka rëndësi masa, sikundër niveli i zhvillimit ekonomik dhe pozita gjeografike. Vendet e vogla zakonisht nuk arrijnë të thithin fonde në vlera të mëdha të TNC-ve dhe të industrive që prodhojnë për tregjet e eksportit në shkallë të gjerë. Ndonëse ky aspekt mund të kufizojë deri diku shkallën me të cilën Shqipëria konkurren me vende më të mëdha në tërheqjen e IHD-ve të orientuara nga eksportet. Nga një numër burimesh, ajo me krahun saj të lirë dhe të motivuar të punës ka një potencial të mirë për t'u shndërruar në një qendër prodhimi dhe shërbimesh për eksportet në drejtim të vendeve fqinje, e në veçanti, Italisë dhe Greqisë. Shqipëria ka zbatuar një kuadër të favorshëm politikash për tërheqjen e IHD-ve. Ndërsa kohët e fundit janë parashtruar politika për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në përgjithësi. Gjithashtu, janë marrë masa të tjera për përmirësime të mëtejshme, duke përfshirë përmirësime ligjore, si dhe krijimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

3.5 Investimet e Huaja Direkte në vendet e Evropës Juglindore, sipas vendit të origjinës

Struktura e stokut të IHD-ve sipas vendeve të origjinës gjatë periudhës 2007-2013 paraqet ndryshime të ndjeshme nga viti në vit. Siç ndodh zakonisht me ekonomitë e vogla dhe të hapura, vendet e EJT-së kanë pranuar vlera më të larta të flukseve hyrëse të IHD-ve, nga vendet fqinje. Nga tabela e mëposhtme shohim se struktura e kapitalit të huaj në formën e IHD-ve në Shqipëri mbizotërohet nga kapitali grek dhe ai italian. Afërsia gjeografike e Shqipërisë me këto dy vende, si dhe një bashkëpunim i fuqishëm ekonomik me BE-në, janë ndër arsyt kryesore që Greqia dhe Italia paraqiten si vende burimore kryesore të IHD-ve për Shqipërinë. Sipas Bankës së Shqipërisë, arsyeja e këtij fluksi të madh të kapitalit grek në ekonominë shqiptare mund të adresohen te kriza

e thellë e borxhit me të cilën u përball Greqia, e cila rrezikoi stabilitetin financiar të kompanive më të mëdha greke, duke i detyruar ata të diversifikojnë portofolet e tyre të investimeve në vendet fqinje. Kështu, në vitin 2010 Greqia renditet e para me 25 për qind, Italia në vendin e dytë me 16 për qind, e treta Austria me 14 për qind. Rritje të ndjeshme ka patur kapitali i huaj me origjinë turke, duke filluar me 8 për qind të totalit të IHD-ve në vitin 2007, deri në 10 për qind në vitin 2013.

Tabela 11: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, 2007-13 (për qindja e totalit).

IHD- të në Shqipëri, 2007 – 2013 (në % të totalit).						
2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Austri (8)	Austri (9)	Austri (10)	Austri (14)	Austri (13)	Austri (13)	Austri (13)
Gjermani (3)	Gjermani (3)	Gjermani (3)	Gjermani (3)	Gjerma ni (3)	Gjerma ni (3)	Gjermani (4)
Greqi (28)	Greqi (27)	Greqi (25)	Greqi (25)	Greqi (15)	Greqi (23)	Greqi (37)
Itali (12)	Itali (15)	Itali (15)	Itali (16)	Itali (12)	Itali (4)	Itali (- 4)
Holandë (15)	Holandë (9)	Holandë (9)	Holandë (9)	Holandë (7)	Holandë (9)	Holandë (12)
Turqi (8)	Turqi (9)	Turqi (10)	Turqi (8)	Turqi (6)	Turqia (7)	Turqi (10)
SHBA (4)	SHBA (4)	SHBA (1)	SHBA (-4)	SHBA (-1)	SHBA (1)	SHBA (2)
Të tjera (22)	Të tjera (24)	Të tjera (27)	Të tjera (29)	Të tjera (45)	Të tjera (40)	Të tjera (26)

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2014.

Nga tabela e mëposhtme vërejmë se, Austria, Holanda dhe Italia janë vendet kryesore burimore për IHD-të për Bosnjë-Hercegovinën. Ndërsa kapitali kroat ka shënuar rënie nga viti 2005 me 26,85 për qind deri në 1.91 për qind në vitin 2011. Rënie ka pësuar edhe kapitali me origjinë nga Sllovenia. Ndërsa, gjatë periudhës së vërtetuar, 2005-2011, mesatarisht, kapitali austriak në Bosnjë-Hercegovinë llogaritet deri në 59,37 për qind, duke lënë prapa Holandën me 12.53 për qind, Italinë me 8,87 për qind dhe Slloveninë me 8,38 për qind.

Tabela 12: Stoku i IHD-ve në Bosnjë, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.

Stoku i IHD – ve në Bonjë dhe Hercegovinë, 2005 – 2011 (në përqindje të totalit)						
2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Austri (31,73)	Austri (62,24)	Austri (65,18)	Austri (64,59)	Austri (63,84)	Austri (64,21)	Austri (63,81)
Kroaci (26,85)	Netherland (14,66)	Netherland (13,51)	Netherland (13,30)	Netherland (13,60)	Netherland (12,49)	Netherland (14,12)
Sllovenia (17,53)	Itali (12,36)	Itali (9,97)	Itali (9,37)	Itali (9,32)	Itali (9,49)	Itali (8,03)
Gjermani (14,2)	Rusia (5,89)	Rusia (4,37)	Sllovenia (4,93)	Sllovenia (6,04)	Sllovenia (6,64)	Sllovenia (7,23)
Netherland (6,05)		Sllovenia (3,04)	Rusia (3,91)	Rusia (3,46)	Rusia (3,59)	Rusia (3,40)
Itali (3,61)		Kroaci (2,41)	Kroaci (2,33)	Kroaci (1,96)	Kroaci (2,01)	Kroaci (1,91)
		Gjermani (1,54)	Gjermani (1,53)	Gjermani (1,48)	Gjermani (1,53)	Gjermani (1,47)

Burimi: Banka e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe UNCTAD, 2014.

Tabela 13: Stoku i IHD-ve në Kroaci, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.

Stoku i IHD – ve në Kroaci, 2005 – 2011 (në përqindje të totalit)						
2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Austri (37,0)	Holandës (71,1)	Austri (56,2)	Austri (25,0)	Holandë (30,2)	Itali (46,1)	Holandë (25,8)
Hungari (22,4)	Francë (37,6)	Belgjikë (9,1)	Hungari (22,7)	Austri (17,9)	Belgjikë (40,6)	Gjermani (21,3)
Itali (12,1)	Luksemburg (11,0)	Holandë (7,3)	Antilet e Hollandës (22,0)	Sweden (13,9)	Luksemburg (37,0)	Austri (20,6)
Holandës (11,8)	Switzerland (9,7)	Hungari (7,0)	Gjermani (10,1)	Gjermani (6,8)	Gjermani (27,6)	Luksemburg (13,9)
Slloveni (8,1)	Gjermani (8,0)	Sllovenia (6,1)	Holandë (6,9)	Hungari (6,8)	Ireland (27,1)	Hungari (9,7)
Luksemburg (7,1)	Itali (6,9)	Gjermani (4,7)	Slloveni (4,3)	Luksemburg (6,6)	Slloveni (26,0)	Federata Ruse (2,3)
Vende të tjera (13,3)	Austri (-18,8)	Vende të tjera (9,6)	Vende të tjera (9)	Slloveni (4,2)	Qipro (11,5)	Poloni (-5,6)
	SHBA (-40,8)			Itali (3,5)	Norvegji (10,4)	Shtetet e Bashkuara (-5,3)
	Vende të tjera (15,3)				Holandë (-96,9)	Vende të tjera (17,3)
					Austri (-39,8)	
					Mbretëri e Bashkuar (-16,6)	

Burimi: Banka e Kroacisë dhe UNSTAD, 2014.

Nga tabela e mësipërme vërejmë se, Austria, Holanda, Italia, Gjermania, Belgjika dhe Hungaria janë vendet kryesore që kanë të regjistruara flukset më të larta dalëse të IHD-ve për në Kroaci, gjatë periudhës së vrojtuar, 2005-2011. Në vitin 2011, vendi kryesor burimor për IHD-të në Kroaci është Holanda me 25.8 për qind e ndjekur nga Gjermania dhe Austria, përkatësisht me 21.3 dhe 20.6 për qind. Pjesa më e madhe e investimeve në Kroaci, mesatarisht gjatë periudhës së vëzhguar (2005-2011), u regjistrua nga Austria (22,35) dhe Holanda (20,18).

Tabela 14: Stoku i IHD-ve në Maqedoni, sipas vendit të origjinës, 2005-2011.

Stoku i IHD-ve në Maqedoni, 2005 – 2011 (në përqindje të totalit)						
2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Hungari, (19,79)	Hungari, (16,69)	Holandë (16,95)	Greqi (15,18)	Austri (11,54)	Holandës (16,83)	Holandës (20,41)
Greqi, (15,78)	Greqi, (15,27)	Hungari (16,55)	Holandë (14,67)	Greqi (12,11)	Sllovenia (12,19)	Austri (11,42)
Holandë (12,06)	Austri, (10,46)	Greqi (15,21)	Hungari (13,83)	Hungari (12,38)	Greqi (11,58)	Sllovenia (11,12)
Austri, (11,8)	Qipro, (8,68)	Zvicër (6,55)	Austri (11,27)	Holandë (16,67)	Austri (11,37)	Greqi (10,70)
Zvicër, (9,28)	Holandë, (10,10)	Sllovenia (6,52)	Sllovenia (8,85)	Sllovenia (12,45)	Hungari (10,61)	Hungari (9,50)
Qipro, (9,09)	Zvicër, (7,18)	Vende të tjera (38,22)	Zvicër (6,76)	Zvicër (6,43)	Zvicër (4,68)	Zvicër (3,46)
Sllovenia, (6,04)	Sllovenia, (6,04)		Vende të tjera (29,44)		Vende të tjera (32,64)	Vende të tjera (33,39)
Vende të tjera, (8,98)	Vende të tjera (25,58)					

Burimi: Banka e Maqedonisë dhe UNSTAD, 2014.

Nga tabela e mësipërme vërejmë se investitorët më të mëdhenj të huaj në Maqedoni, gjatë periudhës së vrojtuar, 2005-2011, ishin Austria, Hungaria, Greqia dhe Holanda. Duke observuar sipas viteve, në vitin 2005, shumica e IHD-ve në Maqedoni e kishin origjinën kryesisht nga Hungaria (19,79), Greqia (15,78), Holanda (12,06) dhe Austria (11,8). Të njëjtat vende vazhduan të mbeten vende kryesore të burimit të IHD-ve në

Maqedoni, në vitet më pas. Në mesin e këtyre vendeve evropiane, Sllovenia shfaqet si vendburimi kryesor i IHD-ve në Maqedoni në vitet 2010 dhe 2011 me (12,19) dhe (11,12) për qind, respektivisht.

Situata me Serbinë është disi më ndryshe. Nga tabela në vijim, mund të vërehet se Serbia ka regjistruar fluks hyrës të IHD-ve, kryesisht nga vende të BE-së, si: Austria, Holanda, Italia, Gjermania dhe Federata Ruse. Në vitin 2010, fluksi hyrës i IHD-ve në Serbi është regjistruar më shumë nga Holanda, Austria dhe Sllovenia.

Tabela 15: Stoku i IHD-ve në Serbi, sipas vendit të origjinës, 2005-2010.

Stoku i IHD – ve në Serbi, 2005 – 2011 (në përqindje të totalit)					
2005	2006	2007	2008	2009	2010
Greqi (16)	Norvegji (40)	Austri (59)	Austri (21)	Federata Ruse	Holandë (24)
Austri (15)	Greqi (21)	Greqi (16)	Itali (21)	(32) Austri	Austria (18)
Gjermani (13)	Gjermani (20)	Luksemburg (13)	Holandë (21)	(18) Itali	Sllovenia (10)
Sllovenia (13)	Austri (13)	Montenegro (11)	Kroaci (6)	(13) Holandë	Shtetet e Bashkuara
Luksemburg (8)	Hungari (6)	Itali (8)	Switzerland (5)	(13) Switzerland	(7) Mbretëri e
Qipro (5)	Sllovenia (5)	Qipro (7)	Gjermani (4)	(5) Mbretëri e	Bashkuar (6)
Switzerland (4)	Holandë (-5)	Switzerland (5)	Sllovenia (4)	Bashkuar (4)	Switzerland (6)
Mbretëri e Bashkuar (4)	Qipro (-9)	Francë (4)	Bosnja dhe Hercegovina (-3)	Sllovenia (3)	Itali (5)
Vende të tjera (22)	Vende të tjera (9)	Bosnja dhe Hercegovina (-43) Vende të tjera (20)	Vende të tjera (21)	Vende të tjera (12)	Kroaci (5) Qipro (5) Gjermani (4) Bosnja dhe Hercegovina (-3) Vende të tjera (10)

Burimi: Banka e Serbisë dhe UNSTAD, 2014.

Në përgjithësi, Austria, Hungaria, Holanda, Italia dhe Sllovenia janë ndër vendet kryesore evropiane që llogariten si vende burimore të IHD-ve, për vendet e Evropës

Juglindore. Arsytet mbështeten në kostot e ulëta të transaksioneve për shkak të distancës së ulët mes vendeve burimore dhe vendeve pritëse të IHD-ve, afërsia kulturore mes vendeve burimore dhe vendeve pritëse, marrëveshje dypalëshe midis tyre dhe perceptimeve të popullsisë së vendeve pritëse të rajonit të Evropës Juglindore drejt investorëve të huaj nga vende të BE-së. Në këtë drejtim, nga vendet e rajonit të Evropës Juglindore, Greqia paraqitet si vend burimor i IHD ve për Shqipërinë dhe Maqedoninë, ndërsa për vendet e tjera të EJT-së, si Kroacinë, Bosnjë dhe Hercegovinën dhe Serbinë, vendet e Bashkimit Europian.

3.6. Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore dhe marrëdhënia e tyre me treguesit e tranzicionit

Sipas treguesve të tranzicionit, vendet e Evropës Juglindore, si Shqipëria, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Serbia kanë shënuar rezultate të kënaqshme në drejtim të liberalizimit të çmimeve, liberalizimin e tregtisë së jashtme dhe kurseve të këmbimit, ku indekset mesatare përkatëse, për këtë grup shtetesh, janë: 4,08 dhe 3,92, duke treguar se ekonomitë e shteteve respektive po hapen në fushën e tregtisë, e cila është arritur me anë të krijimit të zonë së tregtisë së lirë në rajon, në përputhje me Paktin e Stabilitetit. Nga vëzhgimi i tabelës në vijim, shohim se shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Kroacinë, gjithashtu regjistrojnë rezultate shumë të mira në fushën e privatizimit në shkallë të ngushtë dhe në shkallë të gjerë, ku indekset mesatare për këtë grup shtetesh, mesatarisht për periudhën 2000-2010, janë: 3,72 dhe 2,88.

Ne vërejmë se problemet më të mëdha për shtetet pretendente për anëtarësim në struktura të BE-së, janë në fushën e reformave të përgjithshme infrastrukturore, në

fushën e liberalizimit të institucioneve financiare-jobankare dhe tregjeve të sigurimit, si dhe në fushën e politikës konkurruese. Në aspektin e performancës ekonomike, vendet në tranzicion të Evropës Juglindore (EJL) kanë mbetur pas vendeve anëtare të reja të Bashkimit Evropian (BE). Ky hendek zhvillimi dhe performance është zgjeruar edhe më shumë për shkak të disa krizave politike dhe ekonomike që vendet e EJL-së pësuan gjatë dekadës së kaluar. Pas proceseve të tranzicionit të rajonit të EJL-së, që përfshinë kalimin e ekonomive të EJL-së nga sistemi i planifikimit qendror në sistemin ekonomik të orientuar nga tregu, vendet e këtij rajoni kanë patur interes të vazhdueshëm për thithje të burimeve të kapitalit të huaj në formë të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Në përputhje me këtë qasje, një numër i madh i vendeve të tranzicionit kanë zhvilluar politika të ndryshme promovuese dhe favorizuese për llogari të tërheqjes së kapitalit të huaj nga vendet amë. Një justifikim i politikave të tilla mbështetet në argumentin se kthimet sociale të IHD-ve tejkalojnë kthimet private, për shkak të përhapjes së produktivitetit nga IHD-të në firmat vendase (Haskel et al., 2002). Në këtë drejtim, rritja e vazhdueshme e Investimeve të Huaja Direkte ka qenë një element i rëndësishëm i proceseve të globalizimit dhe kanë fituar rëndësi të konsiderueshme gjatë dekadave të fundit për përshpejtimin e rritjes dhe zhvillimin e ekonomive në tranzicion. Si rezultat, fillimi i procesit të tranzicionit në vendet e EJL-së, rezultoi në një kthesë të plotë të politikave të IHD-ve. Qeveritë e vendeve të Evropës Juglindore kanë filluar të aplikojnë masa e politika aktive kombëtare të drejtuara drejt krijimit të kushteve të favorshme për investitorët e huaj, nëpërmjet krijimit të ligjeve të reja që favorizojnë investimet e huaja, përmes zbutjes së taksave, krijimit të zonave të lira ekonomike dhe përmes parandalimit të tatimit të dyfishtë.

Në vende të cilat ndjekin politika pasive që lidhen me investimet, IHD-të dekurajohen përmes kërkesave të mëdha për leje dhe regjistrime, si dhe kufizimeve e barrierave për lëvizjen e kapitalit.

Dunning (1993) argumenton se: “Qështja nuk është vetëm liberalizimi i politikave të investimit apo krijimi i stimujve fiskalë për investitorët e huaj. Njëkohësisht, në mos më e rëndësishme, është që qeveritë e vendeve përkatëse të krijojnë e mbështesin një mjedis ekonomik e shoqëror, ku firmat vendase dhe të huaja mund të konkurrojnë në mënyrë efektive”.

Prandaj, vendet e Evropës Juglindore tani janë duke konkurruar në mënyrë aktive për fluksin e IHD-ve nëpërmjet përdorimit të stimujve, siç janë: ulja e tatimeve mbi të ardhurat e korporatave, qëndrueshmëri të politikave fiskale e monetare, ulja e pengesave burokratike dhe rritja e nivelit të eficiensës institucionale.

Për të siguruar një pasqyrë më të plotë të ndikimit të progresit të tranzicionit në fluksin kumulativ të IHD-ve në rajonin e EJT-së, ne kemi përdorur indekset e tranzicionit të ofruara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), duke pasur parasysh se indekset e tranzicionit duhet të jenë të rëndësishme për hyrjet e IHD-ve në vendet pritëse të tyre (tabela në vijim). Për llogaritjen e progresit të masës së tranzicionit, ne kemi konsideruar katër tregues të rëndësishëm të tranzicionit, si: indeksi i reformave në infrastrukturë, indeksi i liberalizimit të tregtisë dhe kursit të jashtëm të këmbimit, indeksi i reformave të sektorit bankar dhe indeksin e reformave në institucionet financiare jo-bankare (Johnson, 2006). Rezultatet e këtij treguesi variojnë nga 9,35 në 15,82. Vlera më e ulët prej 9,35 qëndron për Serbinë, duke treguar një progres të vogël nga standardi i një ekonomie të planifikuar, ndërsa vlera më e lartë prej 15,82 qëndron për Hungarinë, duke treguar se ekonomia përkatëse po i afrohet

standardeve të ekonomisë së tregut dhe normave të industrializimit në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut.

Një tregues tjetër për progresin e tranzicionit është konsideruar edhe pjesëmarrja e sektorit privat në PPB-në (Johnson, 2006). Ky tregues, mesatarisht, gjatë viteve 2000-2010, për vendet e EQL-së, është 68,22 për qind, ndërsa për shtetet anëtare të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore është 90.30 për qind, duke konfirmuar edhe një herë dallimin mes vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, në aspekt të funksionalitetit të tregut dhe progresit të tranzicionit. Gjithashtu, ekziston dallim i konsiderueshëm ndërmjet dy grupeve të vendeve, në aspekt të pranimit të IHD-ve në ekonomitë e tyre nacionale, për periudhën 2000 - 2010. Duke vlerësuar të dhënat nga tabela 16, vërejmë se vendet e EQL-së që kanë shënuar përparim të lartë në drejtim të tranzicionit, gjatë periudhës së vrojtuar, kanë marrë sasi të mëdha të fluksit hyrës të IHD-ve, duke lënë pas vendet e EQL-së me sasi të vogla të fluksit hyrës të IHD-ve. Ky argument, edhe një herë, konfirmon marrëdhënien pozitive midis treguesve të indekseve të tranzicionit, treguesit të pjesëmarrjes së sektorit privat në PPB-në dhe flukseve hyrëse të IHD-ve, duke sugjeruar se vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, që kanë pjesëmarrje më të lartë të sektorit privat në PPB-në, marrin fluksin më të lartë të IHD-ve, në krahasim me vendet e Evropës Juglindore.

Treguesit e tranzicionit janë të rëndësishëm për stimujt e investitorëve të huaj për të ndërmarrë një aktivitet direkt investimi në një ekonomi pritëse. Tranzicioni i suksesshëm përmirëson kushtet për investitorët e huaj që të angazhohen në aktivitetet e investimeve të huaja në ekonominë e vendit pritës. Prandaj, ashtu si përparon tranzicioni në ekonominë pritëse, gjasat e kompanive shumëkombëshe (KSHK) të angazhohen në aktivitete fitimprurëse ekonomike në ekonominë përkatëse është në rritje.

Mes treguesve të tranzicionit të EBRD-së më të rëndësishme për stimujt investues të kompanive shumëkombëshe janë: liberalizimi i çmimeve, liberalizimi i tregtisë dhe sistemi i këmbimit valutor. Firmat shumëkombëshe nuk duan të jenë të kufizuara nga rregulloret qeveritare të çmimeve, kur ato konsiderojnë investimet e tyre në tregjet përkatëse. Një rregullore qeveritare për çmimet do të ulë funksionalitetin dhe eficensën e tregut të ekonomisë pritëse që rezulton në uljen e stimujve të kompanive shumëkombëshe për ndërmarrjen e Investimeve të Huaja Direkte në ekonominë përkatëse.

Gjithashtu, liberalizimi i tregtisë dhe liberalizimi i sistemit të këmbimit valutor është i rëndësishëm për investitorët e huaj, për shkak të procesit të prodhimit të firmave shumëkombëshe në vendin pritës. Për më tepër, ekzistenca e një infrastrukturë të zhvilluar dhe efektive është e domosdoshme për operacionet e një kompanie shumëkombëshe, pasi ajo redukton kostot e transportit, shpërndarjes dhe të prodhimit (Johnson, 2006). Për sa i përket këtyre indekseve, pothuajse të gjitha ekonomitë e Evropës Juglindore kishin arritur liberalizimin e çmimeve dhe tregtisë dhe liberalizimin e këmbimit valutor, duke i dhënë kështu një hapësirë firmave shumëkombëshe të marrin në konsideratë këto vende për investime.

Gjithashtu, tregues të tjerë, si: privatizimi në shkallë të gjerë dhe të ulët, ristrukturimi i ndërmarrjeve, politika e konkurrencës, reformat e përgjithshme të infrastrukturës janë duke treguar se vendet e EJT-së janë në formë të mirë në rrugën e tyre drejt rritjes së funksionalitetit të tregut të lirë, duke iu afruar nivelit të standardeve të ekonomive të zhvilluara.

Tabela 16. Treguesit e tranzicionit për vendet e EJT-së, mesatare 2000 – 2010.

Vendet	Privatizimi në shkallë të gjerë	Privatizimi në shkallë të ngushtë	Ristrukturimi i bizneseve	Liberalizimi i çmimeve	Liberalizimi i tregtisë dhe kursit të jashtëm të këmbimit	Politika konkurruse	Reformat në sist. bankar dhe liberalizimi i normave të interesit	Tregjet e sigurimeve dhe institucioneve financiare jo – bankare	Reformat e përgjithshme infrastrukture	Progresi i tranzicionit	Pjesëmarrja e sektorit privat në PPB	Hyrjet kumulative të IHD-ve 2000-2010
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10 = 9+5+7+8	11	12
Shqipëri	3,12	4,00	2,15	4,33	4,33	1,88	2,63	1,67	2,12	10,75	75,00	4.037,8
Bosnjë	2,60	2,90	1,91	4,00	3,57	1,42	2,63	1,54	2,30	10,04	63,33	6.548,7
Kroaci	3,24	4,33	2,88	4,00	4,33	2,51	3,18	2,75	2,87	13,13	79,44	21.838,6
Maqedoni	3,21	4,00	2,48	4,21	4,24	2,12	2,76	2,09	2,27	11,36	78,33	3.501,1
Serbi	2,24	3,36	1,99	3,84	3,12	1,45	2,36	1,78	2,09	9,35	45,00	17.303,9
EJT – 5, mesatare	2,88	3,72	2,28	4,08	3,92	1,88	2,71	1,97	2,33	10,92	68,22	10.646,02
Bullgari	3,88	3,82	2,57	4,30	4,33	2,60	3,48	2,51	2,97	13,29	90,00	46.988,8
Rumani	3,51	3,67	2,33	4,33	4,33	2,51	3,00	2,45	3,21	12,99	82,77	51.513,6
Slloveni	3,00	4,33	2,94	4,00	4,33	2,67	3,33	2,76	2,97	13,39	81,66	926,7
R.Sllovake	4,00	4,33	3,45	4,27	4,33	3,21	3,51	2,69	2,87	13,40	97,77	26.023,4
Hungari	4,00	4,33	3,51	4,33	4,33	3,21	3,97	3,85	3,67	15,82	97,77	24.326,8
Poloni	3,36	4,33	3,48	4,33	4,33	3,15	3,51	3,70	3,48	15,02	91,11	102.111,0
Letoni	3,51	4,33	2,91	4,33	4,33	2,81	3,63	2,87	2,97	13,8	84,44	7.108,9
Lithuani	3,75	4,33	2,94	4,27	4,30	3,15	3,42	3,12	2,82	13,66	90,55	7.643,9
Estoni	4,00	4,33	3,48	4,33	4,33	3,33	3,88	3,42	3,33	14,96	96,66	7.192,6
	3,67	4,20	3,07	4,28	4,33	2,96	3,53	3,04	3,14	14,04	90,30	30.426,19

Burimi: EBRD 2012; llogaritje personale.

KAPITULLI IV: INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

4.1. Hyrje

Si të gjitha vendet e kampit socialist, Shqipëria trashëgoi nga sistemi i kaluar një varfëri ekstreme, ekonomi të pazhvilluar me një prapambetje të theksuar në të gjithë sektorët e saj dhe që nuk respektonte avantazhet konkurruese, si dhe mungesa të theksuara në funksionimin e administratës. Qëllimi i këtij kapitulli është të trajtojë tranzicionin ekonomik në Shqipëri të lidhur ngushtë me rolin e IHD-ve në këtë proces. Ky kapitull është organizuar në gjashtë pjesë. Në pjesën e parë trajtohet procesi i tranzicionit në Shqipëri dhe sfidat drejt Bashkimit European. Në këtë pjesë të punimit bëhet një panoramë e rrugës që ndoqi Shqipëria pas viteve '90-të për transformimin e ekonomisë nga planifikimi i centralizuar drejt tregut. Pjesa e dytë e këtij kapitulli trajton profilin e IHD-ve. Në pjesën e tretë, duke shfrytëzuar të dhënat, bëhet një analizë e prurjeve të IHD-ve ndër vite në krahasim me rajonin dhe tendencat globale. Pjesa e katërt trajton aspekte të stokut të IHD-ve. Pjesa e pestë përshkruan mjedisin shqiptar për zhvillimin e IHD-ve. Pjesa e gjashtë përshkruan politikat dhe masat që mund të ndërmerren për rritjen e IHD-ve. Investimet e Huaja Direkte janë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht apo kontribut për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Nisur nga kjo pikëpamje, politikat nxitëse për tërheqjen e IHD-ve kanë qenë dhe mbeten sfidë dhe një nga objektivat kryesore të qeverisë shqiptare, e cila po bën përpjekje në krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj, të shoqëruar me

një kuadër ligjor të përshtatshëm. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli kemi trajtuar disa nga pengesat për zhvillimin e IHD-ve në Shqipëri.

4.2. Tranzicioni në Shqipëri dhe sfidat drejt Bashkimit European

Shqipëria është një vend europian që ndodhet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, me një sipërfaqe prej 28.748 km katrorë. Ajo kufizohet në veri me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në lindje me Maqedoninë, në jug me Greqinë dhe në perëndim me Italinë. Ka një reliev dhe klimë shumë të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë. Deri në vitet 1990, Shqipëria drejtohej nga një sistem politik i centralizuar socialist, ku karakteristikat përcaktuese ishin pronësia shtetërore mbi mjetet e prodhimit, dhe vendimet në lidhje me objektivat e prodhimit, “shpërndarjen e produktit social” ndërmjet konsumit dhe investimeve, si dhe mënyra e shpërndarjes së faktorëve prodhues merren në kuadrin e një planifikimi shtetëror. Planifikimi i centralizuar i prodhimit, sundimi njëpartiak nga partia komuniste dhe integrimi ekonomik mes vendeve socialiste, e kombinuar kjo me një ndarje nga pjesa tjetër e botës, ishte një karakteristikë tjetër për vendet socialiste. Ekonomitë socialiste duhej të ishin të izoluara nga ndikimi i jashtëm, i cili rrezikonte autoritetet planifikuese në fushën e fiksimit të çmimeve dhe shpërndarjes së burimeve të prodhimit (Civici, 2014). Varfëria e madhe dhe mungesa e lirive të individit bënë që sistemi të rrëzohej dhe të zëvendësohej me ekonominë e tregut. Kur Shqipëria hyri në procesin e tranzicionit me qëllim integrimin në ekonominë e tregut, si të gjitha vendet ish-komuniste, ajo u ballafaqua me dy doktrina kryesore në lidhje me procesin. Doktrina e parë inkurajonte fillimin e procesit nga “niveli zero”, duke përfshirë këtu “terapinë e shok-ut” dhe shkatërrimin e çdo gjëje të trashëguar nga

sistemi i mëparshëm. “Terapia e shok-ut” mbështetet në idenë se ndryshimi i sistemit është i pakthyeshëm sapo të jetë e mundur të zbatohen një sërë politikash që në hapat e parë të tranzicionit: stabilizimi dhe liberalizimi i çmimeve, hapja ndërkombëtare e disa sektorëve dhe aktiviteteve të ekonomisë, realizimi i privatizimeve, këmbimi i lirë i monedhave.

Teoria neoklasike propozon se, “metoda kryesore e transformimit të shpejtë dhe reformimit ekonomik është ajo e ‘terapisë së shok-ut’”. Ajo është shumë më tepër sesa thjesht paketa e masave specifike ekonomike që përmbledhen në sloganin “stabilizim, liberalizim, privatizim”. Doktrina e dytë inkurajonte idenë se procesi i tranzicionit duhet të zhvillohet përmes “ndryshimeve graduale”, i mbështetur nga faktorë objektivë, si pasuritë natyrore, burimet njerëzore dhe mjetet financiare në pronësi të shtetit. Në kuadër të kësaj logjike apo koncepti, tranzicioni duhet konceptuar të realizohet “me disa hapa” të përcaktuar qartë në kohë dhe në radhën e tyre. Është legjitime të mendohet se zgjedhja ndërmjet versionit gradual dhe terapisë së shok-ut duhej të ishte e diferencuar nga njëri vend në tjetrin, në varësi të kushteve ekonomike e politike. Terapia e shok-ut u preferua shumë nga vende që ishin shumë të varfëra. Kjo rrugë u tentua të zbatohet në Poloni, Shqipëri, Bullgari dhe Rusi gjatë viteve 1991-1992, ndërkohë që Hungaria është shembulli më tipik i rrugës gradualiste, që në fund të viteve '70-të. Në këtë vend, ndryshimet politike dhe ekonomike të viteve 1990 nuk përbënin ndonjë reformë apo transformim radikal, por thjesht politika konjukturore dhe strukturore që kishin konsensusin e plotë të pozitës dhe opozitës të vendit. Në Poloni, Rumani dhe Bullgari procesi i tranzicionit ndodhi në mënyrë spontane dhe të shpejtë, por u shoqërua me destabilitet makroekonomik. Pavarësisht nga zgjedhja ose preferencat për terapinë e shok-ut ose për rrugë graduale, për kalimin e periudhës së tranzicionit, pothuajse të

gjitha vendet ish-socialiste, në fillimet e tranzicionit, kryesisht në periudhën 1989-1994 u përballën me situata të vështira ekonomike financiare e sociale si pasojë e recensionit të thellë që pësuan. Studimet dhe analiza për këtë periudhë evidentojnë tri arsye fundamentale që ndikuan këtë situatë: tentativat për një stabilizim sa më të shpejtë makroekonomik: efekti i ndryshimeve institucionale; ristrukturimi mikroekonomik (Civici, 2014).

Edhe në Shqipëri, fillimet e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut u shoqëruan me probleme të mëdha makroekonomike. Mallrat e konsumit të gjerë filluan të mungonin në masë, duke kaluar në sistemin e tollonave ushqimore për popullsinë, eksportet u ulën ndërkohë që nevoja për importet vazhdimisht shtoheshin, rezervat me devizë u pakësuan dhe prodhimi po binte me ritme të larta. Gjatë viteve 1991-1992 filluan të shfaqen problemet e para makroekonomike, PBB-ja ra me 50 për qind, rritja ekonomike -13% dhe norma e papunësisë u rrit në 50 për qind (Civici, 2014). Po t'i referohemi të dhënave të Bankës Botërore, niveli i PBB-së për frymë në vitin 1990 ishte 639 dollarë dhe në vitin 1992 arriti në 217 dollarë, pra më pak se 1 dollar në ditë. Banka Botërore dhe FMN-ja e cilësonin këtë periudhë si “fundosje ekonomike e vendeve ish-socialiste në tranzicion”. Në versionin më optimist, Banka Botërore parashikonte që niveli i prodhimit para vitit 1989 do të arrihej mbas vitit 2000 për shtete, si: Bullgaria, Rumania dhe Shqipëria (Banka Botërore, 1991). FMN-ja nga ana e saj nënvizonte se arsyeja kryesore e këtij recensionit ishte shembja e sektorit shtetëror të ekonomisë, kanalizimi i një pjese të prodhimit dhe shërbimeve në sektorin informal e në sektorin formal të tregut, por ende mjaft të dobët. Ndryshimet politike që ndodhën në vitin 1990-1991 i hapën rrugën transformimit radikal të ekonomisë shqiptare: nga një ekonomi e

centralizuar me planifikim qendror-drejt një ekonomie të hapur tregu të tipit perëndimor.

Reforma e plotë stabilizuese e ekonomisë filloi të zbatohet në mes të vitit 1992, me asistencën e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Programi mbështetej në pesë shtylla kryesore:

- *Stabilizimi*, u mbështet në paketën standarde që konsiston në liberalizimin e çmimeve, në politikën fiskale që synonte balancimin e deficitit buxhetor, në politikën shtrënguese monetare që synonte vendosjen e një monedhe të qëndrueshme dhe dhënies fund të inflacionit të lartë.
- *Liberalizimi*, synonte që të zhvilloheshin tregjet nëpërmjet legalizimit të aktivitetit ekonomik privat, ndërprerjes së kontrollit të çmimeve, si dhe në liberalizimin e tregtisë së jashtme.
- *Privatizimi*, si një politikë strukturore që kishte si qëllim identifikimin e aseteve shtetërore dhe privatizimin e tyre në forma të ndryshme në varësi të rrethanave.
- *Rrjeti i mbrojtjes shoqërore*, pensione, kujdes shëndetësor dhe përfitime të tjera për të moshuarit dhe të varfërit dhe veçanërisht të prekurit nga tranzicioni.
- *Kuadri ligjor i përshatshëm*, hap pas hapi për një ekonomi tregu.

Rezultatet e para të kësaj reforme ishin të dukshme. Pas një periudhe trevjeçare rënieje, 1990-1992, Shqipëria arriti stabilitet makroekonomik, PBB-ja u rrit ndjeshëm gjatë viteve pasardhës, 1993-1996 (në terma realë rreth 9 për qind). Kontributi kryesor në këtë rritje vinte si pasojë e bujqësisë, e cila u privatizua gjerësisht dhe shënoi një rritje të produktivitetit. Shifra zyrtare e papunësisë u reduktua dhe praktikisht arriti në 12 për qind në vitin 1996-të. Remitancat e shqiptarëve që punonin jashtë vendit shërbyen si një burim i mirë për kursime dhe për rrjedhojë patën një impakt mjaft të fortë në rritjen

ekonomike. Pavarësisht këtyre arritjeve të ekonomisë shqiptare në këto vite, progresi ekonomik nuk u mbështet nga reforma institucionale. Institucionet shtetërore mbetën të dobëta dhe sektori financiar nuk iu përgjigj zhvillimeve ekonomike në ambientin e ri konkurrues të tregut. Nga këndvështrimi ekonomik, këto probleme me natyrë negative në ekonomi ishin më influencuese gjatë vitit 1997-të, ku ekonomia shqiptare u fut në krizë financiare me pasoja katastrofike për ekonominë e vendit, për shkak të përmbysjes së skemave piramidale. Kriza ekonomike dhe politike çoi në rënie të prodhimit në masën⁷ për qind, në rritje të inflacionit me 45 për qind, duke u shoqëruar me përkeqësim të llogarisë koherente dhe të deficitit fiskal (Kule dhe Haderi, 2001).

Qeveria e re e mesvitit 1997, gjatë vitit 1998 zbatoi një program të detajuar paskrizë, duke u mbështetur edhe nga donatorët ndërkombëtarë, si dhe thelloi më tej reformat strukturore, veçanërisht në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, si dhe atyre strategjike. Thellimi i reformave strukturore, duke marrë në konsideratë faktin se progresi nuk ishte në nivelin e dëshiruar, për vitin 1998-të, u konsiderua prioritet sigurimi i arritjeve makroekonomike afatgjata.

Prioritetet konsistonin në:

- ✓ Përshejtim të procesit të privatizimit (përfshirë këtu dhe bankat në pronësi të shtetit).
- ✓ Përfundim të procesit të transparencës të skemave piramidale.
- ✓ Reduktim të numrit të punonjësve të sektorit buxhetor në fund të vitit 1999-të, në 130 000 vetë.
- ✓ Fuqizim të kuadrit mbikëqyrës, rregullator dhe ligjor në të cilin operojnë bankat.

Gjatë këtij viti u shënua një rritje ekonomike prej 8 për qind dhe një rënie e normës së inflacionit me 8,7 për qind nga 42 për qind që ishte në vitin 1997 (Kule dhe Haderi, 2001). Viti 1999-të konsiderohet si vazhdim i arritjeve të vitit 1998-të. Thellimi i reformave strukturore, duke marrë në konsideratë faktin se progresi nuk ishte në nivelin e dëshiruar, për vitin 1999-të, u konsiderua prioritet sigurimi i arritjeve makroekonomike afatgjata. Konflikti i Kosovës, migrimi masiv i refugjatëve në Shqipëri sikurse dhe perspektiva e paqartë e zhvillimit të mëtejshëm të krizës, krijuan idenë se do të ishte mjaft e vështirë përmbushja e programit ekonomik për vitin 1999-të. Sipas raportit të FMN-së (2005), ecuria e përgjithshme makroekonomike e ekonomisë shqiptare që nga viti 1997 ka qenë e mirë. Sipas FMN-së dhe Ministrisë së Financave (MF), ekonomia shqiptare u rrit me 4.7 për qind në vitin 2002 krahasuar me një vit më parë.

Ky ishte viti i pestë që shënonte rritje ekonomike, megjithëse u konsiderua si rritja më e vogël në harkun kohor 1998-2002, krahasuar me parashikimin prej 6 për qind. Pas një ngadalësimi në vitin 2002, rritja ekonomike e mori përsëri veten në ritmet rreth 6 për qind, inflacioni ra me një normë vjetore që mbetet brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë 2-4 për qind. Si të gjitha vendet e tjera në tranzicion të rajonit tonë, vitet e fundit, Shqipëria ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt liberalizimit të ekonomisë së saj dhe ka nxitur në mënyrë të dukshme orientimin e saj drejt sektorit privat. Shqipëria, gjatë dy dekadave, 1990-2010, realizoi reforma drastike drejt vendosjes së ekonomisë së tregut. Përballë dy alternativave të mundshme: “tranzicion gradual” ose “terapi e shokut”, vendi zgjodhi rrugën e tranzicionit radikal, duke privilegjuar liberalizim të gjerë në të gjitha fushët. Sipas mbështetësve të kësaj teorie, masat në lidhje me stabilizimin dhe liberalizimin, si dhe sigurimi i një rritje ekonomike e konsiderueshme mund të arrihej pa

ndërhyrjen e shtetit. Reformat ekonomiko-financiare të ndërmarra gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri mund t'i përmbledhim si më poshtë:

1. Politikë monetare restriktive, të shoqëruar me krijimin e një banke qendrore të pavarur; nxitjen dhe krijimin e disa bankave tregtare të nivelit dytë; zgjerimin në përgjithësi të shërbimeve bankare.
2. Politikë buxhetore rigorozë, të realizuar nëpërmjet suprimimit të sistemit të subvencioneve shtetërore. Ndërtimin e një sistemi të ri fiskal dhe tatimor, si dhe kontrollin rigoroz të inflacionit.
3. Liberalizimin e tregut të brendshëm të kapitaleve, ku spikasin vendosja e një tregu eficient kapitalesh, krijimin e bazave të nevojshme juridike për funksionimin e tregut të kapitaleve.
4. Liberalizim i tregtisë së jashtme nëpërmjet suprimimit të monopolit shtetëror mbi tregtinë e jashtme.
5. Rritja e ofertës së brendshme, të përqëndruar kryesisht në reformën e çmimeve dhe në eliminimin fiktiv të tyre si pasojë e mungesës së brendshme në sasinë e kërkuar nga tregu; nxitje e prodhimit industrial dhe bujqësor etj.

Megjithatë, edhe pse Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash makroekonomike dhe gjithashtu ka provuar vitet e fundit rritje ekonomike të ndjeshme, përsëri ekziston njëfarë dekurajimi që pengon depërtimin e investitorëve të huaj në vend, nga pikëpamja strategjike dhe afatgjatë, duke bërë në këtë mënyrë që mos të ndjehen shumë benefitet që krijon një investitor i huaj. Shqipëria ka vuajtur nga destabiliteti makroekonomik. Arsyet për performancën e dobët ekonomike janë: paqëndrueshmëria politike, mungesa e reformave institucionale, institucione të dobëta. Nuk ka asnjë dyshim se në fillim të tranzicionit, Shqipëria është përballur me kushte fillestare më të këqija se vendet e tjera

të rajonit të Evropës Juglindore. Shumë nga vendet në tranzicion që synojnë thithjen e investimeve të huaja iu nevojitet një kuadër makroekonomik stabil dhe inflacion i ulët. Parë nga këndvështrimi i investitorëve, ata mund të sigurojnë mjaft përfitime në ekonominë në tranzicion, por ekziston dhe risku i problemeve procedurale si pasojë e papërshtatshmërive në sistemin ligjor kur tërhiqen nga ekonomi të tilla. Gjendja e institucioneve dhe cilësia e shoqërisë civile janë faktorë mjaft të rëndësishëm që influencojnë vendimet e investitorëve të huaj, sidomos në ekonominë në zhvillim. Normalisht, anëtarësimi i ardhshëm në BE mund të jetë një përcaktues i pavarur i IHD-ve në ekonominë në tranzicion. Janë realizuar investigime mbi këtë çështje përmes eksplorimit të impaktit që kanë shpalljet e anëtarësimit në BE-në për ekonominë në tranzicion në IHD-të hyrëse. Studime të ndryshme mbi IHD-të në tregjet në zhvillim i kanë kushtuar rëndësi të veçantë indikatorëve të riskut politik dhe atij ekonomik si elemente mjaft të rëndësishëm në përcaktimin e strukturës së IHD-së një vendi të caktuar.

Në këtë grup bëjnë pjesë tre elementë:

1. Stabiliteti makroekonomik, si: rritja, inflacioni, risku i kurseve të këmbimit.
2. Stabiliteti institucional, si politikat kundrejt IHD-ve, regjimi i taksave, transparenca e rregullave legislative dhe shkalla e korrupsionit në vend.
3. Stabiliteti politik, i matur nga indikatorët në lidhje me lirinë politike deri tek masat e mbikëqyrjes dhe revolucionit.

Në Shqipëri, faktorët kryesorë që ndikojnë IHD-të janë përmbledhur si më poshtë:

1. Stabiliteti ekonomik.
2. Stabiliteti politik.
3. Sistemi fiskal.

4. Infrastruktura.
5. Korrupsioni.
6. Konkurrenca e padrejtë.

1. Stabiliteti ekonomik

Performanca ekonomike e Shqipërisë është një histori suksesi me shumë faqe. Është bërë progres impresionues gjatë viteve të shkuara, duke patur parasysh shumë faktorë makro-ekonomikë, por zgjerimi i ndarjes rurale-urbane, si dhe korrupsioni ngulmues tregojnë se arritjet ekonomike të Shqipërisë nuk kanë qenë pa efekte anësore. Gjithashtu, ndërkohë që normat e rritjes ekonomike kanë qenë të qëndrueshme dhe janë raportuar në nivele të larta (deri 2010), kjo qëndron vetëm në krahasim me normat e mëparshme, sepse ato janë akoma të ulëta në krahasim me vende të tjera në tranzicion. Edhe për vitin 2009, vendi ynë nuk shënoi rënie ekonomike, ndërkohë që është hera e parë që prej shumë dekadash, ekonomia botërore shënoi rënie.

Treguesit bazë që karakterizojnë gjendjen e një ekonomie janë: produkti i përgjithshëm, që për vitin 2009, sipas Bankës së Shqipërisë, ishte rritur me 3 për qind, inflacioni që për vitin 2009 ishte mesatarisht 2.2 për qind dhe deficitit fiskal që për vitin 2009 u rrit ndjeshëm në 7 për qind të PBB-së, nga 4-5 për qind që ishte dy vitet e fundit. Rritja e deficitit fiskal është problem për ekonominë, megjithëse edhe për këtë shkollat e ndryshme japin argumentet pro dhe kundër. Ndërkohë që disa reforma strukturore dhe një angazhim i fortë i stabilitetit makro-ekonomik ka çuar në nivele të mjaftueshme të punësimit dhe rritje të shpejtë, rritja ekonomike nuk përfshin shumë anëtarë të shoqërisë, sidomos jo të varfërit. Ekonomia informale akoma luan një rol të rëndësishëm, me një normë të aktivitetit prej 34.1 për qind GNI-së. Normat e inflacionit

janë stabël dhe qëndrojnë në nivele të pranueshme, ndërkohë që borxhi i lartë i shtetit është shqetësues. Deficiti tregtar është i lartë si përqindje ndaj PBB-së. Remitancat që zënë një përqindje të konsiderueshme të PBB-së gjithashtu shërbejnë si burimi kryesor i mbulimit të deficitit tregtar, ndërsa Investimet e Huaja Direkte luajnë një rol të kufizuar për sa i përket këtij aspekti. Këto investime dhe eksportet njëkohësisht janë të ulëta si përqindje e PBB-së. Në përmbledhje, në mungesë të një kornize të fortë institucionale të bazuar në ligj, ekonomia e tregut në Shqipëri bazohet në tregun e lirë, por është e brishtë. Shqipëria ka bërë një rrugë të gjatë në procesin e tranzicionit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ekonomia e vendit ka shënuar rritje në terma mesatar gjatë viteve të fundit. Transferimi paqësor i pushtetit në vitin 2005 ishte një pasqyrim i pjekurisë politike. Bazuar në këto zhvillime, Shqipëria ka bërë më në fund hapin e parë të rëndësishëm drejt integritit për në Bashkimin Europian, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA). Më shumë përpjekje nevojiten për të kapërcyer varfërinë dhe strukturat tradicionale dhe stabilizimit të institucioneve demokratike. Pavarësia e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit duhet të implementohen sepse garantohen nga kushtetuta.

Kjo është e domosdoshme për qeverisjen e mirë, rritjen ekonomike dhe sigurinë ligjore. Ekonomikisht sfidat kryesore të tranzicionit në vend duhet të inkurajojnë zhvillimin e sektorit privat dhe të kthejnë sektorin informal në ekonomi reale. Investimet afatgjata janë të nevojshme për të zhvilluar infrastrukturën e vendit, rrugët, aeroportet, elektricitetin, telekomunikacionin. Fakti që vendi ka një popullsi të re dinamike (2.8 milionë, 2011), reformat dhe ndryshimi mund të aplikohen lehtësisht. Në kohën që aktivitetet ekonomike private rriten, roli i iniciativave të qytetarëve rritet, si në sferën ekonomike dhe atë të edukimit. Mbajtja e stabilitetit ekonomik dhe thellimi i

marrëdhënieve me Bashkimin Europian është i rëndësishëm për të ardhmen e performancës makro-ekonomike të Shqipërisë. Në qoftë se do t'i referoheshim studimeve të ndryshme në lidhje me tendencën e IHD-ve në Evropën Lindore vihet re se hyrja më e madhe IHD-ve të rajonit është realizuar në Rumani dhe një nga arsyet për këtë fenomen mbetet madhësia e ekonomisë që ajo ka. Nga studimi vihet re qartë se madhësia e tregut luan një rol mjaft të rëndësishëm në thithjen e IHD-ve. Ky studim nxjerr në pah se niveli i IHD-ve në Shqipëri ka qenë mjaft i luhatshëm si pasojë e luhatshmërisë së madhësisë së tregut. Në mënyrë të ngjashme, për sa i përket destabilitetit ekonomik është vënë re se deficitet e bilanceve të pagesave dhe inflacioni janë faktorë të cilët ndikojnë në përpjesëtim të zhdrejtë në nivelin e përthithjes së IHD-ve. Stabiliteti i valutës nuk është thjesht një faktor përcaktues në arritjen e objektivave të politikës monetare dhe reduktimin e deficiteve në sektorin e huaj, por gjithashtu një element kyç në procesin e vendimmarrjes së investitorëve të huaj. Këta investitorë janë mjaft të shqetësuar për sa i përket risqeve që shoqërojnë kurset e këmbimit, në përpjekjet e tyre për t'i minimizuar apo eliminuar ato.

Nga pikëpamja psikologjike, vende si Maqedonia dhe Bullgaria konsiderohen si vende të preferuara për investitorët e huaj, pasi objektivi kryesor i autoriteteve monetare të këtyre vendeve është ruajtja e kurseve të këmbimit fikse. Stabiliteti i çmimeve dhe qëndrueshmëria makroekonomike janë mjaft domethënëse për sa i përket vendimeve afatgjata të investitorëve të huaj.

Shqipëria ka bërë progres në lidhje me ndryshime të rëndësishme politike të ndodhura në vend. Me anëtarësimin e saj në NATO pritet që edhe IHD-të të rriten, pasi tashmë Shqipëria ka hyrë në rrethin e vendeve që ofrojnë kushte dhe siguri të lartë dhe ky është

një element mjaft i rëndësishëm për investorët e huaj. Shqipëria është parë nga investorët si një vend që ofron pak për sigurinë dhe kjo është stimuluar edhe me ngjarjet e vitit 1997. Por tashmë elementi i sigurisë garantohej nga anëtarësimi në NATO dhe kjo përbën një hap mjaft cilësor ndaj thithjes së investimeve të huaja në vend. Për shkak të anëtarësimit në aleancë, ekspertët presin të shohin investime kryesisht në sektorin e energjisë, si edhe në sektorët e burimeve natyrore dhe turizmit. Me një infrastrukturë në zhvillim, nxitjen qeveritare dhe një rritje në numrin e turistëve, turizmi shqiptar po bëhet gjithnjë e më tepër tërheqës për kompanitë e huaja. Gjatë vitit 2008, Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri rezultuan rreth 60 për qind më të larta se një vit më parë, duke arritur një rekord prej 600 milionë eurosh. Sipas Raportit të Investimeve Botërore (UNSTAD, 2011), IHD-të në vitin 2010 u rritën për herë të parë në më shumë se 1 miliardë dollarë, duke u bërë vendi i dytë në Evropën Juglindore për thithjen e IHD-ve, pas Serbisë. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Investimet e Huaja Direkte kanë pësuar rënie në të gjitha vendet e Evropës Juglindore me përjashtim të Shqipërisë, e cila shënoi përsëri rritje për vitin 2010. Në raportin e Bankës Botërore (BB), për vitin 2007-2008, Shqipëria u klasifikua si vendi i dytë për nga shpejtësia dhe cilësia e reformave të ndërmarra për klimën e biznesit. Shqipëria, të paktën deri në vitin 2011, konsiderohet si vendi me taksat më të ulëta në Europë.

2. *Stabiliteti politik*

Stabiliteti politik i një vendi mund të shkaktojë një influencë mjaft të lartë mbi vendimet e investorëve të huaj për sa i përket vendit ku do të investohet. Studime paraprake gjithashtu vënë në dukje se stabiliteti politik i vendeve pritëse influencon IHD-të hyrëse.

Destabiliteti politik dekurajon vendimet për investim në një vend, duke u shndërruar kështu në faktorin më të rëndësishëm që influencon vendimin për IHD-të, përveç potencialit të tregut. Ndërsa disa studime më të hershme të fokusuara në vendet në zhvillim sugjerojnë se në ekonomitë në tranzicion, si ekonomitë e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, një bashkësi institucionesh politike të besueshme, si dhe politika fiskale dhe monetare e stabilizuar nevojiten gjithashtu për të përthithur IHD-të. Në vlerësimet e bëra nga disa studiues në vitin 1999 për IHD-të, në kuadër të risqeve politike, supozohet se përfitueshmëria e IHD-ve në vendin e huaj është në përpjesëtim të drejtë me kthimet e siguruara mbi investimin e huaj direkt. Megjithatë IHD-të mund të jenë të mbrojtura nga politika të ndryshme, ato sërish mbeten të brishta kundrejt ndryshimeve politike. Kjo përfshin pakthyeshmërinë e valutës, dëmtimet e luftës, dëmtimet e luftës civile, aksione kundrejt stafit të kompanisë (si për shembull rrëmbim personi) dhe limite mbi remitancat. Nga ana tjetër, konsideratat socio-politike sugjerojnë se veprimet e qeverisë, të cilat rrisin humbjet nga risqet politike, ka më shumë të ngjarë të ndodhin kur kthimet nga IHD-të janë të pafavorshme. Duke u kthyer në rastin e Shqipërisë, mjedise të pastabilizuara në aspektin e sigurisë politike dhe vendase, janë pengesa serioze për investitorët e huaj. Në studime të ndryshme kudo në botë, në lidhje me IHD-të, kombet e karakterizuara nga paqëndrueshmëri sociale dhe politike janë më pak atraktive nga këndvështrimi i investitorëve të huaj, si pasojë e mundësisë së dhunës dhe pasigurisë që rrjedhin nga konfliktet sociale.

Duke u bazuar në literaturën e Bankës Botërore (2001), e cila i referohet paqëndrueshmërisë sociale bazuar në përbërjen etnike të popullsisë, vihet re se, sa më i fragmentarizuar etnikisht të jetë një rajon, aq më e madhe është mundësia e fërkimeve sociale dhe për rrjedhojë më i ulët do të jetë niveli i IHD-ve në atë vend, të gjitha

kushtet e tjera të pandryshuara. Shqipëria karakterizohet nga një e shkuar politike mjaft e vështirë, që do të thotë se vjen nga një regjim komunist diktatorial. Populli është rritur me frikën e të folurit lirshëm si pasojë e eksperiencës persekutuese të fjalës së lirë. Kjo situatë bëhet dhe më delikate kur bëhet fjalë për barrierat e vërteta me të cilat përballen IHD-të. Në shumicën e rasteve është mjaft e lehtë të shkëpusësh një opinion nga një investitor i Evropës Perëndimore, i cili nuk do të hezitonte të shprehej në lidhje me barrierat që e pengojnë atë të arrijë qëllimet e tij në një vend post-komunist. Nga eksperiencia e përgjithshme, të gjitha këto vende ish-komuniste kanë vuajtur nga një nivel i lartë korrupsioni në qeveritë e tyre, i cili është reflektuar në menaxhimin e burimeve të brendshme dhe të jashtme.

3. Sistemi Fiskal

Të gjitha ekonomitë në tranzicion, që në fillim të tranzicionit, kanë përshtatur të njëjtën filozofi të politikës fiskale, bazuar në rritjen e të ardhurave buxhetore dhe kryesisht në rënien e shpenzimeve të larta të buxhetit. Në disa shqyrtime ekonomike, pohohet se të ardhurat nga taksat si përqindje ndaj PBB-së mbeten më të ulëta në rajonin e Evropës Lindore, dhe se Shqipëria ka shumë për të bërë në këtë aspekt. Nga ana tjetër, në qoftë se do të krahasonim normat e tvsh-ve në rajon do të vinim re se norma e Shqipërisë është nga më të lartat. Kjo është një politikë e mirë për buxhetin e shtetit, por kurrësi për përthithjen e IHD-ve në vend. Mendohet se një regjim i përshtatshëm fiskal për IHD-të duhet të promovojë një sistem të thjeshtë taksash me norma të ulëta, i cili nuk diskriminon investitorët e huaj kundrejt atyre vendas dhe që ka norma taksash korporate të ngjashme me ato në vendet kryesore eksportuese. Megjithatë, çështja e taksave nuk është aq e rëndësishme në procesin e vendimmarrjes së investitorëve. Arsyeja për këtë

ishte se këta investitorë mund të investojnë si pasojë e oportuniteteve specifike që ata identifikojnë dhe se faktori i taksës nuk mund të konsiderohet si kritik, krahasuar me kthimet e siguruara nga investimi në këto tregje në zhvillim. Studiues të ndryshëm kanë arritur në konkluzione krejtësisht të kundërta në lidhje me ndikimin e taksave mbi IHD-të hyrëse. Norma taksash korporatash relativisht të larta ushtrojnë presion negativ mbi fitimin, duke ndikuar kështu negativisht mbi IHD-të hyrëse në Evropën Lindore dhe atë Qendrore. Megjithatë, vlera e efektit si pasojë e normës së taksës është relativisht e vogël. Ky impakt i vogël vjen si pasojë e faktit se ne nuk marrim në konsideratë regjimin special të taksave të hartuara me qëllim thithjen e IHD-ve, që do të thotë se IHD-të do të influenconin bilancin e pagesave si dhe punësimin. Duke u bërë burim financiar, manaxherial, si dhe teknologjik, investitorët e huaj do të ndikonin gjithashtu në ristrukturimin korporativ të sipërmarrjeve dikur në pronësi të shtetit. Megjithatë, me plot bindje mund të themi se ekzistenca e një sistemi fiskal joshtrëngues dhe liberal, do të japë patjetër frytet e tij në promovimin e IHD-ve në vend, pasi investitorët do të kishin një arsye më tepër për të investuar, nga ku edhe marzhi i fitimit do të jetë më i lartë.

4. Zhvillimi i Infrastrukturës

Udhëheqësit politikë pohojnë se një sistem më bashkëkohor transporti nevojitet në mënyrë që të mbështetet rritja ekonomike, si dhe investimet vendase apo të huaja. Në qoftë se do t'i referoheshim Broadman-it dhe Recanatini-it (2000, 2002), kushtet ekonomike nuk janë faktorët e vetëm që duhen marrë në konsideratë nga investitorët potencialë. Zhvillimi i infrastrukturës së një rajoni është gjithashtu po aq i rëndësishëm, duke qenë se ai përcakton se sa e vështirë dhe e shtrenjtë njëkohësisht mund të jetë

marrëdhënia me furnitorët dhe shpërndarja në tregje të ndryshme. Sa më i zhvilluar të jetë sistemi rrugor i një rajoni, aq më i lehtë është dhe aksesimi i tregjeve dhe aq më të ulëta janë kostot e transportit, dhe për rrjedhojë aq më të mëdha janë iniciativat për të investuar në atë rajon. Kjo marrëdhënie intuitive gjithsesi është mjaft e vështirë të matet duke qenë se infrastruktura fizike është aktualisht multidimensionale nga rrugët tek telekomi, tek hekurudhat, tek portet detare, e kështu me radhë. Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor, në terma të cilësisë së konstruksionit, është inferiore në qoftë se do të krahasohej me standardet evropiane. Një tjetër problem ende shqetësues për vendin tonë mbetet pamjaftueshmëria në ujë të pijshëm, i cili mbetet i pamjaftueshëm për shumicën e qyteteve shqiptare. Gjithashtu, edhe shërbimi i telekomunikacionit vetëm vitet e fundit është përmirësuar disi, duke reduktuar kështu shpejtësinë dhe saktësinë e komunikacionit dhe vendimet e manaxhimit të biznesit. Duke ju referuar të gjitha problemeve infrastrukturore të sipërpërmendura theksojmë se këto probleme janë një barrierë shtesë në përthithjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

5. *Korrupsioni*

Çështja e korrupsionit është një nga temat më të nxehta të ditëve të sotme. Shqipëria vijon të shënojë rekorde negative të nivelit të korrupsionit. *Transperancy International* në publikimin e raportit të indeksit të perceptimit të korrupsionit për vitin 2013, citon që Shqipëria ka shënuar regres duke zbritur tre vende më poshtë në krahasim me një vit më parë. Sipas TIA-s, në listën prej 177 shtetesh, Shqipëria renditet në vendin 116 nga vendi i 113 që ishte një vit më parë, ndërsa Kosova renditet në vendin e 111. Në këtë situatë, *Transperancy International* apelon për rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike, pavarësinë e institucioneve dhe hetim pa kompromis të

procedurave korruptive. Sipas *Transperancy International* (organizatë botërore e shoqërisë civile që drejton luftën kundër korrupsionit) është rritur edhe treguesi i perceptimit të korrupsionit. Shumë kërkues, të cilët hulumtojnë mbi këtë çështje, janë mjaft skeptikë për sa i përket sinqeritetit të bisedave në lidhje me korrupsionin. Madje në shumë studime të të intervistuarve apo opinionistëve është thënë se informacioni do të mbetet konfidencial dhe rëndësi do të ketë rezultati. Nga ana tjetër, shumë nga investorët që janë pyetur kanë treguar se në shumë fusha të procedurave specifike gjatë fillimit dhe zhvillimit të një biznesi ka trajtime të njëanshme dhe arbitrare. Kostot e larta, duke përfshirë këtu edhe "pagesat jo zyrtare" të shpeshta, kanë bërë që të rritet shumë korrupsioni në vend. Dobësia nga e cila karakterizohet operimi i sistemit rregullator administrativ, si për shembull, ushtrimi i gjykimeve të shumta të njëanshme dhe mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies, i hap rrugën praktikave të korrupsionit. Ndikimi i këtyre faktorëve në tërheqjen e IHD-ve është shumë i ndjeshëm.

6. *Konkurrenca e padrejtë*

Mania e fitimeve maksimale për një kohë minimale sollën konkurrencë të pandershme në të gjithë sferën e biznesit. Monitorimi sistematik realizuar në Shqipëri nga organizata të ndryshme jo-qeveritare, administrata shtetërore, apo institucione ndërkombëtare financiare konkludojnë se pothuajse të gjitha subjektet punojnë me pasqyra financiare të dyfishta, duke u përpjekur të prezantojnë të ardhura sa më të ulëta, në mënyrë që të shmangin sa të munden detyrimet fiskale. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, këto evazione fiskale shkojnë deri në 60 për qind. Konkurrenca e padrejtë vihet re sidomos në sektorin e ndërtimeve, ku mjaft kompani ndërtimi të palicensuara vendosin çmime më të ulëta se kompanitë e licensuara. Këto të fundit janë të detyruara të fshehin

fitimet e tyre reale ose të zëvendësojnë materialet cilësore të shtrenjta me më të lira në qoftë se duan t'i shpëtojnë konkurrencës së pandershme. Një tjetër aspekt ku konkurrenca e pandershme vihet re është procesi i privatizimit. Vihet re se janë bërë mjaft zhvlerësime, duke filluar nga objektet më të thjeshta si për shembull magazina dhe seksione të vogla punishtesh deri tek fabrikat, uzinat apo njësi të tëra industriale.

Në qoftë se do t'i referoheshim parimit që “prona e çdokujt është prona e askujt”, mund të themi se vlera të konsiderueshme të ekonomisë shqiptare u shitën me çmime ekstremalisht minimale, duke varfëruar ekonominë në tërësi. Për rrjedhojë, buxheti i shtetit nuk përfitoi sasinë e saktë monetare. Nëpunësit e shtetit të të gjitha niveleve ishin në qendër të këtij procesi spekulativ dhe nuk gjykuan nisur nga vlerësimi ekonomik, por mbi bazë të shpërblimeve personale financiare që morën apo prisnin të merrnin në të ardhmen për zhvlerësimin artificial të objekteve që ata kishin nën përgjegjësi. U krijua një ide e përgjithshme se, çdo gjë që e kishte burimin nga e shkuara, ishte e pavlerë dhe duhej filluar nga fillimi dhe se paratë duhet të vinin nga Europa. Në këtë mënyrë u krijuan artificialisht lehtësira politike dhe morale për komisionerët e ankandëve që vlerësonin dhe shisnin pasurinë e shtetit sipas vullnetit të tyre. Një tjetër aspekt i konkurrencës së pandershme ishte dhe rishitja me çmim normal të pronësisë, blerë përmes letrave me vlerë mjaft lirë. Zhvillimet ekonomike në Shqipëri drejt ekonomisë së tregut sollën nga njëra anë krijimin e disa kompanive që performuan një emër të mirë në treg, si pasojë e të mirave dhe shërbimeve cilësore që ofronin dhe nga ana tjetër lulëzimin e konkurrencës së pandershme. Forma kryesore e konkurrencës së pandershme mbetet falsifikimi i produkteve të importit apo produkteve vendase me emër të mirë në treg, duke i dhënë emrin e tyre produkteve pirate.

Gjatë ushtrimit të kësaj praktike, humbësit janë:

- ✓ Konsumatorët, të cilët paguajnë për cilësi të pamërituar dhe të panjohur.
- ✓ Prodhuesit e ndershëm, të cilët kanë kosto më të lartë pasi përballen me presionet e tregut.
- ✓ Dhe sigurisht, shteti, i cili nuk mbledh sasinë e saktë të taksave.

Pirateria e produkteve mbetet një nga faktorët kryesorë që deformon tregun dhe ushqen konkurrencën e pandershme.

Pirateria është më agresive në industrinë ushqimore dhe sidomos në: pijet alkoolike, birrat, ujin, lëngjet e frutave dhe industrinë e lehtë, konfeksionet, industrinë e këpucëve etj. Një tjetër formë piraterie është dhe prodhimi nga prodhues të palicensuar. Në Shqipëri është aprovuar ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe është ngritur një autoritet për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, mangësia e strukturave të nevojshme institucionale bëjnë që ky problem të vazhdojë. Faktet e sipërpërmendura në lidhje me konkurrencën e pandershme reduktojnë oportunitetet për Investimet e Huaja në Shqipëri.

4.3. Profili i IHD-ve në Shqipëri

Duke filluar nga viti 1991, progres i qëndrueshëm u realizua në tranzicionin e vendit për të kaluar nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi tregu, duke përfshirë liberalizimin, privatizimin dhe reformat bankare. Megjithatë, progresi ekonomik nuk u mbështet nga reforma institucionale, institucionet shtetërore mbetën të dobëta dhe sektori financiar nuk u zhvillua mjaftueshëm. Vështirësi u hasën në zhvillimin e tregjeve informale jo-financiare, sidomos me vendosjen e skemave piramidale të investimit që ofronin norma interesi të larta, të cilat u përmbysën në 1997-ën dhe

shpunë në një periudhë paqëndrueshmërie ekstreme, humbje private të mëdha dhe konflikte civile. Investimet e Huaja Direkte u ulën me 50 për qind, në krahasim me ecurinë më të mirë gjatë viteve 1995-1996. Pas vitit 1997, qeveria e re, e mbështetur edhe nga organizmat ndërkombëtare si FMN-ja dhe Banka Botërore, zbatoi një program antikrizë, si dhe thelloi më tej reformat strukturore, veçanërisht në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Sipas raportit të FMN-së (2005), ecuria e përgjithshme makroekonomike e ekonomisë shqiptare që nga viti 1997 ka qenë e mirë. Stabilizimi ekonomik, i vëzhguar në 1998-ën, u pasua nga një fluks i madh kosovarësh në 1999-ën. Kjo ngjarje u pasua me rënie të IHD-ve në gjithë rajonin.

Kjo analizë e thjeshtë tregon se vështirësitë e Shqipërisë në ruajtjen e imazhit të një mjedisi të qëndrueshëm politik, kanë qenë një pengesë e madhe për shumë investitorë të huaj që të investojnë në Shqipëri. Me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare për rikonstruksionet ekonomike, theksi u vu në ristrukturimin e bankave, nxitjen e IHD-ve dhe përshpejtimin e procesit të privatizimit.

Ekziston dhe vazhdimisht është krijuar një besim i përgjithshëm se Investimet e Huaja Direkte do të kenë një impakt shumë pozitiv në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke i sjellë vendit kapital, teknologji të reja, standarde perëndimore, si dhe eksperiencë manaxhimi dhe marketingu mjaft të përparuara nga vendet e zhvilluara perëndimore. Në të njëjtën kohë, të gjithë inputet e sipërpërmendur do të ndihmojnë në ristrukturimin e ekonomisë, duke sjellë kërkesë të re shtesë për asetet e ekonomisë, përshpejtimin e procesit të privatizimit, ofrimin e mundësive të reja të punësimit, do të nxisin rritjen e eksporteve duke përmirësuar kështu dhe bilancin e pagesave etj. Pra, flukset e IHD-ve vazhdojnë të jenë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht

për zhvillimin ekonomik. Në njëfarë mënyre, politikat nxitëse të IHD-ve në Shqipëri do të bëjnë që ekonomia shqiptare të ecë me ritme më të shpejta përpara.

Periudha 1992-2000 ka pasur luhatje për sa i përket thithjes së IHD-ve dhe kjo për shkak të situatës jo-stabile ekonomike dhe politike të vendit. Në këtë periudhë, IHD-të vazhduan të jenë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Edhe nga pikëpamja e bilancit të pagesave, flukset e IHD-ve kanë qenë faktor dominues të ecurisë së llogarisë kapitale e financiare, duke ndikuar ndjeshëm në finacimin e deficitit koherent. Nivelet e IHD-ve në vite kanë qenë të luhatshme duke mbetur nën nivelin e vendeve të tjera me zhvillim me të qëndrueshëm (UNCTAD, 2010).

Të dhënat e analizuara tregojnë se gjatë periudhës 1992-2012, vendet e Evropës Juglindore, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, kanë përfituar nga flukset e kapitalit të huaj, në mënyrë jo stabile dhe mjaft të kufizuar. Flukset kryesore të IHD-ve kanë qenë të lidhura më së shumti me privatizimet. Kapitali i huaj është investuar në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti. Për sa i përket Shqipërisë, kjo periudhë është shoqëruar nga një numër krizash, duke patur ndikim në flukset hyrëse të IHD-ve dhe në rritjen ekonomike. Tabela e mëposhtme tregon kategoritë e ndryshme të IHD-ve në Shqipëri për periudhën 1992-2012.

Tabela 17: Kategoritë ndryshme të IHD-ve në Shqipëri, 1992-2012.

Vitet	Fluksi hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë	Fluksi hyrës i IHD-ve, si % e PPB-së	Stoku hyrës i IHD-ve, në milionë dollarë	Stoku hyrës i IHD-ve, si % e PPB-së	Fluksi dalës i IHD-ve, në milionë dollarë	Stoku dalës i IHD-ve, në milionë dollarë
1992	20.00	1.3	20.00	1.27	0.0	0.00
1993	68.00	3.9	88.00	4.99	0.0	0.00
1994	52.97	2.7	140.97	7.23	0.0	0.00
1995	70.05	2.8	211.02	8.51	0.0	0.00
1996	90.09	2.7	301.11	9.08	0.0	0.00
1997	47.54	2.0	348.65	15.00	0.0	0.00
1998	45.01	1.7	393.67	14.49	0.0	0.00
1999	41.20	1.2	434.89	12.70	0.0	0.00
2000	144.27	4.0	246.80	6.78	0.0	0.00
2001	206.43	5.1	326.98	8.04	0.0	0.00
2002	135.00	3.0	360.25	8.11	0.0	0.00
2003	178.03	3.1	482.88	8.48	0.0	0.00
2004	345.67	4.7	836.63	11.45	13.7	24.59
2005	264.34	3.2	1020.44	12.51	4.1	20.59
2006	324.42	3.6	1392.04	15.48	10.4	37.77
2007	658.51	6.2	2693.32	25.17	23.9	74.59
2008	974.33	7.5	2868.50	22.09	81.1	145.70
2009	995.93	8.2	3257.83	26.95	39.2	166.72
2010	1050.71	8.9	3254.94	27.67	6.4	153.92
2011	876.27	6.9	4399.13	34.61	29.8	172.28
2012	855.44	7.1	4621.53	38.37	22.8	194.18

Burimi: UNCTAD, 2014.

Niveli i IHD-ve në Shqipëri gjatë viteve të fundit, në krahasim me burimet e tjera, ka qenë një burim shumë i rëndësishëm i kapitalit të huaj për financimin e deficitit koherent. Heqja e barrierave administrative ndaj këtyre investimeve, si dhe vendosja e një kuadri ligjor liberal, kanë krijuar një klimë më të favorshme për investimet.

Fokusi për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare do të mbetet në tërheqjen e IHD-ve me një vëmendje në sektorë ku ekonomia shqiptare ka potenciale të pashfrytëzuara, si në aspektin e burimeve natyrore, ashtu edhe në zhvillimin e sektorëve të pazhvilluara, si: turizmi, energjia, bujqësia, agrobiznesi, infrastruktura dhe shërbimet. Sektori i IHD-ve në Shqipëri përfaqëson kryesisht sektorin privat dhe ka kontribuar fuqishëm në terma të rritjes së PBB-së dhe punësimit. Por, si në çdo vend tjetër në tranzicion, ky kontribut do të ishte më i madh në qoftë se do të lehtësoheshin sadopak barrierat me të cilat përballlet ky fenomen. Me qëllim përmbushjen e objektivave të mësipërm, lind nevoja e hartimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm në mbështetje të IHD-ve, si dhe garantimi i një stabiliteti institucional e politik. Një rritje e IHD-ve do të shërbejë si promotor i besimit të investitorëve vendas në biznes, si dhe do të ushtrojë presion në stafin menaxherial të bizneseve për një performancë të lartë. Një rritje në nivelin e IHD-ve do të asistojë hapjen e ekonomisë së vendit dhe do të ndihmojë gjithashtu në tregtimin e aseteve vendase në nivel global. Kjo do të thotë që në periudha afatgjata, Shqipëria do të konsiderohet si një mundësi e barabartë investimi krahasuar me vendet e tjera në terma të avantazheve konkurruese dhe në shumë sektorë të ekonomive të tyre. Kjo është dhe arsyeja pse IHD-të konsiderohen si guri i themelit jo vetëm për një ekonomi të brendshme më të shëndetshme, por gjithashtu për promovimin e avantazheve konkurruese në nivel ndërkombëtar.

Pavarësisht hyrjeve të shumta të IHD-ve në rajon, pjesa e IHD-ve hyrëse në vendet në tranzicion ka qenë më e vogël krahasuar me vende të tjera në zhvillim të rajoneve të tjera. Arsyet kryesore që shpjegojnë këto shifra janë: korrupsioni, kuadri ligjor, burokracia, sistemi fiskal dhe destabiliteti politik. Ekziston një besim i përgjithshëm se institucionet e mira mund të luajnë një rol kyç mediatik në përthithjen e IHD-ve. Por duket që situata është krejt ndryshe po t'i referohemi vitit 2008.

Krahasuar me ekonomitë në tranzicion në mbarë botën, Shqipëria mban rekord, pas Armenisë, në rritjen e IHD-së në vitin 2008, duke shënuar 45 për qind rritje në Investimet e Huaja Direkte (Raport i Investimeve Botërore, UNSTAD, 2009). Parë nga këndvështrimi i investitorit, argumentohet fakti se IHD-të nuk janë një aset fizik i firmës, por thjesht një pasiv i tij. Investitorët e huaj mund të ruajnë fitimet e tyre dhe të mbrojnë vlerën e aktiveve të tyre ose thjesht të spekulojnë përmes huamarrjes në monedhë vendase dhe vënies në garanci të kapitalit fizik si kolateral. Sikurse sugjeron dhe përvoja, IHD-të nuk hyjnë në një vend, në momentet kur vendi ka nevojë më shumë se kurrë për to, pra kur situata ekonomike është keq. Kushtet për të bërë biznes fitimprurës duhet të jenë të dukshme dhe të prekshme. Në të kundërt, IHD-të tentojnë të fokusohen në një segment mjaft të ngushtë të ekonomisë, ku kthimi mbi kapitalin është vërtet i shpejtë.

Shqipëria ofron mundësi të mëdha për tërheqjen e investitorëve të huaj. Pozicioni gjeografik, burimet natyrore të pashfrytëzuara, kostoja e ulët e fuqisë punëtore, e tokës dhe e lëndëve të para, popullsia e re dhe e edukuar që është gati për punë, konkurrenca e ulët, tregtia liberale dhe kuadri ligjor i përshtatshëm janë garanci për sukses të investitorëve të huaj. Me vendosjen e saj strategjike në Ballkanin Perëndimor, me një ekonomi tregu në zhvillim, me një fuqi punëtore të re, dinamike, të arsimuar dhe me

kosto konkurruese krahasuar me rajonin. Burimet e saj natyrore përfshijnë kapacitete të konsiderueshme për sa i përket energjisë hidrike, diellore dhe të erës. Toka e saj pjellore ofron mundësi investimesh në bujqësi, po ashtu edhe bregdeti i saj prej më shumë se 400 km ofron një potencial të shkëlqyer për investime në turizëm. Shqipëria është e pasur edhe me minerale të çmueshme, si: bakër, hekur, krom etj., potenciale këto që shërbejnë për investorët e huaj, por është e rëndësishme të theksojmë faktin se ajo ka nevojë të përmirësojë ndjeshëm performancën e saj. Mundësi ekzistojnë, gjithashtu, në sektorët që s'kanë lidhje me përpunimin e lëndëve të para.

Megjithatë, këto avantazhe nuk janë shfrytëzuar si duhet për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe ekonomike të vendit. Investorëve të huaj që vijnë në Shqipëri iu ofrohet trajtim i veçantë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit Ekonomik (AIDA), e themeluar në gusht të 1998-ës, vepron si një vendqëndrim për investorët potencialë dhe është përgjegjëse për nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Ajo siguron informacion në mundësitë e investimit dhe këshilla ligjore për investorët e huaj potencialë, i ndihmon ata të identifikojnë partnerët e sipërmarrjeve private dhe të implementojnë projekte. Gjithashtu, AIDA është një agjenci shtetërore e specializuar në ofrimin e informacionit dhe shërbimit mbi mundësitë e investimit apo zhvillimit të biznesit ndaj investorëve vendas dhe të huaj. Kjo agjenci ofron mbështetje edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme apo për ndërmarrjet eksportuese, në mënyrë që ato të bëhen konkurruese në tregun vendas dhe të huaj. Sipas Ligjit nr.7764, datë 02.11.1993, "Për Investimet e Huaja", të huajt kanë të drejtë të angazhohen në aktivitete ekonomike pa nevojën për të kërkuar leje apo autorizim paraprak. Ato lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që iu njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me

përfashtim të pronësisë mbi tokën, e cila rregullohet me ligj të veçantë. Investitorët gëzojnë mbrojtje ligjore të të drejtave të tyre të lidhura me një investim dhe kanë të drejtën të transferojnë fitimet dhe të riatdhesojnë çdo kapital të investuar. Për rregullimin e mbrojtjes mjedisore, një licensë mjedisi është e nevojshme nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për firmat e angazhuara në aktivitete industriale. Në rastin e shqetësimeve civile si pasojë e trazirave politike, mbrojtja ndaj humbjes në sektorët privatë, ofrohet nga Agjencia e Garancisë Shqiptare, një korporatë e njohur me ligj dhe e themeluar nga Banka Botërore.

Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe integrimi në BE përbëjnë prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Vendet që kërkojnë të anëtarësohen në BE duhet të respektojnë dhe promovojnë vlera demokratike, duke përmbushur kriteret e vendit anëtar, si:

Politike, duhet të ketë institucione të qëndrueshme, të cilat garantojnë demokracinë, rregullat ligjore, të drejtat e njeriut dhe respektimin e minoriteteve.

Ekonomike, duhet të ketë ekonomi tregu funksionale dhe të jetë në gjendje të përballojë presionet konkurruese të tregut global.

Juridike, duhet të pranojë ligjet dhe praktikat e vendosura nga institucionet e BE-së, veçanërisht qëllimet kryesore politike, ekonomike dhe të bashkimit monetar.

Politikat kryesore të vendit gjatë viteve të fundit kanë sjellë si rezultat një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kushte të përmirësuara për zhvillimin e biznesit dhe për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte. Falë progresit në lidhje me shdërrimet ekonomike dhe një mjedisi mbështetës të jashtëm, rritja ekonomike mbeti e shëndoshë gjatë periudhës 2000-2009. Shqipëria siguroi një rritje mesatare vjetore të PBB-së në nivelin 6 për qind gjatë kësaj periudhe. Ngadalësimi i ekonomisë gjatë viteve 2010-2011 në Shqipëri ishte më pak serioz, krahasuar me vendet e tjera të rajonit (UNSTAD,

2010). Shqipëria ka zbatuar një kuadër të favorshëm politikash për Investimet e Huaja Direkte, ndërsa kohët e fundit ka ndërmarrë politika të tjera për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në përgjithësi. Gjithashtu, po ndërmerren masa për përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit.

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë ofron një treg potencial të konsiderueshëm, sidomos lidhja me tregjet e tjera të Europës - është e kufizuar nga Greqia në jug dhe nga Italia në perëndim. Kostot e tokave dhe të punës janë të ulëta, popullsia e re dhe e edukuar është gati për punë, tarifatat dhe kufizimet e tjera ligjore janë të ulëta në shumë raste dhe mund të shkojnë deri në eliminim. Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) që nga viti 2000, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me të gjitha vendet e Ballkanit ka krijuar mundësinë për tregti në rajon. Rritja ekonomike e Shqipërisë vitet e fundit në terma realë është llogaritur afërsisht në 5-6 për qind. Edhe në 2007-ën, rritja ekonomike ka qëndruar në 6%, duke u mbështetur nga një performancë e përmirësuar, rritje e lartë në industri, dhe nga një rritje e konsiderueshme në eksporte dhe në investime të huaja direkte. Rritja është mbështetur nga përmirësimet në infrastrukturë, risitë teknologjike në sektorë të ndryshëm dhe gjithashtu zhvillimet në kapacitetet njerëzore. Sektori bankar është tërësisht i privatizuar. Disa nga bankat më të njohura ndërkombëtare që operojnë në treg përfshijnë Raiffeisen International, Societe Generale, San Paolo dhe Banka Kombëtare Tregtare. Prezenca dhe forca e tyre në sektorin bankar i ka dhënë një shtysë financimit në ekonomi. Burimet natyrore që ofron Shqipëria janë të shumta dhe përfshijnë: naftën, gazin, qymyrgurin, hekurin, bakrin, kromin, ujin dhe potencialin elektro-energjetik.

4.4. Trendi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me vendet e EJT-së

dhe tendencat globale

Zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe integrimi në BE përbëjnë prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Politikat kryesore të vendit gjatë viteve të fundit kanë sjellë një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kushte të përmirësuara për zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte. Falë këtij progresi, rritja ekonomike mbeti e shëndoshë gjatë periudhës 2000-2009. Shqipëria siguroi një rritje vjetore mesatare të PBB-së në nivelin 6 për qind. Në këtë progres të ekonomisë është i pazëvendësueshëm roli i IHD-ve. Edhe gjatë periudhës 2009-2011, ekonomia shqiptare njohu rritje ekonomike pozitive, pavarësisht rënies nga kriza financiare dhe recensionit ekonomik i vendeve të tjera evropiane dhe nga rënia që shoqëroi eksportet shqiptare dhe remitancat. Faktikisht, gjatë kësaj periudhe, Shqipëria shënoi si mesatare një nga nivelet më të larta të ritmit të rritjes në Europë. Argumenti për këtë rezultat të rëndësishëm ka qenë mungesa e përforsimit për ribalancim të detyruar të deficitit të llogarisë korente dhe deficitit fiskal. Të dy këta deficite janë të lartë në krahasim me ato të ekonomive të tjera evropiane, por prurjet e kapitalit të huaj janë të kënaqshme, një pjesë e madhe e të cilit kanë qenë Investimet Huaja Direkte. Ndikimi i krizës ndërkombëtare financiare dhe ekonomike mbi Shqipërinë u pengua edhe nga rëndësia e kufizuar që kishte kanali i eksporteve për të transmetuar krizën në vend, por edhe nga varësia relativisht modeste e Shqipërisë nga tregjet ndërkombëtare financiare. Ndër efektet stabilizuese mund të përmendim gjithashtu kuadrin e politikave monetare, mbikëqyrjen e kujdesshme të sektorit bankar dhe kursin fleksibël të këmbimit. Në vitin 2009, ekonomia shqiptare njohu një rritje ekonomike prej 3.3 për qind. Disbalancat e huaja financiare nuk e

kufizuan rritjen ekonomike për shkak se financimi i një deficiti të madh të llogarisë korente mund të arrihej në një shkallë të madhe përmes shtimit të fluksit të IHD-ve nga privatizimet. Efektet pozitive të privatizimit dhe IHD-ve, garantuan një stimul pozitiv të aktivitetit ekonomik. Prurjet e IHD-ve në Evropën Juglindore ndoqën tendencën globale, duke shënuar kulmin në vitin 2007. Megjithatë, fluksi i IHD-ve në Shqipëri u zhvillua pothuajse në mënyrë të pavarur nga tendencat globale dhe rajonale, duke dëshmuar një rritje të vazhdueshme që zgjati deri në vitin 2010. Në vitin 2005, prurjet e IHD-ve ishin në vlerën 213 milionë euro dhe në vitin 2006 kapën shifrën e 258 milionë euro, duke kulmuar në vitin 2007 me 481 milionë euro (tabela në vijim). Në vitet 2007-2008, Investimet e Huaja Direkte kanë shënuar rritje të vazhdueshme në terma nominal. Në vitin 2009, Shqipëria përfitoi 717 milionë euro Investime të Huaja Direkte (sipas të dhënave të rishikuara nga Banka e Shqipërisë), ndërsa në vitin 2010 prurjet e IHD-ve arritën në 793 milionë euro.

Pavarësisht se rritja ishte e moderuar, kishte rëndësi duke parë që shumica e vendeve evropiane pësuan rënie të fluksit të IHD-ve në vendet e tyre, për shkak të krizës financiare. Në vitin 2010, Shqipëria renditej e dyta, pas Serbisë, për sa i përket sasisë së prurjeve të IHD-ve midis vendeve të Evropës Juglindore.

Në vitin 2011, si rritja ekonomike, ashtu edhe Investimet e Huaja Direkte u ngadalësuan, por pavarësisht nga një rënie që shkonte përkundër tendencës globale dhe rajonale, prurjet e Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri në vitin 2011 ishin më të larta se të vitit 2009. Në vitin 2011, kjo shifër shkoi në 742 milionë euro (tabela në vijim). Në këto rrethana sfiduese merr edhe më shumë rëndësi fakti i ndërmarrjes nga ana e qeverisë shqiptare i politikave ekonomike në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të IHD-ve në vend. Për sa i përket këtyre të fundit, synimi është thithja e një

numri më të madh investimesh të reja të huaja direkte, si dhe IHD-të në industritë që prodhojnë për eksport, ata që përmirësojnë infrastrukturën ekonomike dhe ata që kontribuojnë në rritjen e nivelit teknologjik të vendit. Një qasje liberale ndaj pronësisë së tokës për personat juridikë të regjistruar në Shqipëri, qofshin ata vendas apo të huaj, u mundëson investitorëve krijimin e bizneseve në këtë sektor. Në këtë mënyrë, bujqësia dhe produktet ushqimore mund të kontribuojnë gjithnjë e më shumë në eksportet, duke ulur varësinë nga importet (UNSTAD, Raporti i IHD-ve, 2011).

Tabela 18: Fluksi i IHD-ve në Shqipëri, në raport me nivelin e IHD-ve në Evropën Juglindore dhe nivelin global të IHD-ve (mil. euro).


Ekonomitë pritëse	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Bota	782,673	1,164,682	1,534,682	1,208,931	802,041	936,640	1,085,24
Evropa Juglindore	3,870	7,885	9,384	8,663	5,446	3,109	4,745
Shqipëria	213	259	481	665	717	793	742

Burimi: UNCTAD, WIR11 dhe Global Investment Trends Monitor No.8 dhe Banka e Shqipërisë.

Gjithsesi, pesha e Shqipërisë, si vend pritës i IHD-ve në rajonin e Evropës Juglindore, është rritur ndjeshëm në veçanti gjatë viteve 2007-2010, ku prurjet e IHD-ve në Evropën Juglindore pësuan rënie, ndërsa ato drejt Shqipërisë vazhdonin të rriteshin (tabela 18).

Rënia e Investimeve të Huaja Direkte në vitin 2011 solli edhe rënien në përqindjen e tyre në Shqipëri, si nga pikëpamja globale dhe rajonale.

Figura 4: Fluksi i IHD-ve në Shqipëri në krahasim me vendet e EJT-së, 1990-2011(në milionë dollarë).



Burimi: Sipas të dhënave të UNSTAD, dhe atyre të Bankës së Shqipërisë.

Ndonëse vlera e prurjeve të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri është modeste për shkak të madhësisë së vogël të ekonomisë së saj, rëndësia relative për ekonominë shqiptare është disi e lartë. Raporti i prurjeve të IHD-ve, si përqindje e formimit bruto të kapitalit fiks (GFCF), u rrit nga më pak se 10 për qind në vitin 2006, në 25 për qind në vitin 2009, duke arritur në nivelin 33 për qind në vitin 2010 (tabela 19). Ky kapërcim i madh në vitin 2010 nuk ishte vetëm rezultat i rritjes së Investimeve të Huaja Direkte, por edhe pasojë e një rënieje të ndjeshme në GFCF. Në vitin 2011, kur Investimet e Huaja Direkte shënuan rënie dhe GFCF-ja u rikuperua, raporti i të dyve shkoi sërish në 25 për qind. Në vitin 2010, midis vendeve të rajonit të Evropës Juglindore, vetëm Mali i Zi ka thithur më shumë Investime të Huaja Direkte përkundëjt GFCF-së¹. Sidoqoftë,

¹GFCF i referohet inicialit në gjuhën angleze, për Gross Fixed Capital Formation, që do të thotë, formimi i përgjithshëm i kapitalit fiks.


kjo rritje e madhe në vitin 2010 e fluksit hyrës të IHD-ve, si përqindje e kapitalit fiks, nuk ishte vetëm rezultat i rritjes së Investimeve të Huaja Direkte, por edhe pasojë e një rënies të ndjeshme të kapitalit fiks të formuar në Shqipëri.

Tabela 19: Prurjet e IHD-ve si përqindje e GCFC-së, vendet e Evropës Juglindore, 2004–2013.

Rajoni	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	12.7	8.8	9.3	15.9	20.8	25	33	25	21.8	29.3
Bosnja	20.3	11.5	19.1	46.7	19.8	6.5	12.5	13.2	10.1	8.9
Kroacia			0.9	7.4	11.6	16.5	24.9	31.7	31.2	22.0
Mali i Zi					55.6	137.8	87.6	67.3	82.6	55.1
Serbia					26.0	25.9	20.2	33.5	5.3	13.6
Maqedonia	33.8	9.7	37.4	43.3	28.4	10.8	11.9	21.9	4.2	14.2
EJL, Mesatare	11.1	5.0	11.1	18.9	27.0	36.7	31.0	31.3	25.9	23.9

Burimi: UNCTAD, 2014, tabelat e aneksit.

Figura 5: Mesatare e fluksit hyrës të IHD-ve në vendet e EJL-së, 2004-2013.



Burimi: UNCTAD, 2014; baza e të dhënave për IHD/TNC, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Gjatë viteve të fundit vlen të theksohet se Investimet e Huaja Direkte dalëse shqiptare drejt vendeve të tjera kanë qenë modeste në nivelin e 9 milionë euro në vitin 2010 dhe 30 milionë euro në vitin 2011, tabela në vijim. Investimet e Huaja Direkte dalëse nga Shqipëria kanë qenë më shumë në vendet fqinje, si Kosovë dhe Maqedoni.


Tabela 20: Flukset hyrëse dhe dalëse të IHD-ve në Shqipëri, 1994-2013.

Viti	Stoku hyrës i IHD-ve	Stoku dalës i IHD-ve	Fluksi hyrës i IHD-ve	Fluksi dalës i IHD-ve
1994	140.97	0.00	52.97	0.00
1995	211.02	0.00	70.05	0.00
1996	301.11	0.00	90.09	0.00
1997	348.65	0.00	47.54	0.00
1998	393.67	0.00	45.01	0.00
1999	434.89	0.00	41.20	0.00
2000	246.80	0.00	144.27	0.00
2001	326.98	0.00	206.43	0.00
2002	360.25	0.00	135.00	0.00
2003	482.88	0.00	178.03	0.00
2004	836.63	24.59	345.67	13.66
2005	1020.44	20.59	264.34	4.10
2006	1392.04	37.77	324.42	10.39
2007	2693.32	74.59	658.51	23.88
2008	2868.50	145.70	974.33	81.14
2009	3257.83	166.72	995.93	39.20
2010	3254.94	153.92	1050.71	6.38
2011	4399.13	172.28	876.27	29.78
2012	4621.53	194.18	855.44	22.77
2013	6103.54	244.26	1225.49	39.76

Shënim: Stoku hyrës dhe dalës i IHD-ve në Shqipëri, për periudhën 1994-2013, është i vlerësuar me çmimet aktuale dhe kursin aktual të këmbimit, në milionë dollarë amerikanë.

Burimi: UNSTAD, 2014.


Figura 6: Stoku hyrës dhe dalës i IHD-ve në Shqipëri, 2004-2013.



Burimi: UNSTAD, 2014.

Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri kanë ushqyer rritjen ekonomike përmes projekteve në infrastrukturë dhe shërbime, por një rënie e madhe mund të sjellë edhe rënie të rritjes ekonomike dhe mund ta bëjë vendin më të ekspozuar nga krizat e jashtme financiare. Sidoqoftë, kjo rritje e madhe në vitin 2010 e fluksit hyrës të IHD-ve, si përqindje e kapitalit fiks, nuk ishte vetëm rezultat i rritjes së Investimeve të Huaja Direkte, por edhe pasojë e një rënieje të ndjeshme të kapitalit fiks të formuar në Shqipëri.

Figura 7: Flukset hyrëse dhe dalëse të IHD-ve në Shqipëri, 2004-2013.



Burimi: UNSTAD, 2014.

Politikat e viteve të fundit të Qeverisë Shqiptare kanë rezultuar në një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kanë sjellë një përmirësim dhe lehtësim të kushteve për bërjen e biznesit dhe thithjen e Investimeve të Huaja Direkte. Shqipëria pozicionohet relativisht lart në renditjen globale të bazuar në Indeksin e Performancës së Investimeve të Huaja Direkte Hyrëse të UNCTAD-it, i cili mat masën relative të IHD-ve që një vend merr në raport me madhësinë e ekonomisë së tij.

Në vitin 2010, Shqipëria renditej në vendin e 18-të midis 141 vendeve, duke shënuar një ngritje të ndjeshme nga vendi i 68-të, që mbante në vitin 2005 (UNSTAD, 2014). Kjo pozitë e përmirësuar reflekton një klimë biznesi më miqësor ndaj investitorëve dhe më shumë mundësi të ofruara përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Megjithatë masat e marra, Shqipëria ka nevojë të bëjë përmirësime të mëtejshme në kuadrin ligjor, në infrastrukturë dhe në potencialin e saj të Investimeve të Huaja Direkte nëse dëshiron të rrisë më tej investime të tilla.

4.5. Aspekte kryesore të stokut të Investimeve të Huaja Direkte

4.5.1. Karakteristikat e prurjeve të IHD-ve, sipas formës


Investimet e Huaja Direkte mund të marrin formën e kapitalit aksioner, fitime të riinvestuara dhe formave të tjera të kapitalit, duke mbuluar kryesisht huatë nga kompania mëmë. Duke qenë se Shqipëria është në fazat fillestare të përhithjes së Investimeve të Huaja Direkte, pjesa dërrmuese e tyre (afërsisht 80 për qind në vitin 2010 dhe akoma edhe më shumë në vitin 2011) ishin në formën e kapitalit aksioner në biznese të reja, si edhe si shtesa kapitali në sipërmarrjet ekzistuese me investime të huaja (tabela në vijim). Fitimet e riinvestuara përfaqësojnë afërsisht 20 për qind të investimeve hyrëse, ndërsa Investimet e Huaja Direkte në forma të tjera kapitali (kryesisht huatë brenda kompanive) janë zakonisht të papërfillshme dhe në vitet 2009 dhe 2011 ishin negative. Shkëmbimi i kredive midis kompanive me marrëdhënie të investimit të huaj, zakonisht ndodh kur kompania mëmë është në situatë të vështirë financiare, siç mund të kishte qenë rasti me investitorët grekë në Shqipëri.

Tabela 21: Investimet e Huaja Direkte sipas formës, 2006-2011.

Komponentet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
IHD - Total	259	481	665	717	793	742
Kapital aksionar	199	487	420	516	600	755
Fitime te riinvestuara	0	0	182	229	186	64
Kapital tjetër	60	-6	63	-27	7	-77

Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Figura 8: IHD-të sipas formës, 2006-2011.



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Të ardhurat e investorëve të huaj në Shqipëri arritën në 81 milionë euro në vitin 2011, duke pësuar rënie nga shifra 288 milionë euro që ishte në vitin 2010. Kjo rënie mund të shpjegohet me njëfarë përkeqësimi në mjedisin e biznesit, si për shembull, ulja e kërkesës së brendshme. Fitimet e investorëve të huaj u korrespondojnë mbi 10 për qind të stokut të IHD-ve të viteve të mëparshme (tabela në vijim). Në vitet 2008 dhe 2009, investorët në Shqipëri realizuan nivele të larta të ardhurash, ndër më të lartat midis vendeve të Evropës Juglindore. Midis vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të reja anëtare të BE-së nga Evropa Qendrore dhe Lindore, ia kalonin vetëm Republika Çeke dhe Estonia. Të dyja këto vende kanë projekte më të maturuara të Investimeve të Huaja Direkte, që zakonisht kanë më shumë kapacitete për të siguruar të ardhura sesa projektet e reja.

Nga të ardhurat e realizuara nga Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, 79 për qind e tyre u investua përsëri në vitin 2011, duke shënuar një rritje nga 65 për qind që ishte në

vitin 2010. Kjo vlerësohet si shifër e lartë nga krahasimet ndërkombëtare dhe përfaqëson një tjetër karakteristikë tjetër të IHD-ve në Shqipëri.

Tabela 22: Pagesat e të ardhurave nga IHD-të hyrëse dhe fitimet e riinvestuara në Shqipëri, 2008-2011 (në milionë euro).

Treguesit	2008	2009	2010	2011
Të ardhura nga IHD-të	197	321	288	81
Të ardhura nga kapitali	10	91	94	14
Të ardhura nga fitime të riinvestuara	182	229	186	64
Të ardhura të tjera	6	1	8	4
Stoku i IHD-ve	2040	2233	2640	-
Të ardhura nga IHD-hyrëse si % kundrejt stokut të IHD-ve	9.7	14.4	10.9	-
Fitime të riinvestuara si % të IHD-ve	92.4	71.3	64.6	79.0

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2012.

4.5.2. Investimet e Huaja Direkte, sipas aktivitetit ekonomik

Investitorët e huaj hyjnë në një vend në formën e investimeve në biznese të reja apo bashkime dhe blerje ndërkufitare (M&A). Sipas të dhënave të përpiluara nga UNCTAD-i, gjatë periudhës 2007-2013, numri i projekteve të reja në Shqipëri ishte 70. Gjithsesi, duhet theksuar se dyqane të veçanta të një rrjeti supermarketesh apo degë lokale të një

banke tregtare shfaqen si projekte të veçanta investimesh (tabela në vijim). Viti me numrin më të madh të projekteve të reja ishte 2008 dhe periudha me numrin më të ulët të projekteve të reja ishte 2009-2011. Rrjedhimisht mund të vihet re një rënie e numrit të projekteve të reja gjatë viteve të krizës globale. Gjithashtu, për sa i takon vlerës së projekteve dhe numrit të vendeve të ardhshme të punës, angazhimet më të mëdha shfaqen gjatë viteve 2006–2008, ndërsa u siguruan sasi shumë të vogla gjatë dy viteve në vijim, të pasuara nga një rikuperim i lehtë në vitin 2011. Numri më i madh i projekteve të reja nisi fillimisht në sektorët e shitjes dhe marketingut, i ndjekur me sektorët e transportit dhe shërbime të tjera biznesi.

Tabela 23: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas aktivitetit ekonomik (milionë euro).

Aktiviteti	2007	%	2008	%	2009	%	2010	%	2011	%	2012	%	2013	%
A	6	0.3	19	0.9	6	0.3	7	0.3	4	0.1	2	0.1	2	0.1
B	0	-	2	0.1	3	0.1	2	0.1	4	0.1	0	-	0	-
C	10	0.5	29	1.4	147	6.5	311	12.8	612	18.0	810	24.8	732	25.6
D	218	11.9	363	17.6	352	15.6	378	15.5	431	12.7	388	11.9	184	-6.4
E	10	0.5	18	0.9	95	4.2	118	4.8	247	7.3	9	0.3	-33	-1.2
F	132	7.2	196	9.5	189	8.4	-1	0.0	11	0.3	78	2.4	84	2.9
G	99	5.4	271	13.1	253	11.2	240	9.9	217	6.4	153	4.7	137	4.8
H	94	5.1	94	4.6	79	3.5	76	3.1	70	2.1	64	2.0	64	2.2
I	590	32.2	383	18.6	357	15.8	400	16.4	389	11.4	437	13.4	785	27.5
J	588	32.1	548	26.6	614	27.2	700	28.7	715	21.0	753	23.1	780	27.3
K	57	3.1	25	1.2	42	1.9	63	2.6	83	2.4	85	2.6	307	10.8
L	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
M	2	0.1	3	0.1	3	0.1	4	0.2	6	0.2	8	0.2	10	0.4
N	0	-	26	1.3	48	2.1	64	2.6	47	1.4	37	1.1	33	1.2
O	13	0.7	8	0.4	9	0.4	12	0.5	9	0.3	18	0.6	17	0.6
P	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Q	0	0	0	0	10	0.4	24	1.0	36	1.1	46	1.4	60	2.1
R	10	0.5	76	3.7	56	2.5	38	1.6	521	15.3	374	11.5	61	2.1
S	1,830	100.0	2,061	100.0	2,261	100.0	2,436	100.0	3,400	100.0	3,262	100.0	2,854	100.0

Shënim: Radhitja alfabetike nga A në Q u referohet aktiviteve ekonomike, në të cilët janë të fokusuar IHD-të. A-Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura; B-Peshkimi; C-Industria nxjerrëse; D-Industria përpunuese; E- Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të ngrohtë; F- Ndërtimi; G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; H- Hotele dhe restorantet; I-Transportet, magazinimi dhe komunikacioni, J- Ndërmjetësimi monetar dhe financiar; K-Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete profesionale; L-Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar, M-Arsimi; N-Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale, O-Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual; Shërbime në shtëpi, Q-Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë; R-Të tjera industri; S-Totali i IHD-ve.


Tabela paraqet stokun vjetor të investimeve të huaja direkte në Shqipëri sipas aktivitetit ekonomik. Zërat janë të shprehur në milionë euro. Në publikimin e datës 30 shtator 2014, paraqiten të dhënat e rishikuara për vitin 2012.

Burimi: Banka e Shqipërisë, sektori i statistikave, 2014, llogaritje personale.

Në përgjithësi, numri më i madh i projekteve të investimeve ishte në sektorin e shërbimeve. Sasitë më të mëdha të fondeve për investime ishin në fushat e energjetikës dhe të prodhimit të materialeve të ndërtimit. Shpërndarja e projekteve sipas kategorive/grupeve tregon se numri më i madh i tyre është në fushat energjetike, ndërtim dhe tregtinë me pakicë. Raportohen katër projekte në fushën ushqimore, të pijeve dhe atë të duhanit, por asnjë në bujqësi. Investitori më i madh, me sasinë më të madhe të fondeve të investuara në projekte të reja është kompania e çimentos Titan Cement, një kompani greke, e cila çeli fabrikën e dytë në vitin 2011. Një tjetër investitor i madh është firma e ndërtimit Moncada Costruzioni (*Moncada Energy Group*) nga Italia. Dyqanit ushqimor italian, të tipit kooperativë, iu shtua një konkurrent në sektorin e pakicës, kompania franceze Carrefour.

Rreth 29 për qind e projekteve të reja të Investimeve të Huaja Direkte vijnë nga Italia, 7 për qind nga Shtetet e Bashkuara, 6 për qind nga Greqia, Turqia dhe Italia veçmas. Projekti më i madh i ri i shpallur në vitin 2010 ishte projekti Hidroelektra Niskogradnja nga Kroacia, në sektorin e ndërtimit. Projekte më të vogla në fushën e shërbimeve erdhën nga Austria, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia. Në sektorin e naftës u shpallën dy projekte të reja, një nga kompanitë e kërkim-zhvillimit, Sonoro nga Kanadaja dhe një tjetër nga një kompani zvicerane, që ndërton tubacione.

Figura 9: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas aktivitetit ekonomik, për vitin 2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2014; llogaritje personale.

Futja e Investimeve të Huaja Direkte (Burimi METE) përmes blerjeve ndërkufitare (crossborder M&A) në një ekonomi në tranzicion, si ajo shqiptare, zakonisht ndodh përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Ka patur një prurje të madhe Investimesh të Huaja Direkte në Shqipëri përmes procesit të privatizimit, duke përfshirë privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në një numër industrish, si edhe përmes privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha në industritë strategjike (si për shembull, bankat, telekomunikacionet dhe energjetika), të cilat kanë futur në lojë TNC-të. Ka qenë kryesisht privatizimi i ndërmarrjeve të industrive strategjike që ka siguruar prurje të larta të Investimeve të Huaja Direkte gjatë disa viteve.

Gjatë viteve 2004-2008, 24 për qind e gjithë IHD-ve ishin rezultat i privatizimeve; në vitin 2009, kjo përqindje arriti deri në 26 për qind (sipas të dhënave të BSH-së dhe ato të METE-së, si dhe të Ministrisë së Financave për prurjet e IHD-ve nga privatizimet). Gjatë viteve 2010 dhe 2011 nuk pati asnjë marrëveshje të re privatizimi. Përbërja e IHD-ve sipas sektorëve ekonomik pësoi disa ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës

2006-201, periudhë për të cilën kemi të dhëna. Fillimisht, pati një rritje të shpejtë të IHD-ve në industri.

Më pas, pjesa më e madhe e Investimeve të Huaja Direkte shkuan në sektorin e shërbimeve, kryesisht në pjesën e ndërmjetësimit financiar. Niveli i lartë i IHD-ve në shërbimet financiare në vitin 2008 ishte rezultat i blerjes së aksioneve të Bankës Popullore dhe Union Bank nga investitorë të huaj. Që nga ajo kohë, Investimet e Huaja Direkte në sektorin e ndërmjetësimit financiar kanë rënë, si pasojë edhe të krizës financiare evropiane. Lloji i IHD-ve që kanë hyrë në Shqipëri deri tani është përqëndruar kryesisht tek prodhimi i shërbimeve për tregun vendas. Por investime ka patur edhe në sektorin e industrisë së minierave dhe energjetikës, disa prej të cilave gjithashtu siguruan edhe eksporte. Nisur nga pikëpamja e bilancit të pagesave, për Shqipërinë do të ishte më mirë thithja e IHD-ve që gjenerojnë eksporte dhe shërbime, përveç tregut vendas.

Tabela 24: IHD-të hyrëse sipas projekteve, numri i investimeve dhe vlera e tyre.

Pozicioni	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Vlera e investimeve M&A, përmes blerjeve ndërkufitare, në Shqipëri, në milionë dollarë amerikanë	41	164	3	146	0	0	0	0
Numri i investimeve përmes blerjeve ndërkufitare, M & A, në Shqipëri	2	6	6	3	2	0	1	0
Vlera e investimeve në bazë të projekteve greenfield, në milionë dollarë amerikanë	446	454	505	124	68	525	288	57
Numri i investimeve në bazë të projekteve greenfield	10	8	16	7	6	8	11	4

Burimi: UNCTAD, 2014.

4.5.3. Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, sipas vendit të origjinës

Tabela në vijim raporton dinamikën hyrëse të stokut të IHD-ve në Shqipëri nisur nga vendet e origjinës. Mostra e vendeve origjinë të IHD-ve, për Shqipërinë, përbëhet nga shumica e vendeve, të cilët kanë investuar me së shumti në Shqipëri, përgjatë viteve nga 2007 në 2012. Është e rëndësishme të theksohet fakti që vendet e Bashkimit European përbëjnë vendet burimore kryesore të stokut të IHD-ve për Shqipërinë, me një normë të përqindjes së stokut të IHD-ve, në raport me nivelin global që sillet nga 62 deri në 80 për qind, përgjatë periudhës 2007-2012. Duke analizuar trendin e stokut të IHD-ve, sipas vendeve, investitorë më të mëdhenj për Shqipërinë, përgjatë periudhës së observuar 2007-2012, janë Greqia dhe Italia. Si zakonisht, në rastin e vendeve të vogla, Shqipëria e siguron një pjesë të madhe të IHD-ve të saj nga një vend fqinj, që në rastin konkret është Greqia. Në vitin 2007, Investimet e Huaja Direkte nga Greqia përbënin 28 për qind të stokut të IHD-ve, ndërsa vendin e dytë e zinin investimet me origjinë nga Italia, me rreth 12 për qind. Me fillimin e krizës ekonomike dhe financiare dhe intensifikimin e krizës së borxhit në Greqi, vihet re një rënie e peshës së stokut të IHD-ve të këtij vendi. Nga viti 2007 deri në vitin 2011, pesha e stokut të IHD-ve me origjinë greke shënoi rënie me 13 për qind, duke përfaqësuar në vitin 2011 rreth 15 për qind ndaj stokut total të IHD-ve. Kriza e thellë e borxheve greke që sfidoi stabilitetin financiar të kompanive dhe bankave më të mëdha ka gjasa të ketë luajtur rol këtu. Gjithashtu, kjo rënie shpjegohet edhe me faktin se investimet me origjinë greke janë të fokusuara në telekomunikacion dhe ndërmjetësim financiar, ku stoku i kapitalit ka pësuar rënie.

Vendi i dytë, si burim i IHD-ve, është Italia me 12 për qind të stokut të IHD-ve për vitin 2007. Investimet e Huaja Direkte me origjinë nga Italia pas një rritje të peshës së tyre në

vitin 2010, rreth 16 për qind, në vitin 2012 kanë pësuar rënie duke shënuar vlerën 4 për qind të totalit të stokut të IHD-ve. Investimet me origjinë italiane janë të fokusuara kryesisht në sektorë prodhues dhe ndërtim.

Ndonëse ato janë të pranishme edhe në sektorin e shërbimeve, kryesisht në ndërmjetësim financiar, financat mbeten të nënpërfaqësuar midis IHD-ve italiane në Shqipëri, në krahasim me IHD-të nga vende të tjera madhore investitore në sektorin e shërbimeve, kryesisht në sektorin financiar. Një dukuri e veçantë e stokut të IHD-ve me origjinë italiane është se ato përfaqësohen në Shqipëri me ndërmarrje të vogla e të mesme.

Austria është vendi i tretë më i rëndësishëm sipas burimit të stokut të IHD-ve, me 14 për qind në vitin 2010, me një rritje prej gjashtë pikë përqindjeje qysh nga viti 2007. Pothuajse të gjitha investimet austriake janë të përqëndruara në sektorin bankar, kryesisht si rezultat i blerjes së Bankës së Kursimeve të Shqipërisë nga kompania Raiffeisen International, që është banka më e madhe në Shqipëri, me 30 për qind të aseteve bankare të vendit (2009).

Në vitin 2010, sipas investimeve, në vendin e katërt renditej Kanadaja, kryesisht prej *Bankers Petroleum Ltd.*, një kompani me qendër në Kanada, e specializuar në kërkimet dhe prodhimin e naftës dhe gazit, që krijon rezerva të mëdha nafte dhe gazi në vend.

Rëndësia e investorëve turq gjithashtu ka ardhur në rritje, nga 8 për qind në vitin 2007 në 10 për qind në vitin 2009, ku vendin e IHD-ve greke e kanë zënë ato turke. Investitorët nga turqia janë të pranishëm në një numër aktivitetesh në Shqipëri. Investitorët gjermanë, holandezë dhe zviceranë, që zakonisht renditen mes pesë të parëve për nga rëndësia në vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, në Shqipëri luajnë një rol modest. Prania e tyre e kufizuar mund jetë për shkak të mungesës relative

të mundësive për investime nga ndërmarrje të teknologjisë së mesme dhe të avancuara. Për shkak të mungesës së stabilitetit financiar të ekonomive të burimeve kryesore të IHD-ve, në Shqipëri ndjehet nevoja e përpjekjeve për diversifikim ndaj burimeve të reja të IHD-ve.

Tabela 25: Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, në milionë euro.

Vendet origjinë të IHD-ve	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Emiratet e Bashkuara Arabe	3	8	16	17	10	-
Austri	147	186	221	354	444	387
Australi	0	0	0	0	0	1
Belgjikë	0	0	0	0	0	0
Bullgari	13	15	21	18	13	14
Kanada	1	8	102	270	529	705
Zvicër	14	137	108	68	544	394
Kinë	1	0	5	-1	-3	-5
Qipro	34	54	50	60	129	97
Çeki	-	0	55	-12	-15	-220
Gjermani	52	66	74	84	84	92
Egjipt	1	1	1	4	4	4
Spanjë	0	0	0	0	0	1
Francë	19	24	26	40	51	84
Mbretëria e Bashkuar	5	3	-5	-2	0	3
Greqi	521	566	560	601	507	767
Kroaci	1	2	3	11	17	13
Hungari	0	3	1	0	0	0
Izrael	2	3	3	3	1	1
Itali	220	321	348	387	427	125

Japoni	0	0	0	0	0	0
Kosovë	5	14	9	10	5	13
Kuvajt	90	84	71	71	9	5
Ishujt Kajman	0	0	0	-7	57	58
Liban	30	40	36	28	29	39
Luksemburg	0	0	0	0	0	5
Monako	1	4	4	2	0	0
Mali i Zi	-1	0	0	1	-2	0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	15	28	22	22	17	9
Holandë	274	188	207	223	253	297
Norvegji	0	0	5	13	19	21
Panama	0	0	0	0	0	1
Rumani	2	-1	0	0	0	0
Suedi	0	0	0	0	0	0
Slloveni	4	11	16	10	27	5
Turqi	154	190	235	187	188	235
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	72	75	24	-98	-47	36
Ishujt Virgin (Britanikë)	0	0	0	0	0	0
Serbi	0	0	0	7	8	7
Organizata Ndërkombëtare	22	25	35	46	54	64
Të tjera	127	5	8	21	39	3
Totali i IHD-ve	1,830	2,061	2,261	2,436	3,400	3,262

Shënim: Tabela paraqet stokun vjetor të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri sipas shteteve. Zërat janë të shprehur në milionë euro. Në publikimin e datës 30 shtator 2014, paraqiten të dhënat e rishikuara për vitin 2012.

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2014.

Rënia e IHD-ve greke solli ulje të përqindjes të vendeve të tjera anëtare të BE-së si pjesë e stokut të IHD-ve në Shqipëri, nga 80 për qind që ishin në 2006, në 67 për qind në vitin 2010, duke zënë vendin e IHD-ve greke ato turke (tabela në vijim).

Por Shqipëria mund të përfitojë gjithashtu edhe nga largimi eventual i kapitalit nga Greqia, në rast se kompanitë largohen nga Greqia, për shkak të uljes së kërkesës dhe rritjes së barrës tatimore.


Tabela 26: Prurjet e IHD-ve në Shqipëri, sipas grup-shteteve.

	2004	%	2005	%	2006	%	2007	%	2008	%	2009		2010	%	2011	%
Bota	843	100	1,001	100	1,387	100	2,964	100	2,868	100	3,257	100	3,564	100	3,928	100
Ekonomite e zhvilluara*.	721	86	827	83	1,162	84	2,034	69	2,317	81	2,626	81	2,905	82	3,290	84
Europa	680	81	789	79	1,112	80	1,924	65	2,197	77	2,440	75	2,500	70	2,557	65
Bashkimi European*	669	79	778	78	1,094	79	1,902	64	2,001	70	2,272	70	2,384	67	2,449	62
Ekonomitë në zhvillim*	60	7	102	10	125	9	411	14	450	16	524	16	537	15	431	11
Vendet e Europës Juglindore*	11	1	26	3	20	1	28	1	58	2	45	1	44	1	25	1
Të paspecifikuar	51	6	46	5	80	6	221	7	43	1	62	2	77	2	182	5

Shënim: Vendet në zhvillim përbëhen nga vendet Afrikane dhe Aziatike: Kina, Hong Kongu, Taiwan, Singapuri, Pakistani, Libia, Arabia Saudite dhe Republika Arabe e Sirisë, Vendet Latine (Beliza dhe Panama) dhe vende tjera të Karaibeve (Bahama, Ishujt e virgjër të Britanisë, Ishujt Cyman, Ishujt holandezë, Ishujt e virgjër të SHBA-së dhe Ishujt Cook). Ekonomitë e zhvilluara përfshijnë vendet e OECD-së. Bashkimi European përfshin të gjithë shtetet anëtare (BE-27) të Bashkimit European. Vendet e Evropës Juglindore përfshijnë: Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Në milionë dollarë.

Burimi: UNCTAD, 2014, dhe të dhëna të bazuara nga Banka e Shqipërisë.

Figura 10: Prurjet e IHD-ve në Shqipëri, sipas grup-shteteve, 2004-2011.



Burimi: UNCTAD, 2014, dhe të dhëna të bazuara nga Banka e Shqipërisë.

4.6. Mjedis i shqiptar dhe Investimet e Huaja Direkte

IHD-të në Shqipëri mundësojnë një sërë aktiviteteve ekonomike, të cilët potencialisht mund të ndikojnë në zhvillimet pozitive, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social. Disa nga ofertat që shteti shqiptar ofron për investitorët e huaj janë:

1. Potencial i lartë investimesh në sektorë prioritar

Tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte, sidomos në ata sektorë ku Shqipëria ka potenciale të pashfrytëzuar, do vazhdojë të mbetet prioritet për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë. Energjetika, turizmi, agrobiznesi, industria e minierave, ICT-ja janë sektorë prioritarë për investime në Shqipëri.

a. *Energjetika*

Qeveria po punon për zhvillimin e një strategjie afatgjatë, që synon krijimin e një sistemi elektroenergjetik operacional e të qëndrueshëm nga pikëpamja teknike dhe financiare, të aftë për të plotësuar nevojat e brendshme dhe për të eksportuar në një treg të integruar. Ndërtimi i kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë dhe i linjave të trasmetimit për të përballuar nevojat e brendshme për energji përbën prioritet për qeverinë shqiptare. Sipas Partneritetit për Energjinë e Rinovueshme dhe Efikasitetin, Shqipëria shfrytëzon vetëm 35 për qind të potencialit të saj.

Legjislacioni i harmonizuar me atë të BE-së parashikon këto lehtësira për investimet e nevojshme në sektorin e energjitik, në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe në rritjen e efikasitetit të energjisë:

- Investitorët që ndërtojnë hidrocentrale të rinj për prodhimin e energjisë, me kapacitet të instaluar mbi 5 MW, si dhe investitorët që janë përfshirë në rehabilitimin e një hidrocentrali ekzistues të prodhimit të energjisë me një kapacitet të instaluar prej më shumë se 5 MW, duke përdorur lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta, kanë të drejtë të përjashtohen nga detyrimet doganore për makineritë e importuara dhe pajisjet e përdorura në investimin kapital. Ata gjithashtu mund të rimbursohen për detyrimet doganore dhe akcizat e paguara për importin e lëndëve djegëse të lëngëta ose të ngurta, të përdorura në prodhimin e energjisë elektrike, në përputhje me ligjin nr. 8987, datë 24.12.2002, “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”.
- Përjashtim nga TVSH-ja për çimenton dhe hekurin e importuar për ndërtimin e HEC-eve.

- Tarifa të përcaktuara për blerjen e energjisë nga HEC-et dhe detyrimin e KESH-it për ta blerë për një periudhë 15-vjeçare

b) Turizmi

Sektori i turizmit në Shqipëri ka potenciale të mëdha dhe qeveria po bën përpjekje për ta stimuluar këtë sektor. Turizmi është një sektor strategjik dhe me përfitime si për investitorët, po ashtu edhe për vendasit. Shqipëria ka një bregdet të mrekullueshëm prej më shumë se 400 km, që përbën një potencial të shkëlqyer për investitorët e huaj, ka dhe një diversitet zonash malore në brendësi të territorit të përshtatshëm për turizëm. Turizmi mund të sigurojë në të ardhmen një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

c) Bujqësia dhe përpunimi i ushqimeve

Bujqësia është një nga sektorët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare që punëson rreth 44 për qind të krahut të punës dhe kontribuon 20 për qind në PBB-në. Ky sektor ka nevojë për investime dhe po përballlet me konkurrencën e mallrave që vijnë nga importi. Sfidë për këtë sektor përbëjnë madhësia e fermave, mungesa e bashkëpunimit midis prodhuesve dhe tregtarëve, përpunimi dhe paketimi i produkteve. Toka pjellore, klima e favorshme, punonjës të arsimuar dhe të motivuar, potenciali i lartë për eksport janë disa avantazhe për investitorët e huaj.

c) Sektori i minierave

Shqipëria është një vend i pasur me burime minerare. Kërkimi, shfrytëzimi dhe përpunimi përbëjnë mundësi për investitorët e huaj. Industria minerare është e privatizuar dhe qeveria nxit investimet e huaja në këtë sektor. Ndër projektet ekzistuese

mund të përmendim: kompania “Albanian Krome” Sh.p.k. (ACR), që operon në Bulqizë në minierën më të madhe të kromit dhe uzina e Ferokromit në Elbasan. Në një projekt të ri, kompania “Kurum Energy” (nëndegë e “Kurum Holding”) dhe “Sichuan Jiannanchun Internacional Group Ltd” (një grup i rëndësishëm kinez) kanë nënshkruar me qeverinë shqiptare një marrëveshje koncesionare për kërkimin dhe shfrytëzimin e depozitave të kromit në zonën e Kalimashit e në Vlahne dhe për ndërtimin e impianteve të pasurimit të bakrit në Shqipërinë e Veriut në prill të vitit 2010. Të drejtat koncesionare bënë të mundur kontratat e mësipërme.

d) ITC

Sektori i ITC-së po rritet me shpejtësi, duke u bërë një nga industritë më dinamike të vendit. Vitet e fundit, qeveria shqiptare ka liberalizuar legjislacionin për industrinë e telekomunikacioneve, duke e harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së për komunikacionin dhe duke nxitur konkurrencën. Në vitin 2007 u krijua Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (NAIS), e cila synon të përshpejtojë zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Rreth 80 për qind e shërbimeve në nivelin e qeverisjes qendrore janë të aksesueshme nëpërmjet internetit dhe më shumë se 50 për qind e shërbimeve për biznesin. Aksesit në telefoninë celulare është përmirësuar dhe tani renditet ndër më të mirët në rajon. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së konkurrencës përmes futjes së operatorëve të rinj në treg, si *Eagle Mobile* në vitin 2008 dhe *Plus Kommunikation* sh.a. në vitin 2010. Pavarësisht faktit që sektori shqiptar i ICT-ve ka marrë zhvillimin më të madh gjatë viteve të fundit, ende ka objektiva të tjera për t’u realizuar, si mbulimi me internet në të gjithë vendin dhe sigurimi i një rrjeti më të shpejtë dhe të sigurt. Duke patur parasysh që rrjetet dhe shërbimet mund të

kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e konkurrencës, një nga objektivat e qeverisë shqiptare është që shërbimet e internetit të shtrihen në të gjitha shkollat dhe institucionet publike.

2. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit dhe zhvillimi i procesit të integrit

Më 1 dhjetor 2006, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA), si një marrëveshje e ndërmjetme dhe një hap drejt integrit në BE. Shqipëria ka rreth 90 për qind të eksporteve që janë drejtuar drejt tregjeve të BE-së. Duhet pasur parasysh që indeksi i eksporteve është një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike, nga ana tjetër krijon një situatë të përshtatshme për tërheqjen e sa më shumë investitorëve të huaj në tregun shqiptar.

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë me vendet e ballkanit

Shqipëria është anëtare e OBT-së që nga viti 2000. Duke filluar nga viti 2004, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me një sërë vendesh të rajonit, si me IRJ-të të Maqedonisë, Kosovën, Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë dhe Republikën e Moldavisë. Marrëveshja për Tregtinë e Lirë (CEFTA) e vitit 2006 u nënshkrua nga të gjitha vendet e sipërpërmendura dhe ka qenë funksionale që nga nëntori i vitit 2007. Kjo marrëveshje reflekton një nivel më të lartë të hapjes së tregtisë dhe bashkëpunimit rajonal midis vendeve të rajonit. Politika e liberalizimit të tregtisë ka vazhduar me marrëveshjet e tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Turqisë, si dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA).

4. Kosto e ulët e punës

Shqipëria është një ndër të paktat vende të Ballkanit dhe të botës që ofron paga relativisht të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit, gjë që e bën joshës këtë vend për investorët e huaj. Pra, investorët e huaj mund të kryejnë investime të konsiderueshme në Shqipëri për aq kohë sa kostoja e punës, që zë një vend të konsiderueshëm në koston totale të produktit, është relativisht shumë e vogël krahasuar me vendet e tjera.

5. Fuqi punëtore e kualifikuar dhe fleksibile

Fuqia punëtore në Shqipëri është e përbërë nga më shumë se 2 milionë njerëz me një moshë mesatare rreth 29 vjeç, krahasuar me vende të tjera evropiane, p.sh në Itali mosha mesatare e punës është 40 vjeç. Një pjesë e mirë e personave nën 40 vjeç flasin të paktën 2 gjuhë të huaja, dhe një pjesë e mirë e tyre kanë studiuar në universitete perëndimore. Norma e papunësisë rreth 15% tregon që ka një treg pune, ndërkohë që ka shumë të diplomuar në shkenca sociale, në biznes dhe në çështjet ligjore. Ky është një nga faktorët që bën të mundur tërheqjen e një numri të madh investorësh të interesuar për të investuar në Shqipëri.

6. Njohja e Gjuhëve të Huaja

Pjesa më e madhe e shqiptarëve mësojnë greqisht dhe italisht që në fëmijëri. Gjenerata e re mëson rregullisht gjuhën angleze në sistemin arsimor shqiptar.

7. Një treg i orientuar dhe liberal për IHD-të

Të huajt kanë të drejtë të angazhohen në aktivitete ekonomike pa nevojën për të kërkuar leje apo autorizim paraprak. Ato lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që iu njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me përjashtim të pronësisë mbi tokën, e cila rregullohet me ligj të veçantë. Investitorët gëzojnë mbrojtje ligjore të të drejtave të tyre të lidhura me një investim dhe kanë të drejtën të transferojnë fitimet dhe të riatdhesojnë çdo kapital të investuar. Në rastin e shqetësimeve civile, si pasojë e trazirave politike, mbrojtja ndaj humbjes në sektorët privatë, ofrohet nga Agjencia e Garancisë Shqiptare, një korporatë e njohur me ligj dhe e themeluar, nga i cili garanton trajtim të njëjtë të investitorëve të huaj me ata shqiptarë.

8. Një pozicion gjeografik strategjik

Shqipëria është një vend evropian që ndodhet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit me një sipërfaqe prej 28.748 km katrorë. Ajo kufizohet në veri me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në lindje me Maqedoninë, në jug me Greqinë dhe në perëndim me Italinë. Ka një relief dhe klimë shumë të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë.

4.7. Politikat dhe masat pro rritjes së IHD-ve në Shqipëri

Investimet e Huaja Direkte zënë një vend të rëndësishëm në panoramën ekonomike të vendeve në zhvillim. Shumë vende kanë përfituar nga flukset e kapitalit në formën e IHD-ve. Duke luftuar mungesën e kapitalit nga e cila vuanin ekonomitë e mbyllura, ata kanë favorizuar përdorimin efikas të burimeve, si dhe kanë krijuar një mjedis

konkurrues dhe të favorshëm për investitorët e huaj. Shqipëria është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) që nga viti 1991, anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) që nga viti 2000, ndërkohë që Marrëveshje të Tregtisë së Lirë janë nënshkruar me shumë vende, duke krijuar mundësi për hyrje në një treg më të gjerë. Qeveria shqiptare ka zbatuar një sërë reformash strukturore duke përfshirë reformën e tokës, reformën e sitemit financiar, në fushën fiskale, administrative dhe ligjore, liberalizimin e çmimeve, privatizimin etj., me qëllim liberalizimin e tregtisë dhe lehtësisë së bërit biznes, si për investitorët vendas, ashtu edhe për ata të huajt. Gjithashtu, për krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj mund të përmendim këta elementë nxitës për investitorët e huaj:

1. Kuadër ligjor liberal për investimet e huaja

Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e klimës së investimeve përmes miratimit dhe zbatimit të një sërë ligjesh dhe rregulloresh, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Megjithatë, ka raste ku ligjet janë të paplota (mungojnë rregullat zbatuese) ose kanë përplasje me njëri-tjetrin dhe mund të krijojnë problem në zbatimin e ligjit dhe të rrisin pasigurinë e biznesit (Banka Botërore, 2010).

Në ligjin nr.7764, datë 2 nëntor 1993, “Për Investimet e Huaja” përcaktohet qartë se kush quhet “investitor i huaj” dhe çfarë quhet “investim i huaj”.

“Investitori huaj” nënkuptohet:

- a) Çdo person fizik që është shtetas i një vendi të huaj; ose
- b) Çdo person fizik që është shtetas i Republikës së Shqipërisë, por me banim të përhershëm jashtë vendit; ose

- c) Çdo person juridik që është themeluar sipas ligjit të një vendi të huaj, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi kërkon të kryejë ose është duke kryer një investim në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet e saj që i përkasin periudhës nga 31.07.1990 e në vijim.

Sipas këtij ligji, “investim i huaj” nënkuptohet çdo lloj investimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, të zotëruar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një investitor i huaj, i cili konsiston në:

- a) pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të prekshme dhe të paprekshme, ose ndonjë lloj tjetër të drejtë pasurore;
- b) një shoqëri, të drejta që rrjedhin nga çdo formë pjesëmarrjeje në një shoqëri, me aksione etj.;
- c) huatë, detyrimet në të holla ose detyrimet në një veprimtari që ka vlerë ekonomike dhe që lidhen me një investim;
- d) pasurinë intelektuale, duke përfshirë veprat letrare dhe artistike, tekniko-shkencore, regjistrimet e zërit, shpikjet, projektet industriale, skemat e qarqeve të integruara, markat tregtare, disenjot e markave tregtare dhe emrat tregtarë;
- e) çdo të drejtë të njohur me ligj ose kontrata, dhe çdo licensë ose leje të dhëna në përputhje me ligjet.

Po në këtë ligj saktësohet:

- a. Të gjithë sektorët janë të hapur për investimet e huaja dhe nuk ka nevojë për autorizim paraprak nga qeveria. Ato lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që u njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme.

- b. Në të gjitha rastet dhe në çdo kohë, investimet kanë trajtim të barabartë e të paanshëm, gëzojnë mbrojtje e siguri të lartë.
- c. Investitorët në Shqipëri gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga gjykata e të drejtave të tyre që lidhen me investimet e tyre. Palët në një debat mund të bien dakord të paraqesin mosmarrëveshjet tek një institucion arbitrazhi. Në rast të një dështimi të këtij arbitrazhi, investitorët e huaj gëzojnë të drejtën e ankimimit në gjykatë. Në rast të një mosmarrëveshje në lidhje me diskriminimin, transferimin e aseteve apo shpronësim indirekt të investimit të huaj nga qeveria, investitori ka të drejtën e tij ta parashtrojë kërkesën e vet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në lidhje me Investimet.
- d. Ndërmarrjet me kapital të huaj të regjistruara në Shqipëri si subjekte juridike u lejojnë të kenë në pronësi çfarëdolloj toke. Investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, me përjashtim të rasteve të veçanta me interes publik të përcaktuar me ligj, pa diskriminim, me kompensim të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv e në përputhje me procedurat ligjore.
- e. Një shoqëri me pjesëmarrje të investimeve të huaja ka të drejtë të punësojë edhe shtetas të huaj.
- f. Investitorëve të huaj, investimet e të cilëve pësojnë humbje si pasojë e luftës apo konflikteve të armatosura u jepet një trajtim jo më pak i favorshëm se sa ai që i bëhet investitorëve vendas.
- g. Fondet që lidhen me investimet e huaja mund të transferohen jashtë vendit, në një monedhë të konvertueshme që llogaritet me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transfertës.

- h. Nuk ka kufizim për sa i përket pjesës së investitorit të huaj në kompani, është i mundur zotërimi 100 për qind nga të huajt.
- i. Investitorët e huaj kanë të drejtën që të transferojnë jashtë vendit të gjitha fondet dhe kontributet në natyrë që kanë të bëjnë me një investim të huaj.
- j. Transferimi i fondeve mund të pengohet vetëm në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve apo mospagesës së taksave, si dhe vendimeve të gjykatës.
- k. Për investimet mbi 10 milionë euro shteti siguron mbrojtje ligjore.

2. *Trajtim më i favorshëm në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare*

Veç ligjit të mësipërm mund të përmendim edhe Ligjin nr. 9663, datë 18 Dhjetor 2006, “Për koncesionet”. Sipas këtij ligji, qeveria shqiptare mund të ofrojë koncesione për investitorët vendas ose ndërkombëtarë për çmimin simbolik 1 €. Në këto raste, prona shtetërore-asetet, burimet natyrore, aktivitetet ekonomike, mundësohen me një çmim prej 1 euro. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, vlera e kontratës së qirasë ose enfiteozës mund të përcaktohet me tarifën simbolike prej 1 euro, kur në këto pasuri shtetërore do të kryhen veprimtari prodhuese industriale në nivele investimi mbi dhjetë milionë euro ose kur kemi të bëjmë me zgjidhjen e problemeve ekonomike e sociale në zona të veçanta. Kushtet dhe kriteret e konkurrimit për këto kontrata përcaktohen, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. *Taksim i ndershëm*

- Taksimi i ndershëm do të përbëjë boshtin e politikës fiskale. Kush fiton më shumë do të kontribuojë më shumë.
- Sistemi i taksave në Shqipëri nuk bën dallim midis investorëve të huaj dhe atyre vendas.
- Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me shumë vende për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

4. *Thjeshtime administrative ndaj biznesit*

- *Regjistrimi i biznesit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)*

Që nga viti 2007, regjistrimi i biznesit bëhet brenda një dite në QKR për më pak se një euro dhe numri i hapave për të filluar një biznes është shkurtuar nga dhjetë në pesë. Brenda një dite, me një aplikim të vetëm, biznesi i ri mund të regjistrohet online për të plotësuar kërkesat që lidhen me tatimet, sigurimet shëndetësore dhe krahun e punës.

- *Procedura e Licensimit nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL)*

Procedurat e licensimit janë thjeshtuar shumë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë përmes krijimit të Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL), në korrik të vitit 2009.

Rrjedhimisht, shumë kërkesa për licensa janë hequr dhe shumë të tjera janë thjeshtuar në shumë sektorë të ekonomisë, duke përfshirë minierat, hidrokarburet, punët publike, shëndetësinë, bujqësinë dhe mjedisin.

- *Shërbimi online për deklarin dhe pagesat e taksave*

Lidhur me thjeshtimin e procedurave të bërjes biznes, është bërë progres në veprimtarinë e administratës publike. Gjatë vitit 2011 e në vazhdim, shërbimeve elektronike të ofruara nga administrata tatimore u është shtuar edhe deklarimi online i

punëtorëve të rinj, atyre të punësuar rishtazi dhe të larguarve nga puna, si dhe listëpagesa e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

5. *Sistemi tatimor*

Nëse procedurat tatimore janë të thjeshta, transparente dhe jodiskriminuese, ata janë të favorshëm për investitorët e huaj. Legjislacioni tatimor shqiptar nuk parashikon stimuj të veçantë për investitorët e huaj. Kompanitë e huaja, si edhe ato vendase përfitojnë njësoj nga stimujt tatimorë të ofruar nga ligje të ndryshme. Reforma tatimore ka ndikuar shumë modernizimin dhe përmirësimin e regjimit tatimor, ka përmirësuar pagesat dhe ka ulur evazionin fiskal. Politika tatimore është fokusuar në rritjen e bazës tatimore. Që nga viti 2007 e deri në vitin 2013, në Shqipëri është zbatuar taksa e sheshtë. Më pas po zbatohet taksa progresive. Megjithëse për këtë ka akoma debate se cila do të ishte më e mira të zbatohet për Shqipërinë. Gjithashtu, përmirësime janë bërë edhe në lidhje me kontributet për sigurimet shoqërore. Aktualisht ato janë 16,7 për qind, paguhen nga punëdhënësi dhe 11,2 për qind nga punëmarrësi. Për të parandaluar korrupsionin janë ngritur sisteme në administratën doganore e tatimore që kontrollojnë veprimtarinë e administratës, me qëllim që ajo të përafrohet me standardet evropiane. Megjithatë, mbetet sfida për qeverinë ulja e evazionit fiskal që ende mbetet e lartë.

6. *Prokurimet publike*

Prokurimet publike janë përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Me synimin e përmirësimit të efikasitetit dhe rritjes së transparencës, si dhe të sundimit të shtetit

ligjor, Shqipëria ka krijuar një sistem prokurimi elektronik që nga viti 2010. Ky sistem tashmë është për të gjitha vlerat që prokurohen.

7. Politika tregtare


Politika tregtare ka rëndësinë e duhur për integrimin e ekonomisë shqiptare në tregjet e vendeve rajonale të Evropës Juglindore. Shqipëria aplikon një regjim liberal tregu. Tregtia e jashtme është liberalizuar që në vitin 1991. Kjo mund të kompesojë faktin se Shqipëria është një vend me treg të vogël. Integrimi në tregjet rajonale nxitet nga politika që synojnë liberalizimin e tregtisë, mbështetja e eksporteve dhe nxitje e IHD-ve. Që me anëtarësimin në OBT, në shtator të vitit 2000, Shqipëria ka zbatuar liberalizimin e plotë të import-eksporteve të mallrave. Gjithashtu, qeveria shqiptare ka marrë masa dhe veprimtari që synojnë heqjen e barrierave tregtare ndaj tregtisë.

8. Kuadër ligjor për biznesin në përputhje me legjislacionin e BE-së

Shqipëria është anëtare e OBT-së që nga viti 2000. Më 1 dhjetor 2006, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA), si një marrëveshje e ndërmjetme dhe një hap drejt integritit në BE. Që nga viti 2004, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me një sërë vendesh të rajonit, si me IRJ të Maqedonisë, Kosovën, Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë dhe Republikën e Moldavisë. Marrëveshja për Tregtinë e Lirë (CEFTA) e vitit 2006 u nënshkrua nga të gjitha vendet e lartpërmendura dhe ka qenë funksionale që nga nëntori i vitit 2007. Kjo marrëveshje reflekton një nivel më të lartë të hapjes së tregtisë dhe bashkëpunimit rajonal midis vendeve të rajonit.

Politika e liberalizimit të tregtisë ka vazhduar me marrëveshjet e tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Turqisë, si dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA). Në vitin 2012, Shqipëria renditej në vendin e 82-të, sipas klasifikimit global të vendeve sipas lehtësisë së bërit biznes (Banka Botërore, raporti të bësh biznes, 2012). Shqipëria renditet në grupin e mesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përpara Italisë dhe Greqisë.

Figura 11: Lehtësia e të bërit biznes, në Shqipëri dhe vendet e përafërta, për vitet 2013 dhe 2014.



Burimi: Banka botërore, 2014. Llogaritje personale.

Tabela 27: Treguesi i lehtësisë së të bërit biznes në rajon, për vitet 2013 dhe 2014.

Vendet	Viti 2013	Viti 2014
Shqipëri	108	68
Maqedoni	31	30
Mali i Zi	42	36
Kroaci	67	65
Itali	52	56
Serbi	77	91
Greqi	65	61

Shënim: Indeksi i lehtësisë së të bërit biznes pasqyron rregullat më të përshtatshme të të bërit biznes. Në qoftë se një vend aplikon rregulla më të përshtatshme të të bërit biznes, indeksi i lehtësisë së të bërit biznes është i barabartë me 1.

Burimi: Banka Botërore, Indekse të Zhvillimit Botëror, 2014.

Për sa i përket dhjetë fushave kryesore që përfshihen në treguesit e bërjes biznes ekziston një diferencë e madhe, Shqipëria renditet më mirë në aspektin e mbrojtjes së investitorëve (16), marrja e kredive (24) dhe fillimit të një biznesi (61).

Por pozita e saj është më ulët në lidhje me regjistrimin e pronës (154) dhe akoma më e ulëta në rang global për sa i përket trajtimit të lejeve të ndërtimit (183).

Tabela 28: Treguesit e mjedisit të biznesit në Shqipëri, për vitet 2010-2014.

Treguesi	2010	2011	2012	2013	2014
Koha e nevojshme për forcim të kontratës (ditë)	390	390	450	525	525
Koha e nevojshme për marrje të energjisë elektrike (ditë)	177	177	177	177	177
Koha e nevojshme për të regjistruar pasurinë (ditë)	42	33	33	33	22
Koha e nevojshme për të filluar biznes (ditë)	6	5.5	4.5	4.5	4.5
Koha e nevojshme për të paguar taksat (orë)	360	371	357	357	357
Koha e nevojshme për të zgjidhur josolventitetet (vite)	2	2	2	2	2
Përqindja e taksës në profilin komercial	39.7	37.7	37.9	30.9	30.7
Numri i procedurave për të regjistruar pasuri	6	6	6	6	6
Numri i procedurav për të aplikuar kontratën	39	39	39	39	39
Treguesi	2010	2011	2012	2013	2014

Burimi: Banka Botërore, 2014.

9. *Krijimi i Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA)*

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve luan rolin e nxitjes së investimeve që nga viti 2011, duke u bërë një faktor i rëndësishëm për thithjen e IHD-ve në vend. Kjo agjenci ka këto detyra kryesore: të lehtësojë dhe mbështesë investimet direkte në Shqipëri, përmes identifikimit dhe nxitjes për investime, duke ofruar shërbime për investitorët ekzistues dhe ata potencialë; të rrisë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si dhe e teknologjive që ato përdorin, gjithashtu të nxisë eksportin e mallrave dhe shërbimeve përmes ofrimit të asistencës finaciare për kompanitë eksportuese. Agjencia kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësuar klimën e biznesit, duke ndihmuar kompanitë në aktivitetin e tyre, si edhe duke ndërmjetësuar me investitorët dhe autoritetet shtetërore.

Masat që mund të ndërmerren në Shqipëri në funksion të rritjes së IHD-ve

Duke patur parasysh problemet që ka Shqipëria në lidhje me mjedisin e biznesit, si dhe për ta bërë vendin tonë një vend tërheqës për investitorët e huaj, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash, ku në bazë qëndrojnë reformat rregullatore dhe politikat që synojnë zhvillimin e sektorit privat. Thelbi i masave konsiston:

1. Zhvillimi i veprimtarive me publikun e gjerë, komunitetin e biznesit, nivelet qeverisëse për të kuptuar rëndësinë e përfitimeve nga konkurrenca midis aktorëve kyç të tregut. Përfshirja në këto aktivitete edhe e komunitetit ndërkombëtar, me qëllim marrjen e eksperiencave mbi kulturën e konkurrencës.
2. Minimizimi i ekonomisë informale, duke mbështetur autoritetet shqiptare të konkurrencës, Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në luftën e tyre ndaj këtij fenomeni.
3. Hapja e sektorit financiar për konkurrencën (pas privatizimit të Bankës së Kursimeve edhe privatizimi i INSIG-ut; ngritja e një zyre për informacion mbi kreditë; zhvillimi dhe përforcimi i një organizmi përgjegjës për garancinë e risqeve për investitorët.
4. Zhvillimi i një rrjeti rajonal të autoriteteve dhe zyrtarëve që merren me rregullimin e konkurrencës, si dhe inkurajimi i ndarjes së eksperiencave midis njëri-tjetrit në rajon.
5. Inkurajimi dhe mbështetja e politikave për reformat në vend dhe rajon.

Përzgjedhja e Shqipërisë si një vend për të bërë biznes varet nga stabiliteti i politikave ekonomike, nga integriteti i qeverisë (ulja e korrupsionit, taksa të arsyeshme, rregullim i pronësisë mbi tokën, politika punësimi). Zbatimi i strategjive për nxitjen e investimeve të

huaja, ashtu si në çdo vend, edhe në Shqipëri, ndikohet nga krijimi i imazhit të vendit. Imazhi merr një rëndësi shumë të madhe, sidomos për një vend si Shqipëria, imazhi i së cilës tek investitorët e huaj është i perceptuar si më pak i favorshëm sesa ç'është në realitet.

Fushata e krijimit të imazhit pozitiv tek investuesit e huaj përfshin:

- a. Krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve publike me shtetet e synuara.
- b. Përfshirjen e informacioneve mbi Shqipërinë në publikime të huaja.
- c. Publicitetin përmes mediave të huaja.
- d. Shpërndarjen e botimeve periodike elektronike përmes internetit.
- e. Krijimin apo pjesëmarrjen në aktivitete të tjera, me qëllim vënien në opionencë ndaj përshtypjeve të këqija mbi Shqipërinë dhe ndërtimin e një imazhi pozitiv mbi vendin si një lokalitet i mundshëm për të investuar.

4.8 Pengesat për zhvillimin e IHD-ve në Shqipëri

Fatkeqësisht, edhe sot, në Shqipëri, veprojnë një sërë faktorësh ekonomik, politik dhe social, që disfavorizojnë zhvillimin në mënyrë të lartë të IHD-ve në Shqipëri. Këta faktorë i rendisim si më poshtë:

1. Ekzistenca e tregjeve të vogla lokale

Në përgjithësi, investitorët e huaj janë të lidhur kryesisht me tregjet e mëdha, të cilat ofrojnë edhe fitime të mëdha. Kështu që tregjet e brendshme të vogla shqiptare janë një ndër faktorët që kufizojnë futjen në masë të investimeve të huaja.

2. Privatizimi dhe ristrukturimi i kompanive

Procesi i privatizimit ka ndikuar në procesin e IHD-ve, por gjatë viteve të fundit është vërejtur njëfarë apatie në implementimin e këtij procesi, për arsye se akoma po zvarritet

procesi i privatizimit të INSIG-ut, dhe gjithashtu duhet marrë në konsideratë dështimi i privatizimit të Shpërndarësit të Energjisë Elektrike. Aktualisht, pjesa më e madhe e IHD-ve në Shqipëri janë fokusuar në fusha të tilla të shërbimit, si: sistemit bankar, telekomunikacioni dhe kompani të sigurimit.

3. *Legjislacioni shqiptar nuk parashikon stimuj të veçantë për investitorët e huaj*

Kompanitë e huaja njësor si ato vendase përfitojnë njësor nga stimujt që afrohen nga legjislacioni shqiptar. Stimujt rregullohen përmes Ligjit Nr.9374, datë 21 Prill 2005, “Për ndihmën shtetërore” dhe sipas amandamenteve të Ligjit Nr. 10183, datë 20 Tetor 2009, “për zbatimin e projekteve të rëndësishme”.

4. *Infrastruktura*

Infrastruktura e dobët, duke përfshirë transportin dhe komunikimin krijojnë pengesa për zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë në përgjithësi (Zoto, 2012). Rrjeti i rrugëve është një pengesë për zhvillimin e zonave turistike, aq më tepër që rrjeti hekurudhor pothuajse nuk funksionon. Megjithatë hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, përsëri ka shumë për të bërë, sepse ka zona të tjera me interes potencial për investitorët e huaj, siç është: turizmi, bujqësia, industria ushqimore etj. Këto janë pengesa që frenojnë rritjen e IHD-ve, për shkak të rritjes së kostos së madhe që shoqërojnë një sipërmarrje në Shqipëri.

5. *Probleme në gjetjen e zonave industriale*

Ka shumë faktorë të lidhur direkt me sistemin e të drejtës së pronësisë, si një ndër problemet kryesore për investitorët e huaj, ndër të cilët mund të përmendim: mungesa e dokumenteve të pronësisë, mbivendosje mbi tokën në fjalë dhe vendimeve të gjykatave. Procesi ende i papërfunduar i decentralizimit, vështirësitë në gjetjen e identifikimin e pronarëve të ligjshëm janë disa faktorë të tjerë me të cilët përballen investitorët e huaj.

Kjo bën që investorët e huaj të ndjehen të pasigurt që të investojnë pa pasur një siguri të tillë.

6. *Legjislacioni i punës dhe tregu informal i saj*

Investitorët e huaj janë më shumë të interesuar të investojnë në ato vende, të cilat kanë një legjislacion fleksibël të tregut të punës, sidomos për punësimin e shkarkimin nga puna të punonjësve. Po t'i referohemi Shqipërisë, investorët e huaj janë të tërhequr nga pagat e ulëta, por nga ana tjetër ekziston risku që forca punëtore nuk është shumë produktive, duke qenë se tregu i saj ka akoma informalitete që dëmtojnë ekonominë shqiptare.

7. *Politikat qeveritare në promovimin e IHD-ve*

ALB INVEST funksionon si një agjenci për nxitjen e IHD-ve në Shqipëri. Që prej disa vitesh ajo është përqëndruar në iniciativën qeveritare “Shqipëria 1 Euro”. Një iniciativë kjo që edhe sot e kësaj dite nuk është shumë e qartë në lidhje me arritjet dhe objektivat, nga ku akoma nuk janë ndjerë efektet e kësaj iniciative.

8. *Korrupsioni dhe informaliteti*

Korrupsioni dhe mungesa e përgjithshme e transparencës mbeten sfida të vazhdueshme për demokracinë dhe për sipërmarrjet shumëkombëshe që mund të investojnë në Shqipëri (Zoto, 2012). Korrupsioni është përkufizuar si shfrytëzimi i fuqisë publike për të përfituar fitime individuale. Korrupsioni dhe informaliteti ndikojnë shumë negativisht në integritetin e një vendi, në ekonominë e tij, ul konkurrencën e drejtë, eliminon funksionimin normal të tregut, gjeneron monopolet, si dhe ulje të ligjitimitetit të shtetit. Të gjitha këto shkaktojnë ulje të besimit të investorëve të huaj, e cila reflektohet në hyrjet relativisht të vogla të IHD-ve.

KAPITULLI V: FAKTORËT PËRCAKTUES TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI DHE ROLI I TYRE NË RRITJEN EKONOMIKE TË VENDIT

5.1. Hyrje

Rëndësia e Investimeve të Huaja Direkte qëndron në aftësinë e tyre për të rritur konkurrencën e mirëfilltë në tregun e vendit pritës të IHD-ve, e cila rezulton në korrigjim të ineficencave të tregjeve kombëtare. Ky efekt pozitiv në ekonominë nacionale të vendeve pritëse të IHD-ve motivon vendin pritës për të nxitur fluksin e IHD-ve në konkurrencë me vendet e tjera pritëse që shohin fitime të njëjta potenciale. IHD-të, si një prej formave të hyrjes së kapitalit të huaj, mund të ndihmojnë për të financuar nevojat në rritje për burime financiare të vendeve në zhvillim dhe për të lehtësuar transferimin e teknologjisë, si dhe aftësive menaxheriale nga vendet origjinë të IHD-ve në vendet pritëse të IHD-ve. Ky kapitull mbështetet në dy analiza empirike që lidhen me Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri. *Pjesa e parë e analizës empirike trajton faktorët përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri, duke shfrytëzuar të dhëna vjetore, për periudhën 1994-2010, të nivelit panel. Për trajtim të hipotezave të trajtuara në kapitullin e parë të punimit, pjesa e parë e kreut empirik mbështetet në modelin e gravitetit, që shpjegon faktorët përcaktues të flukseve të IHD-ve, nga 14 vende kyçe të Bashkimit Europian në Shqipëri. Pjesa e dytë e analizës empirike, duke përdorur testin Granger të shkakshmërise, trajton rolin e Investimeve të Huaja Direkte, në nivel fluksi dhe stoku, në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Pjesa e tretë e këtij kapitulli paraqet metodologjinë hulumtuese konkrete që është aplikuar në*

këtë studim, hipotezat, burimet e të dhënave dhe modelin ekonometrik. *Pjesa e katërt* diskuton rezultatet dhe *pjesa e pestë* përfundon studimin, duke nxjerrë politika rekomanduese për Shqipërinë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e IHD-ve për vendet e Evropës Juglindore, në pjesën e parë të këtij kapitulli analizohet procesi dhe politikat që kanë ndikim në vendimet e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri. Duke përdorur modelin e zgjeruar të gravitetit do të japin përgjigje për pyetjet kërkimore:

1. *A janë faktorët gjeografik, si madhësia e ekonomisë së vendeve shprehur përmes PBB-së dhe PBB-së për frymë, si dhe distanca ndërmjet vendeve respektive, faktorë të rëndësishëm të cilët shpjegojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?*
2. *A janë faktorët institucional, të mjedisit të biznesit apo të tranzicionit, faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?*

Bazuar në këto pyetje hulumtuese, punimi do të japë rekomandime nëse fluksi dhe madhësia e IHD-ve në Shqipëri nxitet nga faktorët kërkues të tregjeve apo faktorët kërkues të efikasitetit të ekonomisë shqiptare. Rezultatet e punimit do të na shërbejnë për të dhënë rekomandimet e nevojshme për politikbërësit shtetërorë për promovim dhe nxitje të IHD-ve në ekonominë shqiptare. Në këtë pjesë të këtij kreu analizohen faktorët përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri. Vende origjinë të IHD-ve konsiderohen 14 vende të zhvilluara të Bashkimit Evropian, për shkak të peshës specifike të këtyre vendeve në flukset dalëse të IHD-ve, në drejtim të ekonomisë shqiptare. Në këtë studim, vendet origjinë të IHD-ve konsiderohen: Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. Analiza empirike e punimit mbështetet në të dhëna vjetore bilaterale ndërmjet vendeve për periudhën: 1994-2010.

5.2. Modeli ekonometrik i gravitetit

Modeli që aplikohet në këtë studim bazohet në ligjin e Newton mbi tërheqjen gravitacionale, duke përfshirë në model variabla agregatë, të tranzicionit, të mjedisit të biznesit dhe institucional në ekuacionin (5.1). Forma e ekuacionit të gravitetit duket si më poshtë:

$$\ln IHD_{ijt} = a_{ij} + u_t + \beta_0 \ln PPB_{it-1} + \beta_1 \ln PPB_{jt-1} + \beta_2 \ln |PPBk_{it} - PPBk_{jt}| + \beta_3 D_{ijt} + \beta_4 \ln IHD_{ijt-1} \times \ln X_{jt-1} + \beta_5 \ln IHD_{ijt-1} \times \ln Y_{jt-1} + \beta_6 \ln IHD_{ijt-1} \times \ln Z_{jt-1} + \gamma + \delta + u_{ijt} \quad (5.1)$$

Ku i -ja paraqet vendet origjinë të IHD-ve², j -ja paraqet vendin pritës të IHD-ve, Shqipërinë, t -ja paraqet vitet për periudhën 1994-2010.

IHD_{ijt} tregon fluksin bilateral të hyrjeve të IHD-ve nga vendet origjinë i në vendin pritës j në kohën t , në milionë dollarë amerikanë.

PPB_{ijt} paraqet matësin e madhësisë së tregut, që përfaqësohen nga Produkti i Përgjithshëm Bruto, në milionë dollarë, në vendet origjinë i dhe vendin pritës të IHD-ve j .

Në model gjithashtu përfshijmë edhe variablën $|PPBk_{it} - PPBk_{jt}|$ që paraqet diferencën e Produktit të Përgjithshëm Bruto për frymë (PPB për frymë), ndërmjet vendeve origjinë dhe vendit pritës të IHD-ve në periudhën t . Kjo variabël është përfshirë në model për të konsideruar matjen e nivelit të të ardhurave (Campos dhe Kinoshita, 2003) dhe për arsye të korrigjimit të problemeve të korrelacionit serial dhe endogjenitetit ndërmjet PPB-së dhe PPB-së për kokë banori (Greene, 2013).

D_{ijt} është matës i distancës ndërmjet vendeve i (14 vende të BE-së) dhe j (Shqipërisë).

² Austri, Belgjikë, Danimarkë, Francë, Finlandë, Gjermani, Greqi, Irland, Itali, Holandë, Portugali, Spanjë, Suedi dhe Mbretëri e Bashkuar.

X_{jt} paraqet vektorin e të gjithë faktorëve institucional të Shqipërisë.

Y_{jt} qëndron për faktorët e tranzicionit dhe

Z_{jt} paraqet faktorët e mjedisit të biznesit.

Të gjithë këta faktorë institucionalë, të tranzicionit dhe të mjedisit të biznesit përfshihen në model në interaksion me variablën varëse të një periudhe më herët.

a_{ij} paraqet efektet specifike random të vendeve, ku përfshihen të gjithë faktorët e pavarur nga koha, si për shembull, distanca, përderisa u_t paraqet variablën fiktive të kohës, γ paraqet variablën fiktive për vendet nikoqir të IHD-ve dhe δ paraqet variablën fiktive të vendeve burimore.

u_{ijt} paraqet gabimin standard.

Modeli empirik (2) sugjeron që flukset bilaterale të IHD-ve nga vendet origjinë të Bashkimit Europian në Shqipëri janë në funksion të faktorëve të gravitetit (PPB, PPB për frymë, distanca), faktorëve institucional, faktorëve të tranzicionit dhe faktorëve të mjedisit të biznesit.

5.3. Testimi i hipotezave, analiza dhe diskutimi i rezultateve

Duke konsideruar modelin e zgjedhur për vlerësim të koeficientëve, feasible GLS dhe metodologjinë tobit me efekte të rastit, *vërejmë që variablat e gravitetit (PPB-së, PPB-së për frymë dhe distancës), janë statistikisht të rëndësishëm dhe me efekte pjesërisht të pritshme për flukset bilaterale të IHD-ve.* Nëse fokusohemi tek rezultatet e zgjedhura empirike të modelit GLS (kolona 4), koeficientët e vlerësuar interpretohen si vijon, duke dhënë përgjigje edhe për pyetjet kërkimore me anë të testimit të hipotezave:

Pyetja kërkimore 1:

A janë faktorët gjeografik, si madhësia e ekonomisë së vendeve shprehur përmes PBB-së dhe PBB-së për frymë, si dhe distanca ndërmjet vendeve respektive, faktorë të rëndësishëm të cilët shpjegojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?

Hipoteza 1:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto në vendet origjinë të Bashkimit European, është faktor i parëndësishëm në përcaktimin e flukseve të IHD-ve, nga vendet origjinë të BE-së në drejtim të Shqipërisë.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto në vendet origjinë të Bashkimit European, është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e flukseve të IHD-ve, nga vendet origjinë të BE-së në drejtim të Shqipërisë.

Përkundër pritjeve teorike, PPB-ja e vendit origjinë ka ndikim negativ në flukset bilaterale të IHD-ve nga BE-14 në Shqipëri, me elasticitet prej -0,158. Kështu që, 10 për qind rritje të nivelit të PPB-ve, në vendet origjinë të IHD-ve, të 14 vendeve të Bashkimit European, asocohet, mesatarisht me 1,58 për qind ulje të fluksit bilateral të IHD-ve nga vendet origjinë në Shqipëri. *Pra, Ha vërtetohet.*

Hipoteza 2:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto në Shqipëri, është faktor i parëndësishëm në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto në Shqipëri, është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Në anën tjetër, në përputhje me pritjen teorike, PPB-ja e vendit pritës të IHD-ve (Shqipërisë), është statistikisht i rëndësishëm dhe në relacion pozitiv me flukset bilaterale të IHD-ve nga 14 vende të Bashkimit European në Shqipëri. *Pra Ha, vërtetohet.*

Ky ndikim pozitiv i PPB-së së Shqipërisë në flukset bilaterale të IHD-ve, është me elasticitet prej 0,375, që do të thotë se 10 për qind rritje në nivelin e PPB-së në Shqipëri shoqërohet mesatarisht me 3,75 për qind rritje të fluksit bilateral të IHD-ve, nga vendet origjinë të Bashkimit European në Shqipëri.

Hipoteza 3:

Ho: Produkti i Përgjithshëm Bruto për frymë është i faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Produkti i Përgjithshëm Bruto për frymë është i faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Diferenca e PPB-së për frymë ndërmjet vendeve origjinë dhe pritës të IHD-ve, është statistikisht i rëndësishëm dhe ka ndikim negativ në flukset bilaterale të IHD-ve. 10 për qind rritje në diferencën e PPB-së për frymë ndërmjet vendeve të BE-14 dhe Shqipërisë, ndikon mesatarisht në 5.32 për qind ulje të fluksit bilateral të IHD-ve nga BE-14 në Shqipëri. Ky rezultat vërteton që divergjencat ekonomike ndërmjet 14 vendeve të Bashkimit European dhe Shqipërisë janë në pajtueshmëri me flukse të ulëta bilaterale të IHD-ve, nga 14 vende origjinë të Bashkimit European në drejtim të Shqipërisë. *Pra, Ha vërtetohet.* Ky rezultat edhe njëherë vërteton se Shqipëria duhet të përshpejtojë politikat ekonomike që kanë të bëjnë me konvergjencën ekonomike, që shoqërohet me përmirësim të nivelit të të ardhurave për kokë banori.

Hipoteza 4:

Ho: Distanca është faktor i parëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Distanca është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Koeficienti negativ dhe statistikisht i rëndësishëm i distancës vërteton se fluksi bilateral i IHD-ve varet nga faktorë të distancës. Kjo gjetje është në përputhje me literaturën teorike që sugjeron relacion negativ në mes distancës ndërmjet vendeve origjinë të IHD-ve dhe atyre pritës (Shqipërisë). Distanca e lartë ndërmjet vendeve origjinë dhe vendeve pritës të IHD-ve, rrit koston e transportit dhe sjell ulje në fluksin bilateral të IHD-ve. Nga rezultatet (kolona 4), rritja në distancë rrugore ndërmjet vendeve për 10 për qind, sjell ulje në aktivitetin e IHD-ve, mesatarisht, për 9,3 për qind. *Ha, vërtetohet.*

Pyetja kërkimore 2:

A janë faktorët e tranzicionit, të institucioneve apo të mjedisit të biznesit, faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri?

Hipoteza 1:

Ho: Progresi i tranzicionit është faktor i parëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Progresi i tranzicionit është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Treguesi i progresit të tranzicionit është faktor statistikisht i rëndësishëm në lidhje me flukset bilaterale të IHD-ve. Një periudhë më herët është vërtetuar të jetë në relacion negativ me flukset bilaterale të IHD-ve. Duke u fokusuar në kolonën 4,1 për qind rritje në progresin e reformave që lidhen me tranzicionin, ndikon mesatarisht në 3,25 për qind ulje të fluksit të IHD-ve, ndërmjet vendeve, duke mbajtur faktorët e tjerë konstant. *Pra, Ha vërtetohet.*

Ky interaksion vërteton që relacioni në mes nivelit të kaluar dhe nivelit potencial të IHD-ve në Shqipëri, varet nga progresi i tranzicionit që atribuohet, kryesisht zhvillimeve në sektorin privat, në institucionet financiare bankare dhe jobankare dhe institucionet e sigurisë. Ky rezultat, i vërtetuar në kundërshtim me pritjen teorike mund t'i atribuohet joeficiencës institucionale në drejtim të reformave të përgjithshme infrastrukturore, reformave në sistemin bankar, reformave në politikën tregtare dhe kursin e jashtëm të këmbimit dhe reformave në tregjet e sigurimeve dhe institucioneve financiare jobankare në Shqipëri. Ky rezultat është i rëndësishëm për Shqipërinë, aq më shumë, duke konsideruar institucionet vendase, për avancim të reformave të tranzicionit në drejtim të reformave të përgjithshme në infrastrukturë, reformave në sektorin bankar, reformave në politikën e tregtisë dhe reformave në kursin e jashtëm të këmbimit, si dhe reformave në institucionet financiare jobankare dhe të sigurisë.

Hipoteza 2:

Ho: Zhvillimi i institucioneve është faktor i parëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Zhvillimi i institucioneve është faktor i rëndësishëm në ndikim, në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Nga faktorët institucional vërejmë që faktorët institucional, që lidhen me indekset e qeverisjes së mirë, si: kontrolli i korrupsionit, rregulla e ligjit, efektiviteti qeveritar, kualiteti i politikës qeveritare, llogaridhënia institucionale dhe risku politik janë të rëndësishëm statistikisht për flukset bilaterale të IHD-vë, ndërmjet vendeve. *Pra Ha, vërtetohet.*

Koeficienti i vlerësuar i flukseve bilaterale të IHD-ve, në interaksion me indekset e qeverisjes së mirë, të paraqitur së bashku, është pozitivisht i lidhur me tendencën rritëse të IHD-ve. Kjo lidhje teston nëse relacioni mes nivelit të kaluar dhe nivelit potencial të IHD-ve në Shqipëri, varet nga zhvillimet institucionale. Rezultatet e studimit konfirmojnë që 1 për qind rritje të indeksit të zhvillimeve pozitive institucionale në interaksion me IHD-të e kaluara, lidhet pozitivisht me rritje të fluksit të ardhshëm të IHD-ve, nga vendet origjinë të Bashkimit European në Shqipëri, mesatarisht për 1,49 për qind, duke mbajtur faktorët e tjerë konstant. Kjo do të thotë se prezenca e hershme e kapitalit të huaj (kryesisht me origjinë nga 14 vende të BE-së), në formë të IHD-ve, ka treguar efekt pozitiv në rritje të kualitetit të shërbimeve publike, të prodhuar dhe siguruar nga qeveria shqiptare gjatë periudhës së studimit.

Hipoteza 3:

Ho: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktorë të parëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Ha: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktorë të rëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IHD-ve në Shqipëri.

Në përputhje me pritjen teorike, zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktorë të rëndësishëm dhe me ndikim pozitiv në rritjen e IHD-ve në vendin pritës të IHD-ve

(Shqipërisë), nga 14 vende të Bashkimit European në Shqipëri. Rezultatet e studimit konfirmojnë që 10 për qind rritje të indeksit të zhvillimeve pozitive në mjedisin e biznesit, lidhet pozitivisht me rritje të fluksit të ardhshëm të IHD-ve, nga vendet origjinë të Bashkimit European në Shqipëri, mesatarisht për 0.15 për qind, duke mbajtur faktorët e tjerë konstant. *Pra, Ha vërtetohet.*

Kjo lidhje pozitive midis fluksit të IHD-ve nga 14 vende origjinë të BE-së drejt Shqipërisë dhe zhvillimeve në mjedisin e biznesit, tregon që klima më e favorshme e biznesit pasohet me flukse më të larta thithjesh të IHD-ve në Shqipëri nga vende të Bashkimit European.

Tabela 29: Rezultatet empirike sipas metodologjisë së efekteve të rastit.

VARIABLES	(1) OLS	(2) Efekte Fikse	(3) Efekte te Rastit	(4) Feasible GLS	(5) Tobit me efekte te rastit
Log PPB në vendin origjinë (-1)	-0.158*** [-2.90]	-0.032 [-0.07]	-0.158*** [-2.90]	-0.158*** [-2.95]	-0.158*** [-2.95]
Log PPB në Shqipëri (-1)	0.375*** [4.17]	0.241 [0.98]	0.375*** [4.17]	0.375*** [4.24]	0.375*** [4.24]
Log i diferencë në PPB për frymë	-0.532* [-1.96]	0.724 [0.94]	-0.532* [-1.96]	-0.532** [-1.99]	-0.532** [-1.99]
Log i distancës	-0.933*** [-7.28]	0.000 [.]	-0.933*** [-7.28]	-0.933*** [-7.41]	-0.933*** [-7.41]
Log i progresit të tranzicionit * IHD (-1)	-3.255** [-2.20]	-3.881** [-2.54]	-3.255** [-2.20]	-3.255** [-2.24]	-3.255** [-2.24]
Log i institucioneve * IHD (-1)	1.491** [2.31]	1.762*** [2.64]	1.491** [2.31]	1.491** [2.35]	1.491** [2.35]
Log i mjedisit të biznesit * IHD (-2)	0.015* [1.68]	0.017* [1.93]	0.015* [1.68]	0.015* [1.71]	0.015* [1.71]
Konstanta	11.227*** [4.07]	-8.681 [-0.96]	11.227*** [4.07]	11.227*** [4.14]	11.227*** [4.14]
Numri i observimeve	236	236	236	236	236
R katrori	0.562	0.333			14
R katrori i korrigjuar	.	0.367	0.562	14	.
Numri i paneleve - grupe		14	14	.	

t-statistics in brackets

*** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

5.4. Roli i investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike në Shqipëri

Nocioni i rrugës së zhvillimit të investimeve zhvillon idenë se pozicioni i flukseve hyrëse dhe dalëse të IHD-ve, të një vendi, në mënyrë sistematike lidhet me zhvillimin ekonomik të vendit përkatës në raport me vendet e tjera. Ky nocion do të thotë se vendet kanë tendencë për të kaluar drejt zhvillimit dhe se ky zhvillim funksionalisht mund të realizohet në përputhje me flukset e prurjes nga jashtë të IHD-ve apo stokut të brendshëm të akumuluar të IHD-ve (Dunning dhe Narula, viti 1996). Kjo prirje, nga ana tjetër, mbështetet në masën dhe modelin e avantazheve të pronësisë specifike të firmave të secilit vend, avantazhet e lokacionit dhe masën në të cilën firmat vendase dhe të huaja zgjedhin për të shfrytëzuar avantazhet e tyre të pronësisë, avantazheve të ndërkombëtarizimit të tregjeve ndërkufitare. Evidenca empirike ekzistuese, për dallim nga qasja teorike, tregon rezultate të përziera në lidhje me marrëdhëniet në mes të Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes ekonomike të vendeve pritëse të IHD-ve. Disa arsye mund të jenë të avancuara për të shpjeguar këtë ndërsjellje të tillë të rezultateve empirike. Së pari, testet kryhen tradicionalisht duke përdorur të dhënat për grupe vendesh heterogjene, përderisa në anën tjetër studimet empirike të përdorura bazohen në një numër të madh modelesh teorike. Së dyti, studimet empirike zakonisht kanë zbatuar një numër të konsiderueshëm të teknikave të ndryshme ekonometrike në testimin e modeleve teorike. Sidoqoftë, ky disparitet në mes rezultateve empirike dhe qasjes teorike, nuk përjashton nevojën për studime të mëtejshme të subjektivitetit, për aq kohë sa është treguar në mënyrë të qartë se analiza dhe rezultatet e fituara nuk janë përgjithësuar domosdoshmërisht për raste të tjera.

Pasi shpjeguem faktorët përcaktues të IHD-ve në Shqipëri, duke përdorur model graviteti dhe të dhëna panel, qëllimi kryesor në këtë pjesë të dytë të kreut empirik është për të testuar marrëdhëniet shkakësore mes flukseve të IHD-ve dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke përdorur të dhëna kuartale për periudhën 1994-2010 dhe metodologji të serive kohore.

5.4.1. Testimi i hipotezave me anë të modelit ekonometrik Granger

Në këtë pjesë të punimit, duke aplikuar aplikuar testin e shkakshmërisë Granger, ne do të japim përgjigje për pyetjen e tretë kërkimore, duke testuar hipotezat përkatëse. Analiza e studimit bazohet në seri kohore për të dhënat kuartale të PPB-së real, Investimeve të Huaja Direkte mbi bazë të fluksit dhe Investimeve të Huaja Direkte mbi bazë të stokut. Të gjithë variablat janë në formën logaritmike. Periudha e mostrës është nga viti 1994:1 deri në 2010:2.

Pyetja kërkimore 3:

A ekziston ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet Investimeve të Huaja Direkte dhe rritjes ekonomike në Shqipëri?

Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore të dytë, do të testojmë hipotezën e mëposhtme:

Hipoteza 1:

Ho: Nuk ekziston lidhje shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri.

Ha: Ekziston lidhje shkakësore ndërmjet IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Shqipëri.

Hipoteza 2:

Ho: Nuk ekziston lidhje shkakësore ndërmjet rritjes ekonomike dhe IHD-ve në Shqipëri.

H1: Ekziston lidhje shkakësore ndërmjet rritjes ekonomike dhe IHD-ve në Shqipëri.

1.6.1 Testi i shkakshmërisë Granger duke përdorur metodologjinë VAR

Në mënyrë që të bëjmë një analizë më formale lidhur me ndikimin e kategorive të ndryshme të IHD-ve (në nivel fluksi dhe stoku), në nivelin real të Produktit të Përgjithshëm Bruto, kemi aplikuar metodologjinë e autoregresionit vektorial (VAR). Periudha e analizuar është nga 1994-ra deri 2010-ën, duke përdorur të dhëna kuartale. Duke përdorur testin Granger, regresojmë 'PPB real' mbi vlera të diferencuar të variablave të dy kategorive të ndryshme të IHD-ve dhe variablave të diferencuar të 'PPB real'. Nëse koeficientët e diferencuar të 'IHD-ve' janë statistikisht të ndryshëm nga 0-ja, atëherë mund të konkludojmë që 'dy kategoritë e IHD-ve, në nivel fluksi dhe stoku' shkaktojnë efektin granger në 'PPB real', që do të thotë se IHD-të mund të përdoren për të parashikuar ndodhitë në 'PPB real' (Stock dhe Watson, 2007; Green, 2008). Sipas Granger (1969), "Y-ni" thuhet të shkaktojë efektin granger në "X" nëse dhe vetëm nëse "X" parashikohet më mirë duke përdorur vlera të diferencuara (vlera të mëhershme) të "Y-it" sesa përmes jo parashikimit duke përdorur vlera të diferencuara të "X-it".

Konkretisht:

1. Nëse Y-ni mund të ndihmojë për parashikim një tjetër X, atëherë themi që Y-ni shkakton efektin granger në X.
2. Nëse Y-ni shkakton X dhe X nuk shkakton Y, thuhet që shkakshmëria jodrejtuese ekziston nga Y-ni në X.
3. Nëse Y-ni nuk shkakton X dhe X nuk shkakton Y, atëherë X dhe Y-ni janë statistikisht të pavarur.

4. Nëse Y-ni shkakton X dhe X shkakton Y, thuhet që ekziston një lloj feedbacku në mes X-it dhe Y-it.

Esencialisht, definicioni i Granger për shkakshmërinë tregohet përmes parashikimit. Me analizë të regresionit, ne vlerësojmë nëse Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri, në nivel fluksi dhe stoku, promovojnë rritje ekonomike në Shqipëri dhe nëse rritja ekonomike mund të inkurajojë nivelin e IHD-ve. Me fjalë të tjera, dëshirojmë të gjejmë nëse ndryshimet në nivelin e PPB-se reale do të përgjigjen ndaj ndryshimeve në nivelin e IHD-ve.

Në mënyrë që të testojmë kauzalitetin direkt në mes IHD-ve dhe rritjes ekonomike të paraqitur përmes nivelit të PPB-real, performojnë testin e kauzalitetit granger, duke përdorur ekuacionet 5.1. Testi i granger kauzalitetit, i aplikuar në ekuacionin 5.1, i cili implementohet në analizë të relacionit në mes kategorive të IHD-ve dhe PPB-se real jepet si më poshtë:

$$PPBreal_t = \gamma + \sum_{i=1}^k \alpha_i \cdot PPBreal_{t-i} + \sum_{i=1}^k \beta_i \cdot IHD_{t-i} + \mu_t \quad (5.1)$$

$$IHD_t = \phi + \sum_{i=1}^k \delta_i \cdot PPBreal_{t-i} + \sum_{i=1}^k \lambda_i \cdot IHD_{t-i} + \eta_t \quad (5.2)$$

Ku *PPB real* dhe *IHD*-ja paraqesin sekuenca kohore stacionare, γ dhe ϕ interceptet (parametrat fiks), respektiv, μ_t dhe η_t paraqesin termat e gabimit nga zhurma e bardhë (*white noise error terms*), dhe k paraqet nivelin maksimum të diferencimeve që përdoret në çdo seri kohore. Niveli optimal i diferencimeve identifikohet përmes kritereve të informacionit AIC dhe HQIC.

Ky nivel i diferencimit sugjerohet për më shumë edhe nga sekuencat e Hsiao's (1981), që bazohet në definimin e Granger-it për shkakshmërinë e Akaikes (1969, 1970) lidhur me kriterin minimum të parashikimit të gabimit final.

Nëse në ekuacionin (5.1) $\sum_{i=1}^k \beta_i$ posedon rëndësia statistikore e ndryshme nga zero,

atëherë konkludojmë që IHD-të shkaktojnë PPB-real. Në anën tjetër, nëse $\sum_{i=1}^k \delta_i$ në

ekuacionin (5.2) posedon rëndësia statistikore e ndryshme nga zero, atëherë konkludojmë që PPB real shkakton IHD-të. Kauzaliteti Granger në të dy drejtimit, sigurisht, është një mundësi.

Figura 12: Paraqitja grafike e rolit të IHD-ve në nivel fluksi dhe stoku në PPB real.




Tabela 30: Rezultatet e Granger-kausalitetit nga analiza VAR, sipas testit Wald.

Relacioni në mes PPB real dhe IHD në nivel fluksi				
Ekuacioni	Përfshirë	chi2	df	Prob > chi2
Logaritëm i PPB real	Logaritëm i IHD-fluks	1.2e+08	1	0.000
Logaritëm i PPB real	Tjerat	12.641	1	0.000
Logaritëm i IHD - fluks	Logaritëm i PPB real	0	1	1
Logaritëm i IHD - fluks	Tjerat	0	1	1
Relacioni në mes PPB real dhe IHD në nivel stoku				
Ekuacioni	Përfshirë	chi2	df	Prob > chi2
Logaritëm i PPB real	Logaritëm i IHD-stoku	3.0e+07	1	0.000
Logaritëm i PPB real	Tjerat	3.0e+07	1	0.000
Logaritëm i IHD-stoku	Logaritëm i PPB real	0	1	1
Logaritëm i IHD-stoku	Tjerat	0	1	1

Testi Wald është test i zakonshëm që përdoret për të testuar shkakshmërinë Granger. Çdo rresht në tabelën e Wald Testit, raporton testin Wald që koeficientët e diferencuar të variablave në kolonën "përfshirë" janë zero për variablat në kolonën "ekuacion". Lidhur me Investimet e Huja Direkte në Shqipëri, në nivel fluksi, vlera e ulët p prej 0.000 në rreshtin e parë favorizon hipotezën që koeficientët në formë të diferencuar në kolonën përfshirë të fluksit të IHD-ve, nuk janë bashkërisht zero në ekuacionin për PPB-të real, që do të thotë se në nivelin 1% të rëndësisë statistikore, ekziston evidencë e mjaftueshme empirike për të hedhur poshtë hipotezën zero të kausalitetit Granger, që fluksi i IHD-ve totale nuk shkakton ndryshimet granger në PPB real. *Me fjalë të tjera, testi vërteton që ndryshimet në fluksin e IHD-ve "shkaktojnë" ndryshime në nivelin e*

PPB real. Pra, Hipotaza1, vërtetohet Ha. Në anën tjetër, vlera e lartë p prej 1 në rreshtin e tretë, paraqet evidencë të pamjaftueshme empirike për të hedhur poshtë hipotezën zero të kauzalitetit granger, që niveli i PPB-real nuk shkakton ndryshime shkakësore në fluksin e IHD-ve. Me fjalë të tjera, testi vërteton që ndryshimet në PPB real "nuk shkaktojnë" ndryshime në nivelin e fluksit të IHD - ve. Pra, Hipoteza 2, Ho nuk hidhet poshtë. Hipoteza zero pranohet.

Lidhur me Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri në nivel stoku, vlera e ulët p prej 0.000 në rreshtin e parë favorizon hipotezën që koeficientët në formë të diferencuar në kolonën përjashtuese të fluksit të IHD-ve, nuk janë bashkërisht zero në ekuacionin për PPB-në real, që do të thotë se në nivelin 1% të rëndësisë statistikore, ekziston evidencë e mjaftueshme empirike për të hedhur poshtë hipotezën zero të kauzalitetit granger që stoku i IHD-ve totale nuk shkakton ndryshimet granger në PPB real. Me fjalë të tjera, testi vërteton që ndryshimet në stokun e IHD-ve real "shkaktojnë" ndryshime në nivelin e PPB real.

Në anën tjetër, vlera e lartë p prej 1 në rreshtin e tretë, paraqet evidencë të pamjaftueshme empirike për të hedhur poshtë hipotezën zero të kauzalitetit granger, që niveli i PPB-real nuk shkakton ndryshime granger në stokun e IHD-ve, në Shqipëri, përgjatë periudhës 1994-2010. Me fjalë të tjera, testi vërteton që ndryshimet në PPB real "nuk shkaktojnë" ndryshime në nivelin e stokut të IHD-ve.

5.5. Përfundime dhe implikime të politikave

Ky kapitull mbështetet në dy analiza empirike që lidhen me Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri. Pjesa e parë e analizës empirike trajton faktorët përcaktues të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri. Për trajtim të hipotezave të trajtuara në pjesën e literaturës empirike dhe pjesën teorike të punimit, pjesa e parë e kreut empirik mbështetet në modelin e gravitetit, që shpjegon faktorët përcaktues të flukseve të IHD-ve, nga 14 vende kryesore të Bashkimit Europian në Shqipëri. Mostra e trajtuar prej 14 vendeve të Bashkimit Europian, si vende burimore të IHD-ve për Shqipërinë, justifikohet më shumë nga niveli i lartë aktual dhe potencial i flukseve të investimeve të këtyre vendeve drejtuar Shqipërisë, si vend nikoqir i IHD-ve.

Analiza e pjesës së parë e këtij punimi ka identifikuar faktorët kryesor përcaktues të fluksit të IHD-ve në Shqipëri, duke u fokusuar më shumë në faktorët e gravitetit që lidhen me madhësinë e tregjeve dhe faktorët institucional të vendeve pritës të IHD-ve, të cilët shpjegojnë motivet e IHD-ve, duke u bazuar në faktorët kërkues të eficensës dhe burimeve ekonomike në Shqipëri.

Rezultatet empirike të nxjerra nga punimi konfirmojnë pritjet teorike, lidhur me rëndësinë dhe peshën specifike të faktorëve institucional dhe faktorëve të tjerë që lidhen me motivet e investorëve të huaj, për IHD-të. Shikuar nga aspekti i motiveve të investorëve të huaj, rezultatet empirike konfirmojnë një pjesë të teorisë së paradigmës elektike të zhvilluar nga Dunning (2001), ku vërtetohet se investorët e huaj, udhëhiqen nga motivet kërkuese të eficensës, për orientim të investimeve të tyre në Shqipëri.

Rezultatet empirike të studimit mund të shërbejnë si mjet analitik për vlerësim të politikave institucionale të qeverisë shqiptare, me qëllim të bërjes së Shqipërisë, si vend më atraktiv për investitorët e huaj.

Pjesa e dytë e analizës empirike e punimit mbështetet në të dhëna të serive kohore, në nivel vjetor, për periudhën 1994-2010, duke trajtuar kështu rolin e Investimeve të Huaja Direkte, në nivel fluksi dhe stoku, në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Për një analizë të tillë kemi përdorur metodologjinë e vektorëve me korrigjim të gabimit (VAR), që mbështetet në testet Granger të shkakshmërisë.

Testet e realizuara Granger, vërtetojnë lidhje të njëanshme shkakësore nga Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri. Këto teste në anën tjetër nuk vërtetojnë lidhje prapavepruese të ndikimit të Produktit të Përgjithshëm Bruto (PPB-së) në nivelin e Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri, në të dy nivelet: në nivel fluksi dhe stoku.

KAPITULLI VI: PËRFUNDIMI I PUNIMIT DHE REKOMANDIME

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të gjetjeve empirike të studimit. Seksioni 6.1 diskuton përfundimin mbështetur nga modelet empirike. Seksioni 6.2 jep rekomandimet dhe seksioni 6.3 jep sugjerime për kërkime në të ardhmen.

6.1. Përmbledhja dhe gjetjet empirike

Ky punim doktore kishte si qëllim kryesor që të vlerësonte faktorët përcaktues të IHD-ve në Shqipëri, si dhe të vlerësonte rolin e IHD-ve në rritjen ekonomike. Studimi arriti t'u japë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura mbi bazën e literaturës së shqyrtuar. Në pjesën e parë të kapitullit empirik të këtij punimi, duke përdorur një model graviteti, studimi shqyrton flukset e IHD-ve duke marrë për bazë¹⁴ vende të ndryshme burimore, kryesisht vende anëtare të Bashkimit Europian nga njëra anë dhe Shqipërinë, në anën tjetër, si vend pritës i IHD-ve. Duke patur parasysh rëndësinë e IHD-ve për të përshpejtuar procesin e tranzicionit në vendet e EJT-së, qëllimi i studimit ishte për të krahasuar teoritë e IHD-ve, si: teorinë e paradigmes eklektike, teorinë e bazuar në burimet ekonomike dhe teorinë e rrjetit biznesor. Literatura mbi faktorët përcaktues të IHD-ve, duke u mbështetur në teoritë e trajtuara, është shqyrtuar edhe në bazë të evidencës empirike, në kapitullin e dytë. Teoria e paradigmes eklektike siguron bazën analitike për një prodhim ndërkombëtar dhe investimet e huaja direkte. Konceptet e kësaj teorie janë bazuar në supozimet e faktorëve të pronësisë, faktorët e vendndodhjes dhe faktorët e ndërkombëtarizimit. Kjo teori i lejon studiuesit për të vlerësuar efektin e IHD-ve në ecurinë ekonomike të vendit

pritis dhe avantazhet konkurruese të IHD-ve për të zhvilluar më tej politika promovuese nga qeveritë e vendeve që kërkojnë të thithin më shumë investime.

